



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:  
“Inxhinieri të Telekomunikacioneve”  
Universiteti Politeknik i Tiranës”**

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Ana KTONA 

Dr. Alketa GREPCKA 

**Dhjetor / 2022**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Bsc në "Inxhinieri të Telekomunikacioneve"**

1	IAL aplikues:	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierise Elektronike dhe Telekomunikacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Inxhinieri të Telekomunikacioneve
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë e MASH me Nr. 765. Prot, datë 06.02.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i MAS nr.217 datë 12.05.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	37 PAE / 9 PAK
18	Numri i studentëve:	- 2019-2020; 100 studentë; - 2020-2021; 100 studentë; - 2021-2022; 111 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve ofrohet në Universitetin Politeknik të Tiranës i cili është institucion i Arsimit të Lartë me eksperiencë në fushën inxhinierike dhe me një historik që daton fillimet e tij në vitin 1957. Programi i studimit ofrohet në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit i hapur përmes Vendimit Të Këshillit të Ministrave VKM Nr.824 datë 05.12.2007 “Për krijimin e disa njësive kryesore, fakultete në Universitetin Politeknik të Tiranës”. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga tre njësi bazë respektivisht:

1. Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit;
2. Departamenti i Inxhinierisë Informatike;
3. Departamenti i Bazave të Informatikës;

Programi i studimit ofrohet në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit. Kjo njësi ofron programe studimit duke mbuluar 2 programe studimit të ciklit të parë, 2 programe studimit të ciklit të dytë Master Shkencor, 1 program studimi mastër profesional dhe 1 program studimi doktoraturë. Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit (DET) zotëron një staf që zë 53% të numrit total të stafit akademik të FTI-së. DET ka ruajtur në vite numrin e tij duke përmbushur standartet ligjore.

Programi i ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” është ndërtuar në perputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 10247, datë 04.03.2010, "Për Kuadrin e Kualifikimeve Shqiptare", të ndryshuar. Miratimi i diplomes për këtë program studimi është bërë me shkresë të MASH me Nr. 765 Prot, datë 06.02.2006.

Ky program ofron njohuri dhe zhvillon aftësi dhe kompetenca tek studentët në përfundim të studimeve të tyre në programin Bachelor në fushën e Telekomunikacionit dhe Elektronikës në perputhje me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare.

Programi i ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” është në perputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi i studimit në shqyrtim ka një kohëzgjatje 3 vite dhe në total ka 180 kredite. Ngarkesa vjetore është 60 kredite me një numër total të lëndëve dhe moduleve 32. Forma e studimit është me kohë të plotë dhe zhvillohet në gjuhën shqipe.

Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” zhvillon kompetenca të nevojshme për studentin për një formim të përgjithshëm dhe profilizim të tij në studime të mëtejshme të thelluara.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në Maj 2022. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur FTI/UPT për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. UPT, po ashtu, nëpërmjet

sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër evidencash mbështetëse. Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkuara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr.531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizmin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

GVJ gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga specialistja e ASCAL, Msc. Majlinda Demirneli. Takimet në institucion, u zhvilluan sipas programit të miratuar nga ASCAL. Takimet në institucion konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Përgjegjës të Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit, takim me grupin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit, takim me stafi akademik të angazhuar në programin e studimit, takim me studentët në këtë program studimi. GVJ zhvilloi takime me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtorisë së Komunikimit dhe Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së Kurrikulës. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë.

Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Universiteti Politeknik i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 15.11.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 186/36 Prot, datë 15.11.2022. Universiteti Politeknik i Tiranës, njofton nëpërmjet sistemit AMS, më datë 01.12.2022 me anë të shkresës me nr. 501/1, datë 25.11.2022 "Mbi Draft Raportet e Vlerësimit të Jashtëm", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri të Telekomunikacioneve”**

**I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti Politeknik i Tiranës është Institucion i Arsimit të Lartë me status të personit juridik dhe në qendër të veprimtarisë së tij ka lirinë akademike si nocion universal [Ref.1. Statuti i UPT-së, neni 2]. Programet e ofruara nga ky institucion nuk bie ndesh me interesat kombëtare, madje në të kundër kontribuon në rritjen e vlerave të vetë institucionit dhe të vendit në tërësi përmes ofrimit të programeve të studimit të cilat garantojnë cilësi në mësimdhënie dhe ofrojnë përmes studentëve të diplomuar cilësi në tregun e punës.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	UPT ofron programe studimi pjesë e të cilës është edhe programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” të cilat forcojnë vlerat akademike dhe kulturore. Në pikën 6 të nenit 3 në Statutin e UPT theksohet: <i>“UPT mbështet dhe mbron studentët në ushtrimin e të drejtës së tyre për arsim cilësor dhe siguron përfaqësimin e tyre si partnerë të plotë në qeverisjen e tij. UPT përpiqet në promovimin e mirëkuptimit ndërkulturor, mendimit kritik, tolerancës politike dhe fetare, barazisë gjinore, vlerave demokratike dhe qytetare, në mënyrë që të forcojnë qytetarinë Evropiane dhe globale të studentëve, të cilët do të hedhin themelet për një shoqëri gjithëpërfshirëse”.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	UPT zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me qëllimin, vizionin dhe misionin e tij të cilat shprehen qartë në nenin 3 në Statut të UPT-së. Qëllimi kryesor është përparimi i shkencës, i teknologjisë dhe i arsimit të lartë nëpërmjet integritit të tyre. UPT promovon dhe rrit rolin e tij në procesin e zhvillimit të shoqërisë, përmes transferimit të teknologjisë dhe informacionit, si edhe shërbimeve për territorin dhe komunitetin. Misioni i tij është: <ul style="list-style-type: none"><li>• të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, si edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatitë shkencëtarë të rinj;</li><li>• të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës në fushat e tij të ekspertizës;</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;</li> <li>të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.</li> </ul> <p>Veprimtaria akademike e UPT zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës [Ref.1. Statuti i UPT; Ref.3. Plani strategjik UPT 19-24].</p>								
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve përmes kurrikulumit të tij ka dhënë gjithmonë kontributin në zhvillimin e vendit përmes ofrimit të breza studentësh të diplomuar në këtë program të cilët tashmë janë sipërmarrës dhe ekspertë në fushën e inxhinierisë elektronike dhe telekomunikacionit. Ky program që në fillesat e tij të formimit ka plotësuar kërkesat dhe nevojat e vendit me inxhinierë të kualifikuar në fushën e inxhinierisë elektronike dhe telekomunikacionit të cilët me kontributin e tyre kanë nxitur në përfaqësimin e reja teknologjike [Ref.32. Mendimi i Dekanit për programin e studimit Bsc-InxhTLK].								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet						
			X						

### Standardi I.2

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri të Telekomunikacioneve" zhvillohet në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit [Ref.3. Plani strategjik UPT 19-24; Ref.31. Plani strategjik i zhvillimit të FTI 2018-2023]. Synimet kryesore të Strategjisë së zhvillimit të UPT 2019-2024 janë pjesë përbërëse e synimeve të këtij program studimi. GVJ konstaton se pika kryesore si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Ndërkombëtarizimi përmes rritjes së njohjes ndërkombëtare të diplomës së ofruar në këtë program studimi;</li> </ol>

	<ol style="list-style-type: none"> <li>2. Rritja e veprimtarisë ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor përmes pjesëmarrjes në projekte kërkimore kombëtare, evropiane dhe rajonale;</li> <li>3. Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkëmbimit të personelit akademik;</li> <li>4. Intesifikimi i shkëmbimeve të studentëve në përputhje me kornizën e marrëveshjeve dypalëshe;</li> <li>5. Zhvillimi i nje infrastrukture të qëndrueshme me synimin në përgatitjen e studentëve me aftësi në fushën e inxhinierisë së telekomunikacioneve;</li> </ol> <p>GVJ përmes evidencave dhe takimeve të zhvilluara në institucion konstaton se janë në përputhje me synimin e zhvillimit strategjik të institucionin në tërësinë e tij [Ref.3. Plani strategjik UPT 19-24; Ref.31. Plani strategjik i zhvillimit të FTI 2018-2023].</p>								
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” realizohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe në akordancë me Rregulloren e Njesisë Bazë dhe të Rregullosës së Programit të Studimit. [Ref.30. Rregullore e brendshme e FTI; Ref.92. Rregullore e brendshme e njesisë bazë-DET; Ref.101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë;</p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtimi i programit të studimit “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” është në përputhje me vendimin nr. 824 date 05.12.2007 e MAS për hapjen e FTI-së [Ref.28. Vendimi 824 dt 5.12.2007 për hapjen e FTI]. Struktura e programit mësimor dhe përmbajtja e tij janë në linjë me programet mësimore të ofruara nga DET. Me mbarimin e studimeve në këtë program studenti ka mundësi të ndjekë studime të thelluara në programet Master Shkencor përkatesisht MSc në Inxhinieri Telekomunikacioni ose Master Professional në Teknologji Informacioni të ofruara nga DET [Ref.101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë]</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="569 1639 758 1733">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="758 1639 968 1733">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="968 1639 1173 1733">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1173 1639 1372 1733">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="569 1733 758 1792"></td> <td data-bbox="758 1733 968 1792"></td> <td data-bbox="968 1733 1173 1792"></td> <td data-bbox="1173 1733 1372 1792" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

**Standardi I.3**




**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” ka objektiva të qarte. GVJ u njoh me disa prej këtyre objektivave në takimet e zhvilluar në Institucion. Përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• të ofrojë njohuri të thella në aspektet metodologjike dhe aplikative të matematikës dhe shkencave të tjera bazë të Teknologjisë së Informacionit;</li><li>• të ofrojë njohuri mbi teknikat dhe koncepte të thelluara në fushat e sistemeve të telekomunikacioneve, sistemeve elektronike, rrjetave të përpunimit të të dhënave, Interneti dhe programimi;</li><li>• të ofrojë njohuri rreth implementimit të teknologjive të reja të sistemeve mobile, internetit dhe rrjeteve kompjuterikë për rritjen e efikasitetit dhe transparencës së shërbimeve të ndryshme si dhe zgjidhjen e problemeve;</li><li>• të formojë studentë me aftësi dhe kompetenca për të marrë pjesë në analizën, zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjeve të ndryshme në sistemet mobile;</li><li>• të ofrojë një bazë të mirë teorike dhe praktike që studentët të jenë të aftë të zhvillojnë dhe implementojnë sisteme të ndryshme komunikimi në ndihmë të zgjidhjes së problemeve të ndryshme në institucione dhe ndërmarrje publike/private;</li><li>• të përgatisë profesionistë, të aftë për të punuar në projekte individuale ose në grup, të cilat sipas natyrës mund të jenë: projekte shkencore hulumtuese, projekte zhvillimore, punë praktike, etj; <i>[takim me Dekanen e FTI-së, takim me stafin akademik].</i></li></ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna</p>	<p>Institucioni ka ndërmarrë studime të mirëfillta tregu të punës për programin e studimit. Një studim tregu është kryer në kuadër të projektit GRADUA (një projekt tre-vjeçar 2017-2020) e cila në mënyrë të përgjithshme jep një panoramë të situatës në sektore të ndryshëm, analizë të ekonomisë, demografisë dhe tregut të punës në Shqipëri, punësimi, dinamika e numrit të studentëve, sektorët bazë të ekonomisë bazuar në të dhënat e INSTAT të cilat i përkasin vitit 2016. Në nivel me specifik GVJ u njoh me iniciativa të stafit akademik të cilët në kuadër të hartimit të një studimi kanë ndërmarrë edhe sondazhe më specifike në</p>



mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	lidhje me studentët e diplomuar, mendimin kritik të tyre për përmbajtjen e programit, aftësimin e tyre në përfundim të studimeve, fushën e punësimit të tyre. GVJ e konsideron këtë iniciativë inkurajuese ndonëse rekomandimet e dhëna janë në kuadër të një artikulli dhe aspak institucionale ku masat për përmirësim do të ishin më evidente [Ref.33. Sondazhe mbi tregun e punës dhe kompanitë; Ref.34. Studimi i tregut të punës profilet FTI].			
<b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të nxënësit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Programi mësimor në syllabuset e paraqitura ka shprehur qartë objektivat formues për programet lëndore. Përmbajtja e programit mësimor garanton përfundimin e një kuadri teorik dhe praktik i cili e bën të aftë studentin në përfundim të studimeve të tij dhe garanton një punësim të tij në tregun e punës [Ref.102. Plani mësimor i programit të studimit BscTLK; Ref.103 Syllabuse të programit të studimit BscTLK.].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	<p>UPT zotëron kapacitete dhe burime të duhura për të mundur zhvillimin e programit mësimor Bachelor “Inxhinieri të Telekomunikacioneve”. Ky program zhvillohet në Fakultetin e Teknologjise së Informacionit (FTI) i cili përbëhet nga tre njësi bazë si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Elektronikes dhe Telekomunikacionit;</li> <li>2. Departamenti i Inxhinierisë Informatike;</li> <li>3. Departamenti i Bazave të Informatikës;</li> </ol> <p>Programi i studimit zhvillohet në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit. Të dhënat statistikore shprehin një qëndrueshmëri të stafit akademik PAE në këtë departament. Për periudhën 2018-2022 stafi PAE mbetet i njëjtë në numer (total 19) duke dëshmuar një rritje në grada shkencore (nga 1 prof. Dr ne 2018 në 4 për</p>

vitin 2021) [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK; dokumenta shtese]

Tabela 1: Stafi akademik në DET

Viti akademik	PAE	Total PAE	PAK	Total P
2021-2022	4 Prof. Dr	19	6 Prof. Dr.	32
	6 Prof. Asoc.		1 Prof. Asoc. Dr.	
	7 Dr.		1 Dr.	
	- Dr. proces		1 Dr. process	
	2 Msc.		29 Msc.	

Në mbështetje të programit të studimit angazhohet edhe një personel ndihmës akademik (3 në total). Institucioni ofron një infrastrukturë të duhur për zhvillimin e programit mësimor me nje bazë të gjerë laboratorike [Ref.23. Raporti i kontrollit të kapaciteteve të MASR; Ref.59. Infrastruktura dhe shërbime IT në FTI; Ref.64. Infrastruktura laboratorike në funksion të programeve te studimit FTI].

**Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Programi i studimit ofrohet në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit. Programet e ofruara në këtë department në total janë 6 për periudhen 2018-2022. Fusha e studimit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të programit të studimit. Bazuar edhe në evidencat e paraqitura Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ofron një larmi programesh që variojnë nga niveli Bachelor deri në studime Doktorature në fushën e elektronikës, telekomunikacionit, teknologjisë së informacionit, informatikës në një total 10 programe studimi. [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK; Ref.102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK].

**Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas

Fusha e përgjithshme e njësisë bazë (Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit) ka një spektër të gjerë në fushën e elektronikës dhe telekomunikacionit. Ky department mban edhe peshën më të madhe në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit përmes ofrimit të 2 programe studimi në nivelin Bachelor (BSc. në Inxhinieri Elektronike dhe BSc. në Inxhinieri Telekomunikacioni), 3 programe studimi në ciklin e II-te (Msc në Inxhinieri Elektronike, MSc. në Inxhinieri

direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Telekomunikacioni dhe MP në Teknologji Informacioni) dhe 1 program studimi në ciklin e III-të në fushën e teknologjisë dhe komunikimit me dy nënfusha studimi (Dr.në Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit).				
	Tabela 2: Numri i programeve të studimit ofruar në FTI				
	<b>FTI</b>	<b>BSc.</b>	<b>MSc.</b>	<b>MP</b>	<b>Dr</b>
	<b>DET</b>	<b>(2)</b>	<b>(2)</b>	<b>(1)</b>	<b>(1)</b>
	DII	1	2	1	-
	DBI	-	-	-	-
<b>Tota l</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
				<b>X</b>	

<b>Standardi I.</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UPT ushtron aktivitetin e tij bazuar në dokumenta ligjore institucionale të hartuara në përputhje me kërkesat ligjore të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” [Ref.1. Statuti i UPT; Ref.2. Kodi i etikës UPT; Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT].  Kreu II në Statut përcakton strukturën akademike të UPT-së të cilën GVJ e gjen në përputhje edhe më organigramën e institucionit [Ref.1. Statuti i UPT; Ref.9. Organigrama UPT]. Detyrat dhe përgjegjësitë janë dhënë qartë në kapitullin “Autoritete Drejtuese të UPT-së”, ku neni 19 dhe 20 përcakton detyrat e autoritetit të njësisë kryesore dhe

	<p>njesisë bazë. Referuar edhe rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies këto detyra përcaktohen qartë hartimi dhe zhvillimi i programeve të studimit ku Kreu I – IX përshkruajnë qartë edhe dispozitat ligjore të funksionimit të programeve të studimit të ofruara në këtë institucion [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]. Më eksplicite GVJ gjen një ndarje të detyrave dhe përgjegjësi në Rregulloren e Njesisë Bazë dhe ne Rregulloren e Programit të Studimit [Ref.30. Rregullore e brendshme e FTI; Ref.92. Rregullore e brendshme e njesisë bazë-DET; Ref.101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë]. Specifikat në lidhje me lëndët, ngarkesën mësimore dhe detyrimet e studentëve janë dhëne qartë në Rregulloren e Programit të Studimit [Ref.101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë].</p> <p>Në këtë kontekst GVJ gjen një kuadër ligjor që buron nga niveli i vendimarrjes deri në nivelin e programit të studimit të institucionalizuar ku secila hallke ka të përcaktuar qartë rolin e saj. Për sigurimin e veprimtarisë mësimore Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit si hallkë e Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit bashkërendon punën e tij Departamentin e Inxhinierisë Informatike dhe Departamentin e Bazave të Informatikës. Për këtë program studimi angazhohet edhe staf akademik nga njësi të tjera bazë të UPT ku përmendim: Departamenti i Inxhinierisë Matematike (FIMIF), Departamenti i Inxhinierisë Fizike (FIMID), Qendra e Gjuhëve të Huaja (FIMIF), Departamenti i Automatikës (FIE), Departamenti i Eletroteknikes (FIE) dhe Departamenti i Prodhim, Menaxhimi (FIM) [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK].</p> <p>Në këtë kuadër konstatojmë bashkëpunimin edhe me struktura organizative ku përmendet Drejtoria e Bibliotekës Shkencore, Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, Drejtoria e Kurrikulave, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike ku marrëdhëniet janë përcaktuar qartë në rregulloret përkatëse të këtyre strukturave [Ref.9. Organigrama UPT].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit nga ana e DET konsiderohet e rëndësishme bashkëpunimi me të gjithë hallkat brenda dhe jashtë institucionit të cilat japin një impakt pozitiv në program dhe veçanërisht tek studentët që</p>

bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.

diplomohen në këtë program studimi. Në këtë drejtin FTI ka nënshkruar një sërë marrëveshje bashkëpunimi me palë të ndryshme me qëllim bashkëpunimin ndër-institucional dhe shkëmbim përvojë profesionale. Ndërtimi i partneriteteve me shoqëri të civilë, dhe komunitetin e biznesit konsiderohet si një nga përfitimet kryesore në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor. Nga zhvillimi i këtyre veprimtarive bashkëpunuese FTI synon në përfitimin siç vijon më poshtë dhe shprehet qartë në dokumentin nr.42. Raport i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit:

- Ndërtimi i programeve të përbashkëta studimore dhe kërkimore me përfitime të dyanshme;
- Lëvizshmëria e stafit/studentëve dhe vënia në dispozicion e kapaciteteve të ndërsjellta;
- Shkëmbime përvojash, eksperiencë konkrete dhe përgatitja e studentëve të këtij program studimi si kapacitete potenciale për punësime të ardhshme në këto institucione bashkëpunuese;
- Aplikime për programe specifike kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të cilat do t'ju shërbejnë palëve bashkëpunuese në funksion të përfitimeve të ndërsjellta të tyre;
- Organizime të përbashkëta me karakter shkencor, trajnime, aktivitete studentore si botime, konferenca etj.

Në këtë kuadër GVJ shqyrtoi me vëmendje evidencat e paraqitura nga institucioni për bashkëpunimet dhe impakti i tyre në programin e studimit. Me konkretisht bazuar edhe në takimin me Përfaqësuesin e Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit dhe Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve konstatojmë:

- a. 18 marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda vendit;
- b. 17 marrëveshje bashkëpunimi me IAL-të në vend;
- c. 27 marrëveshje bashkëpunimi me universitete evropiane;
- d. 50 marrëveshje në kuadër të Erasmus ku 10 prej tyre i përkasin FTI-së;
- e. 8 double degree në nivel univesiteti ku 2 prej tyre i përkasin FTI-së;

	<p>f. 40 mobilitete të studentëve në nivel universiteti ku 4 i përkasin FTI-së;</p> <p>g. 45 mobilitete të stafit akademik ku 30 janë outgoing dhe 15 incoming;</p> <p>Vetem për vitin akademik 2021-2022 kanë përfituar mobilitet në kuader të Erasmus+:</p> <p>a. 22 anëtarë të stafit akademik (10 pedagogë në Universitetin Teknologjik Compiegne/ France, 3 pedagogë në Institutin Politeknik Viseu/Portugali; 4 në Universitetin OnDokuz Mayıs/Turqi, 4 pedagogë në universitetin Politeknik Bari/Itali) me fokus kryesor në trajnim dhe mësimdhënie;</p> <p>b. 2 studentë kanë përfituar mobilitet në Universitetin Teknologjik Compiegne, Francë; [ dok shtesë, takime në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia bazë përmes monitorimit të praktikës profesionale në institucionet host ku studentët kryejnë këtë veprimtari analizon në fund të vitit edhe përfitimet përmes këtyre bashkëpunimeve të cilat reflektohen edhe në raportin vjetor që njësia bazë harton në fund të vitit akademik. Drejtoritë përkatesë si Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit dhe Zyra Alumni për specifikat e punës së tyre analizojnë bashkëpunimet me institucione përkatëse. Të dhënat përpunohen në formë statistikore dhe reflektohen në raportin vjetor të FTI-së. [Ref.46. Model analizë vjetore mësimore FTI; Ref.47. Model analizë vjetore për kërkimin shkencor FTI; Ref.19. Informacion mbi sektorin e statistikës.]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Zhvillimi i praktikës profesionale me kodin B-TLK-350 është i përfshirë në programin mësimor të programit të studimit Bachelor “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” vlerësuar me 4 ECTS dhe planifikuar të zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të tretë. Në realizimin e saj DET mbështetet në marrëveshjetet e bashkëpunimit që ka nënshkruar me një sërë kompani në fushën e biznesit [Ref.6. Marrëveshjet Institucionale UPT me akademinë dhe industrinë]. Zhvillimi i praktikës profesionale monitorohet nga Koordinatorin e programit të studimit dhe pedagogët përgjegjës të grupit mësimor kërkimor [Ref. neni 8, neni 20 në Rregulloren e Brendshme të FTI; takim me stafin akademik].</p>




GVJ shqyrtoi me vëmendje evidencat e paraqitura nga institucioni në lidhje me Procedurat e zhvillimit të praktikës profesionale. GVJ konstaton një mungese informacioni në Rregulloren e programit të studimit në lidhje me dispozitat e zhvillimit të këtij procesi. Bazuar në nenin 54 të Rregullores së FTI-se, pika (i) citojmë: “çdo program studimi ka rregulloren e tij mësimore. Rregullorja mësimore e programit të studimit përmban (i): kërkesat specifike për organizimin e praktikave profesionale dhe diplomimit”.

*Bazuar për sa më sipër GVJ rekomandon që të përfshihet në një dispozitë të veçantë në Rregulloren e programit të studimit procedura e zhvillimit të praktikës profesionale.*

[Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT; Ref.92. Rregullore e brendshme e njësisë bazë-DET; Ref.30. Rregullore e brendshme e FTI; Ref.101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë]

**Kriteri 5.** Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.

Institucioni ofron një larmi trajnime, seminare për studentet e diplomuar nga kompani si Digitalb, Lufthansa, Soft & Solution, Albtelecon, Vodafone Albania të cilat kanë organizuar seminare dhe workshop-e me studentët në fusha të caktuara [Ref.43. Aktivitete shkencore FTI, DET, DII; Ref.78. Shembull i orëve të hapura.]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet			
	Plotësisht	Pjesërisht	Kryesisht	Plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet			
	Plotësisht	Pjesërisht	Kryesisht	Plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

### Standardi II.1

**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” është ndërtuar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Program i studimit në shqyrtim ka një kohëzgjatje 3 vite dhe në total ka 180 kredite. Ngarkesa vjetore është 60 kredite me një numër total të lëndëve dhe moduleve 34 (32 lëndë, 1 Praktikë profesionale dhe Punimi i diplomës). Forma e studimit është me kohë të plotë dhe zhvillohet në gjuhën shqipe. Programi i studimit në Kapitullin I në nenet 1-3 të rregullores së tij përcakton qartë strukturën e programit dhe bazën ligjore mbi të cilin është ndërtuar dhe funksionon. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” është program studimi që i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe mbulohet nga Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit [Ref.neni 3 në Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë].</p> <p>Ky program përmban elementet e nevojshëm (modulet, lëndët dhe kreditet përkatëse për secilin prej tyre, shpërndarjen në çdo semestër), kushtet e pranimit dhe përzgjedhjes, metodat e vlerësimit të studentëve dhe progresi i tyre, kushtet për transferim dhe çdo element detyrues në përputhje me kuadrin ligjor dhe specifikisht me VKM Nr.41 datë 24.01.2018 (i ndryshuar) dhe dispozitat e dhëna në Kreun III-VIII të Rregullores së zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK Ref.102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” është ndërtuar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 10247, datë 04.03.2010, "Për Kuadrin e Kualifikimeve Shqiptare", të ndryshuar. Ky program ofron njohuri dhe zhvillon aftësi dhe</p>



	<p>kompetenca tek studentët në perfundim të studimeve të tyre në programin Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve në perputhje me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare për një formim të thelluar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fushën e ICT-së;</li> <li>• Elektronikës dhe telekomunikacionit;</li> <li>• Njohuri teorike dhe praktike në fushën e përpunimit të sinjalit;</li> <li>• Njohuri teorike dhe praktike në rrjetat kompjuterike;</li> <li>• Njohuri teorike dhe praktike në fushën e antenave dhe sistemeve të radio transmetimit, rrjetave me fibër optike, sistemeve mobile etj.</li> </ul> <p>Dhe të aftë të punojnë si specialistë në fushën e:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Elektronikës dhe telekomunikacionit;</li> <li>b. Specialist në rrjetat kompjuterike;</li> <li>c. Specialistë në kompanitë mobile;</li> <li>d. Specialist në fushën e antenave dhe radio transmetimit;</li> </ol> <p>[Ref.102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK; Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK.]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” përmban lëndë dhe module të trajtuara gjerësisht në aspektin teorik dhe praktik.</p> <p>GVJ gjen në këtë program studimi një set lëndë dhe module të cilat formojnë një bazë të gjerë njohurish për studentin dhe marrjen e koncepteve bazë themelore në këtë fushë. Disiplina “Lënde Karakterizuese “B” përmban 16 lëndë ku 13 prej tyre janë vlerësuar me 6 ECTS dhe 3 janë më 5 ECTS duke i ofruar studentit një formim të gjerë teorik dhe praktik në fushën e telekomunikacionit. Përmendim këtu lëndë që japin formim në drejtime:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Elektronike &amp; Telekomunikacion: Teoria e sinjaleve, Matje elektronike, Automatizim, Elementet dhe teknologjitë elektronike, Sistemet elektronike, Përpunimi numerik i sinjaleve, Bazat e telekomunikacioneve, Teoria e fushës elektromagnetike, Sistemet në radiofrekuencë 1, Sistemet e telekomunikacioneve, Rrjetat e transmetimit të të dhënave, Transmetim numerik, Rrjetat me fibra optike.</li> </ol>

	<p>b. Programim: Elementet e Informatikës, Teknikat dhe gjuhët e programimit, Algoritëm dhe programim i avancuar, Arkitekturë e kompjuterave;</p> <p>të cilat janë disa prej lëndëve në këto disiplina të cilat kontribuojnë në një formim të përgjithshëm dhe karakterizues teorik dhe praktik. Përmes këtij spektri të gjerë njohurish dhe aftësimit të tyre në praktikë studenti përfiton të menduarit kritik dhe analizim në gjetjen e zgjidhjeve duke mundësuar një punësim të shpejtë të tij në tregun e punës.</p> <p>[takim me studentët, takim me stafin akademik; Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK; 102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK; Ref.103.Syllabuse të programit të studimit BscTLK]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” zhvillon kompetenca të nevojshme për studentin për një formim të përgjithshëm dhe profilizim të tij në studime të mëtejshme të thelluara.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në vitin e parë studentit merr njohuri të thelluara në Analizë Matematike 1,2 &amp; 3, Fizikë 1&amp;2, Elektroteknikë dhe hyrje në Elementët e Informatikës, Teknikat dhe Gjuhët e programimit, Komunikim Inxhinierik dhe Probabilitet.</li> <li>- Në vitin e dytë dominojnë kryesisht lëndët dhe modulet e disipinës “B”, ku studentit aftësohet në Teorinë e sinjaleve, Matjet elektronike, Automatizim, Elementet dhe teknologjitë elektronike, Sistemet elektronike, Përpunimi numerik i sinjaleve, Bazat e telekomunikacioneve dhe Teori të fushës elektromagnetike. Në këtë vit janë përfshirë edhe njohuritë në lidhje me Algoritëm dhe Programim i avancuar.</li> <li>- Në vitin e tretë në semestrin e parë dominojnë lëndët e kategorisë “B” ku thellohen njohuritë në fushën e telekomunikacionit përmes moduleve: Sistemet ne radiofrekuence, Sistemet e telekomunikacionit, Rrjetat e transmetit të të dhënave, Transmetimi numerik, Rrjetat me fibra optike dhe Njohuri ne arkitekturën e kompjuterave. Në programin mësimor janë parashikuar edhe katër lëndë me zgjedhje ku tre prej tyre zhvillohen në semestrinë dytë të vitit të tretë përkatësisht dy me karakter profesional dhe një lëndë</li> </ul>

	<p>me karakter social dhe menaxhues. Programi ka ngjashmëri në përmbajtje dhe zhvillim me programin mësimor të Universitetit Politeknik Milano, Itali dhe ka shumë elemente nga Programi Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike të Torinos; [Ref.95. Programe studimi të ngjashme (Torino, Milano)].</p> <p>GVJ e gjen programin mësimor solid dhe në një vijueshmëri llogjike të lëndëve të cilat derivojnë në një formim të orientuar të studentit. Finalizimi i njohurive është me përgatitjen e tezës së diplomës ku studenti shfaq aftësinë në analizimin e një teme të caktuar dhe dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve të duhura në lidhje me të. [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK; takim me studentët; takim me stafin akademik]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Bazuar në evidencat e paraqitura dhe takimet në institucion GVJ konkludon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartimi i programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” dhe funksionimi i tij kryhet duke u mbështetur në të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë, është hartuar duke respektuar kërkesat e VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë” [Ref.102. <i>Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK.</i>];</li> <li>2. Lëndet - modulet janë dhënë me kredite, bazuar në Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve [Ref.102. <i>Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK</i>; Ref.103. <i>Syllabuse të programit të studimit BscTLK</i>];</li> <li>3. Programi në total është 180 ECTS dhe organizohet në tre vite akademike. Çdo vit akademik ka në total 60 ECTS [Ref.102. <i>Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK</i>; Ref.103. <i>Syllabuse të programit të studimit BscTLK</i>];</li> <li>4. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” ka pësuar disa ndryshime në vite. Programi i studimit është gjithmonë në përmirësim të vazhdueshëm. Ndryshime që nuk tejkalojnë masën 20% të tij janë bërë në 2018-2018 ku evidentohet heqja e lëndës “Kimi” në vitin e parë dhe zëvendësimi i saj me lëndën “Komunikim Inxhinierik” dhe rritja në peshë ë kësaj të fundit nga 3 ECTS në 4 ECTS duke shtuar një hapësirë</li> </ol>

për një lëndë të dytë me zgjedhje në semestrin e gjashtë [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK]

5. Kontrolli i dijeve dhe format e vlerësimit janë shprehur qartë në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT dhe në përmbajtjen e çdo syllabusi [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT; Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK.].
6. Objektivat formues, kompetencat profesionale janë dhënë qarte edhe në syllabuset e çdo lënde pjesë përbërëse e programit të studimit [Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK.];

**Kriteri 6.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Nga analiza e programit të studimit, GVJ konstatoi se janë përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët sipas kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore. Duke i ballafaquar dhe përshtatur në përputhje me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” veprimtaritë formuese të programit mund të grupohen:

Tabela 3: Lëndët sipas kategorive

Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi
A	Lëndë Bazë	37	20%	15 – 20 %
B	Lëndë karakterizuese	93	52%	50 – 55 %
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	25	14%	12 – 15 %
D	Lëndë plotësuese	19	11%	10 – 15 %
E	Detyrime përmbyllëse	6	3%	3 – 5 %

Tabela 4: Përqindja e lëndëve sipas kategorive

Kategoria	Tipi	2021-2022	2020-2021	2019-2020	Standardi
A	Lëndë Bazë	20%	20%	20%	15 – 20 %

B	Lëndë karakterizuese	52%	52%	52%	50 – 55 %
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	14%	14%	14%	12 – 15 %
D	Lëndë plotësuese	11%	11%	11%	10 – 15 %
E	Detyrime përmbyllëse	3%	3%	3%	3 – 5 %

GVJ në lidhje me këtë element të programit të studimit jep konsiderat si vijon më poshtë:

- Ndarja e lëndëve sipas kategorive është në përputhje me standartet e kërkuara për secilën discipline dhe kjo është ruajtur për gjithë periudhën 2018-2022.
- Bazuar edhe në VKM nr.41 date 24.01.2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” përqindja totale e lëndëve të kategorise “A” + “B” është 72%.
- Rishikimi i programit mësimor dhe hyrja në fuqi e ndryshimeve për vitin akademik 2018-2019, solli edhe krijimin e një hapësire për dy lëndë me zgjedhje. Tashme studenti mund të përftojë njohuri jo vetëm në zgjedhjen e dy lënde nga fusha teknike por ka mundësinë edhe në fusha të tjera si: Integrimi Evropian, Siguria dhe Legjislacioni, Ekonomi dhe menaxhim të cilët do ta aftësojnë atë edhe ne aspektin ligjor dhe menaxherial.

[Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK; 102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK; Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi II.2****Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	GVJ shqyrtoi me vëmendje dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe verifikimit të tij në platformën elektronike të ASCAL dhe konkludon si vijon më poshtë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Universiteti Politeknik i Tiranës si IAL në Republikën e Shqipërisë i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 1 datë 07.01.2022, me kohëzgjatje 6 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 06.01.2028 [Ref.26. Vendimi për akreditimin Institucional UPT].</li><li>• Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” zhvillon për herë të parë procesin e akreditimit në nivel programi.</li><li>• Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit (DET) përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin sipas përcaktimeve në ligjin 80/2015.</li></ul>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit përmes vendimit datë 19.02.2020 ka përcaktuar Koordinatorin e programit dhe Këshillin e Programit të Studimit (KPS) Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve”. KPS përbehet nga: 1 Prof. Asoc.Dr. (në cilësinë e Kryetarit), 1 Dr. dhe 1 student [Ref.93. <i>Vendimi për emërimin e këshillave të programeve të studimit (KPS)</i> ].  Të drejtat dhe detyrat e Koordinatorit dhe KPS janë përcaktuar në Rregulloren e DET dhe në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT [Ref.92. <i>Rregullore e brendshme e njësisë bazë-DET</i> ; Ref.12. <i>Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT</i> ]. Bazuar në nenin 11 të Rregullores së DET, Koordinator i programit të studimit dhe KPS janë përgjegjës për evidentimin, angazhimin dhe zgjerimin e kompanive/institucioneve për realizimin e praktikave profesionale. Koordinator i KPS-së përditëson databazën e kompanive/institucioneve që ka bashkëpunim dhe i dërgon elektronikisht një muaj para fillimit të praktikës drejtuesit të departamentit”.
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve ofrohet në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit në Fakultetin e

ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Teknologjisë dhe Informacionit të UPT-së. FTI në përbërjen e tij ka tre departamente përkatësisht:

- Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit;
- Departamenti i Inxhinierisë Informatike;
- Departamenti i Bazave të Informatikës;

Në total Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit ofron 10 programe studimi përkatësisht 3 në ciklin e parë Bachelor, 3 programe studimi në ciklin e dytë MSC, 2 programe studimi në ciklin e dytë Mastër Profesional dhe 1 program studimi në ciklin e tretë Doktoraturë.

Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore – shkencore të FTI-së i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve”. Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit ofron në total 6 programe studimi duke mbuluar të tre ciklet e studimit (2 programe studimi BSc, 2 Programe studimi MSc, 1 Program studimi MP, 1 Program studimi Dr). Ky department mbulon i vetmi studimet Doktoraturë në ciklin e tretë me dy nënfusha kërkimi shkencor duke i dhënë një peshë edhe fushës kërkimore – shkencore të FTI-së.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit përmbushin detyrimet ligjore, referuar Kreut V të Ligjit për Arsimin e Lartë nr.80/2015 për “Organizimin akademik dhe administrative i IAL”.

Referuar Rregullores se FTI-se, Kreu III “Organizimi akademik dhe administrativ i FTI-së”, neni 9 përcakton organet kolegjiale drejtuese të FTI-së përkatësisht Asambleja e Personelit Akademik, Dekanati dhe Komisionet e Përhershme duke përshkruar qartë detyrat dhe përgjegjësitë në nenin 10-12 të tij.

Nenet 14 e në vijim të Rregullores së Brendshme të FTI-së përcaktojnë edhe autoritet drejtuese të kësaj njësie kryesore:

1. Dekani (neni 14);
2. Zëvendësdekanët (neni 15)
3. Zëvendësdekani për anën mësimore (neni 16)
4. Zëvendësdekani për anën kërkimore – shkencore (neni 17)

5. Drejtuesi i njësisë bazë (neni 19) [Ref.30. Rregullore e brendshme e FTI].

Organizimi i strukturës akademike të FTI-së është në përputhje të plote edhe me Statutin e UPT-së përkatesisht Kreu III i tij (Autoritetet Kolegjinale dhe Drejtuese Akademike) [Ref.1. Statuti i UPT].

**Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Ky fakultet angazhon një staf me eksperiencë dhe grada shkencore. Të dhënat statistikore tregojnë një qëndrueshmëri në vite të stafit PAE të punësuar në programet e studimit.

Tituj/ grada	2020-2021		2019-2020		2018-2019	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	6	8	5	1	3	4
Prof. Asoc.	9	1	10	1	12	1
Dr./PhD.	15	2	16	2	16	3
Dr proces	2	1	2	1	2	1
Msc.	4	40	5	34	4	36
<b>Totali</b>	<b>36</b>	<b>52</b>	<b>38</b>	<b>39</b>	<b>37</b>	<b>45</b>
	<b>88</b>		<b>77</b>		<b>82</b>	

Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit zotëron një staf që zë 53% të numrit total të stafit akademik të FTI-së. DET ka ruajtur në vite numrin e tij duke përmbushur standartet ligjore. Siç duket evidente edhe nga tabelat që vijonë më poshtë stafi akademik me grada shkencore zë 89.4% duke shfaqur edhe një konsistenë në përbërje në vite.

Tituj/ grada	2020-2021		2019-2020		2018-2019	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	4	4	2	-	1	2



Prof. Asoc.	6	1	7	1	8	2
Dr./PhD.	7	2	8	2	8	3
Dr proces	1	1	1	1	1	1
Msc.	1	17	1	17	1	16
<b>Totali</b>	<b>19</b>	<b>25</b>	<b>19</b>	<b>21</b>	<b>19</b>	<b>24</b>
	<b>44</b>		<b>40</b>		<b>43</b>	

**Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënlige për organizimin dhe strukturën akademike.

Për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri të Telekomunikacioneve" DET angazhon një staf të kualifikuar dhe me eksperiencë. Për stafin akademik PAK, GVJ konstaton angazhimin e një numri të madh kryesisht me gradën MSc. Në takimin e zhvilluar në institucion nga ana e stafit akademik u theksua përfshirja e studentëve të diplomuar si staf i jashtëm kryesisht në orët laboratorike dhe zhvillimin e orëve praktike dhe seminareve. GVJ e vlerëson këtë politikë të ndjekur nga DET ku cilësia e mësimdhënies ruhet edhe për nivelin Bachelor përmes zhvillimit të leksioneve nga titullarët e lëndëve me grada shkencore dhe angazhimin e alumni si staf PAK për orët praktike. [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK].

**Shkalla e përmbushjes së standardit**

Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi II.3

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit disponojnë të gjithë informacionet e nevojshme për organizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri të Telekomunikacioneve". Dokumentat bazë që japin informacionin e nevojshëm për mënyrën e funksionimit të programit të studimit janë si vijojnë më poshtë:

- a. Plani mësimor i programit të studimit;
- b. Rregullorja e programit të studimit.
- c. Programi i lëndëve mësimore;
- d. Syllabuset për çdo lëndë të rifreskuara dhe rishikuara në fillim të çdo viti akademik dhe të aprovuara në DET;
- e. Organizimi i praktikave profesionale;
- f. Vendime të Asamblesë Akademike dhe çdo vendim të miratuar në Senatin Akademik për programin mësimor;
- g. Struktura organizative e njësisë bazë dhe rregullorja e saj;
- h. Rregullorja e FIT-së.
- i. Plani kalendarik vjetor.
- j. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT;

FTI ndjek një procedurë të caktuar në lidhje me arshivimin dhe protokollimin e çdo shkrese zyrtare që buron nga DET dhe Dekanati i FTI-së. Dokumentacioni baze ruhet në arshivën e FTI-së dhe të DET. Informacioni i nevojshëm në lidhje me programin mësimor është i aksesueshëm edhe në [www.upt.al](http://www.upt.al) e cila tashme është aktive.

[Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT; Ref.92. Rregullore e brendshme e njësisë bazë-DET; Ref.101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë; Ref.80. Shembull Orari mësimor; Ref.102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK; Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK]

**Kriteri 2.** Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

Organizimi i programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” dhe lëndët e ofruara janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi përcaktuar nga MASR [Ref.vkm.nr.41 date 24.01.2018]. Referuar programit të studimit ndarja sipas kategorive në të cilat përfshihen lëndet dhe modulet është si vijon më poshtë:

- Kategoria A: 37 ECTS
- Kategoria B: 93 ECTS
- Kategoria C: 25 ECTS
- Kategoria D: 19 ECTS
- Kategoria E: 6 ECTS

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve përbëhet nga veprimtari formuese të

	<p>cilat realizohen në kredite ECTS. Veprimtaritë formuese janë të grupuara si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kategoria A</b> – Lëndë bazë të programit të studimit që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike. Në këtë kategoria janë përfshirë 8 lëndë.</li> <li>• <b>Kategoria B</b>- Lëndë karakterizuese që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim me specific në fushën e telekomunikacionit. Në këtë kategori janë përfshirë 16 lëndë.</li> <li>• <b>Kategoria C</b> – Lëndë ndërsiplinore dhe/ose integruese në një ose me shumë disiplina të studimit dhe japin një formim specific. Në këtë kategoria janë përfshirë 5 lëndë ku tre prej tyre janë lëndë me zgjedhje.</li> <li>• <b>Kategoria D</b> – Lëndë plotësuese të fokusuar në përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike, komunikimi inxhinierik. Në këtë kategori janë përfshirë 3 lëndë dhe praktika mësimore e cila është vlerësuar me 4 ECTS.</li> <li>• <b>Kategoria E</b> – Detyrime përmbyllëse që lidhet me përgatitjen e tezës së diplomës dhe e vlerësuar me 6 ECTS.</li> </ul> <p>Studimet organizohen në lëndë dhe module dhe vlerësohen sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është rishikuar në përputhje me udhëzimet e MASR. Numri i lëndëve në total është 32 duke shtuar praktikën mësimore dhe temën e diplomës shkon në një total 34. Format e testimit janë provim në 32 lëndë, praktika mësimore është me relacion dhe diploma është me përgatitje të temës nga ana e studentit. Sipas planit mësimor në semestrin e gjashtë studenti frekuenton Praktikën Mësimore (4 ECTS ose 80 orë) dhe në fund të këtij semetri pasi ka mbyllur të gjithë detyrimet përgatit temën e diplomes e cila është 6 ECTS [Ref.102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK; Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve ka 32 lëndë pa përfshirë Praktikën Mësimore dhe Punimin e temës së diplomës. Në total janë 32 forma testimi me provim përcaktuar në nenin 17 të Rregullores së Programit të Studimit. Lëndët janë ndarë sipas semestrave dhe krediteve për të balancuar peshën e oreve në auditor. Programi zgjat 6 semetra. Neni 14 në Rregulloren e</p>

Programit të Studimit përcakton se programi i studimit zgjat tre vite akademike dhe kohëzgjatja maksimale nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të tij.

Semestri I	32 ECTS	( 6 lëndë)
Semetri II	28 ECTS	(6 lëndë)
Semetri III	31 ECTS	(6 lëndë)
Semetri IV	29 ECTS	(5 lëndë)
Semetri V	30 ECTS	(5 lëndë)
Semetri VI	30 ECTS	(3 lëndë, praktika mësimore dhe tema e diplomës)

**Kriteri 4.** Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.

Bazuar në Planin Mësimor ngarkesa totale për 180 ECTS është **2275.5 orë në auditor** nga ku

- 1185 orë leksione;
- 714 orë seminare;
- 222.5 orë ushtrime dhe laboratorë;
- 43.75 orë janë forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor;
- 80 orë janë praktikë profesionale dhe;
- 30 orë për përgatitjen e temës së diplomës;

Shpërndarja e orëve në programin e studimit

Viti	Leksione (orë)	Ushtrime (orë)	Detyra/projekte kursi (orë)	Laborat ore (orë)	Praktike profesionale (orë)
I	408	308	7.5	50	
II	423	224	18.75	100	
III	354	182	20	70	80
Total	1185	714	46.25	220	80
Raporti %	52%		48%		

	<p>Detyrimet e studentit në lidhje me frekuentimin janë përcaktuar qartë në nenin 29 të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies në UPT ndërsa vlerësimi i dijeve janë përcaktuar në Kreun V të tij. GVJ nuk gjeti përcaktime në lidhje me frekuentimin dhe vlerësimin e dijeve të veçanta për këtë program studimi në Rregulloren e programit të studimit. Rregullorja e programit të studimit i referohet dispozitave të Rregullores së UPT-së.</p> <p><i>GVJ rekomandon vendosjen e përcaktimeve të qarta ligjore në Rregulloren e Programit të Studimit, të cilat mendojmë se do ti japin informacion më të detajuar studentit për programin e studimit.</i></p> <p>[Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT; Ref.30. Rregullore e brendshme e FTI; Ref.92. Rregullore e brendshme e njësisë bazë-DET; Ref.101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT përcakton qartë informacionin në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit të studentëve.</p> <p>[Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]. Kreu VI i saj jep dispozitat në lidhje me transferimet dhe ekuivalentimin e studimeve. Rregullorja e programit të studimit në nenin 9 të Kreut III përcakton: “Në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve regjistrohen persona sipas listave fituese të renditura nga komisioni ad-hoc dhe të miratuara nga Dekani I FTI-se”. Neni 18 në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe të mësimdhënies në UPT jep informacion për procedurat në lidhje me kuotat e pranimit në programet e studimit. Kushtet e përgjithshme të pranimit në programin e ciklit të parë jepen në nenin 19 të kësaj rregullore ku theksohet se pranohet çdo kandidat i cili ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm ose zotëron një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë”. Pika 3 e këtij neni i atribuon njësisë bazë përcaktimin e kriterëve të veçanta për programin e studimit. Bazuar për sa më sipër GVJ nuk gjeti evidencë të kushteve të veçanta të pranimit të shprehur në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>[Ref.101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë; 30. Rregullore e brendshme e FTI; Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT].</p>

Kushtet e vecanta të pranimit burojnë nga njësia bazë dhe miratohen me vendim të Senatit Akademik. Për vitin 2021-2022 bazuar në Vendimin Nr.4 datë për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve janë vendosur kushtet e vecanta të pranimit si vijon më poshtë:

- a. Kandidatët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Keshillit të Ministratve për vitin akademik 2021-2022;
- b. Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluar sipas formulës. Në këtë formulë peshë i jepet notës mesatare të thjeshtë të matematikës, fizikës në të tre vitet e shkollës së mesmë;

[Ref.72. Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve; Ref.73. Miratimi i kuotave të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve].

DET ka ruajtur kuotat e regjistrimit të studentëve në masën 100 kandidatë për çdo vit akademik.

Tabela 8: Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në programin e studimit

Sipas viteve akademike	Te regjistruar per here te pare	Student te transferuar	Total
2018-2019	120	-	120
2019-2020	100	-	100
2020-2021	100	-	100
<b>Total</b>			<b>320</b>

Ne lidhje me kuotat e pranimit në takim me stafin akademik u ngrit edhe pyetja nese do të deshironit të rrisnin numrin e studentëve duke konsideruar që kjo rritje do të jepte impakt të drejtpërdrejte në rritjen e të ardhurave të institucionit dhe kërkesa për këtë program është e lartë dhe të dhënat statistikore tregojnë që nota mesatare në hyrje e studentëve është 9.15-9.43. Dekanati i FTI-së dhe stafi akademik u shprehën në mënyrë solide që rritja e numrit të studentëve do të cënonte cilësinë e mësidhënies dhe në diskutimet e zhvilluara në department është kundërshtuar një propozim i tillë [takim me stafin akademik; takim me Dekanin e FTI-së].

**Kriteri 6.** Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.

Për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve, janë paraqitur programet e lëndëve të cilat janë të klasifikuara në kategori A, B, C, D dhe E. Programi i lëndës jep informacion mbi lektorin/lektorët që do të zhvillojnë modulin/lëndën dhe semestrin kur zhvillohet, tipologjinë e modulit/lëndës njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti, kohëzgjatjen e modulit, kreditet ECTS, objektivat e modulit/lëndës, elementët e mësimdhënies, detyrimet e studentit, metodat e vlerësimit dhe literaturën [Ref.102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK; Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK].

Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën totale për studentin, duke dhene edhe ngarkesën në auditor [Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK];

GVJ është i mendimit që programi përmban elementët e kërkuar nga VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” [Ref.102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK; Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK].

**Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.

Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” ka pësuar disa ndryshime në vite. Programi i studimit është gjithmonë në përmirësim të vazhdueshëm. Ndryshime që nuk tejkalojnë masën 20% të tij janë bërë për vitin akademik 2018-2019 ku evidentohet heqja e lëndës “Kimi” në vitin e parë dhe zëvendësimi i saj me lëndën “Komunikim Inxhinierik” duke shtuar një hapësirë për një lëndë të dytë me zgjedhje në semestrin e gjashtë [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
				X

#### Standardi II.4

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit Inxhinieri të Telekomunikacioneve paraqitet në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me VKM nr.41, Dt. 24.01.2018, i ndryshuar duke ruajtur ngarkesën ditore, javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, detyre kursi etj. [Ref.102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK; Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve është një program i koceptuar që të kombinojë pjesën teorike me atë praktike. Kjo vërehet në balancimin e orëve mësimore në auditor në formë leksioni që janë 1185 orë dhe në formë seminari, ushtrimesh, laboratorit dhe projektsh që janë në total 1190.25 orë. Ky balancim i jep mundësi studentit që të marrë njohuri dhe aftësi të mjaftueshme dhe në raport të drejtë në mënyrë që student kur të zhvillojë praktikën mësimore në vitin e fundit, të jetë i përgatitur më së miri për të kuptuar nevojat e tregut e punës [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK].</p> <p>Programi mësimor një vëmendje të veçantë i jep pjesës së ushtrimeve, orëve laboratorike dhe projekteve të kursit. Kjo u mundëson studentëve të aftësohen më shumë në praktike e kombinuar me përfitim të koncepteve të zgjeruara teorike. Programi ka një kombinim të lëndëve në çdo semester. Programi zhvillohet gradualisht me 12 lëndë – module në vitin e parë dhe me pas vijon me 11 lëndë në vitin e dytë dhe të tretë. Sikurse shprehet edhe në nenin 2 të Rregullores së Programit të Studimit, ky program ka për qëllim dhënien e njohurive të reja për ti pajisur studentët me njohuritë e nevojshme specifike për plotësimin e nevojave të tregut të punës lidhur me fushën e Inxhinierise së Telekomunikacioneve dhe te fushave të tjera të ngjashme me të. GVJ shqyrtoi me vëmendje evidencat e paraqitura nga institucioni dhe bazuar edhe në takimet e zhvilluar në institucion konkludon se përmbajtja e programit mësimor është plotësisht në shërbim të aftësimin teorik dhe praktik të</p>



	<p>studenteve [Ref.101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të pare]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p>	<p>GVJ bazuar edhe në standartet më sipër konstaton se programi mësimor Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve është i hartuar për të balancuar ngarkesën teorike me praktikën në një raport 52% : 48%. Ky ekuilibër është evident duke garantuar në fund të çdo viti akademik plotësimin e 60 ECTS. Programi i studimit, lëndët shpërndarja në vite dhe semestra, vlerësimi në kredite dhe orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit. GVJ objektivat formues i gjen të shprehur në syllabuse dhe aspak në rregulloren e e programit të studimit.</p> <p><i>Për këtë GVJ rekomandon plotësimin e rregullores së studimit duke përcaktuar qartë edhe objektivat formues në këtë rregullore që çdo student e disponon në fillim të vitit akademik të studimeve të tij [101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të pare].</i></p> <p>GVJ konkludon që programi i studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve përmbush të gjithë standartet, normat dhe dispozita ligjore të përcaktuara nga MAS për organizimin e tij, për shpërndarjen e krediteve, orëve brenda dhe jashtë saj auditorit, për zhvillimin e praktikës mësimore dhe profesionale dhe mbrojtjen e temës së diplomes [Ref.101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të pare; Ref.102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK; Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ është i mendimit se në tërësinë e saj struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master i shkencave dhe e përafërt me programe të ngjashme jashtë vendit. Programi ka ngjashmëri me Universitetin Politeknik të Milanos dhe Torinos duke marrë modelin më të mirë dhe praktikat ekselente të tyre dhe implementuar në këtë program. Eksperiencia e fituar nga mobilitetet e stafit akademik është përkthyer edhe në rishikimin e përvitshëm të përmbajtjes së syllabuseve duke ruajtur një raport të drejtë teori dhe praktik. Programi mësimor ndonëse ka qëllimin kryesor aftësimin në praktikë të studentit nuk ka anashkaluar asnjëherë kuadrin teorik që është edhe baza e njohjes së koncepteve themelore dhe më pas vijimin e zbatimit të tij në praktikë përmes studimit të</p>

	<p>rasteve konkrete. Në takimin me studentet u theksua që teoria është e nevojshme dhe aspak e ngarkuar. Ata janë të vetdijshëm që pa një teori të qartë nuk mund të kuptosh anën praktike të proceseve. Bazuar për sa më sipër, GVJ konstaton se ky program ruan traditën e tij e të qenurit një lider në fushën e elektronikës dhe telekomunikacionit përmes ofrimit të një bazë teorike dhe praktike të konsoliduar.</p> <p>Punesimi i larte i studentëve nga kompanite private është një indikator që tregon suksesin e këtij programi [takime në institucion]. Kjo dëshmohet edhe nga studentë të cilët kanë kryer mobilitete në universitete të huaja të cilët e kanë patur shumë të lehtë integrimin në programet respektive të tyre [takim me studentët; dok. Shtese: të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues të përcaktuar në këtë program studimi. Gjithashtu vlerësimi me kredite ECTS lejon transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK;takim në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të këtij programi studimi GVJ konstatoi se ato janë të përditësuara me literaturë bashkëkohore (të deri 5 viteve të fundit për literaturën bazë e deri të 10 viteve të fundit për literaturën ndihmëse). Në rastin e programit të studimit në fushën e inxhinierisë së telekomunikacionit kjo vjen edhe si domosdoshmëri për arsye të zhvillimeve të shpejta në këtë fushë. [103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK.]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve”, i vlerësuar në përmbajtje nga GVJ, garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për një program studimi të ciklit të parë. Nga takimet me studentët rezulton se realizimi faktik i programit të studimit është brenda pritshmërive të tyre [Ev. Takim me studentët].</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe / ose punësimin e studentëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës. Kjo tregohet nga një shkallë e lartë e punësimit të të diplomuarve të studentëve në fushën e inxhinierisë elektronike dhe</p>

<p>pritsmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>telekomunikacionit në kompani shumë prestigjioze si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.</p> <p>Studentët në këtë program studimi aktivizohen edhe në aktivitete kërkimore shkencore të stafit akademik duke i bërë të aftë që në studime të thelluara Mastr Shkencor të kenë njohje në lidhje me kërkimin shkencor, në adresimin e problemeve dhe zgjidhjen e tyre. Të dhenat statistikore tregojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për punime shkencore individuale të pedagogeve: 8 studentë të aktivizuar;</li> <li>• Për projekte shkencore nga Departamenti DET: 6 studentë;</li> <li>• Për projekte në nivel FTI: 3 studentë;</li> <li>• Për projekte shkencore nëbashkepunim me të tjerë: 3 studentë; [107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK]</li> </ul>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit mban lidhje të forta me kompanitë e biznesit. Staf i akademik i punësuar me kohë të pjesshme për këtë program studimi por edhe për programe të ngjashme të ndërmarra nga DET vijonë nga shoqëri të suksesshme në fushën e inxhinierisë elektronike dhe telekomunikacionit. Në forcimin e marrëdhënieve me biznesin shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara me FTI-në të cilat shërbejnë si bazë për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve. DET është i hapur për çdo thirrje nga fusha e biznesit dhe shfrytëzon çdo mundësi për aktivizimin e stafit akademik dhe studentëve duke krijuar gjithmonë urë komunikimi aktiv dhe të ndërsjellë. Bashkëpunimi është efektiv edhe në drejtim të punësimit të studentëve duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse. GVJ konstaton një punë serioze të kryer nga stafi akademik dhe Dekanati i FTI-së por nuk gjeti evidencë të qarta të punës së qëndrës së karrierës dhe alumni në këtë drejtim. Takimet me stafin akademik dhe studentët nuk sollën shembuj konkrete të punës së kësaj qëndre në këtë drejtim. [takime ne institucion]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi II.5**

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

GVJ në tabelat më sipër ka paraqitur strukturën akademike të FTI-së dhe të Departamentit Elektronike dhe Telekomunikacionit. Personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi mbart eksperiencë në fushën inxhinierike. Sic duket edhe nga tabela që vijon me poshtë raporti staf PAE /:PAK është 3.6-3.42 (78%:22% për 2018-2019, 77%:23% për periudhën 2019-2021). Për periudhën 2018-2021, 82% e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi zotërojnë gradën shkencore Dr dhe më lart. Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit bashkëvepron edhe me njësi bazë të FTI-së dhe UPT-së për angazhimin e stafit akademik në këtë program studimi [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK]. Niveli i kualifikimeve është pasqyruar qartë në CV-të e stafit akademik [Ref.82. CV - Stafit akademik i FTI-së]. Stafit akademik është i njohur edhe në fushën kërkimore shkencore përmes një numri të gjerë publikimesh në revista shencore, pjesëmarrjes në konfereca dhe trajnime dhe përmes punës së tyre edhe jashtë institucionit si konsulente në kompani të njohura [Ref.83. Lista e publikimeve të stafit akademik të FTI-së; [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK]

Institucioni ka një sërë projektsh duke rritur edhe numrin e mobilitetit të stafit akademik në universitete host si edhe numrin e stafit akademik të huaj në kuader të ERASMUS+ duke sjelle një shkëmbim eksperience dhe përvoja e cila jep impaktin e saj pozitiv edhe në procesin mësimor [takim me stafit akademik; Ref.49. Procedura mobilitet stafi akademik, student; Ref.50. Listë trajnimesh, pjesëmarrje në mobilitete për stafin akademik].

Bazuar në [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK] stafit akademik i angazhuar në programin e studimit për tre vite akademike është:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020		2018-2019	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK

Prof.Dr.	6	1 Akademik	7	1	3	-	3	-
Prof. Asoc.	3	-	8	-	13	-	13	-
Dr./PhD.	20	-	19	-	20	1	21	1
Msc (Dr në proces)	-	-	1	-	1	-	1	-
Msc.	8	8	11	18	10	14	6	18
<b>Totali</b>	<b>37</b>	<b>9</b>	<b>46</b>	<b>19</b>	<b>47</b>	<b>15</b>	<b>44</b>	<b>19</b>

**Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Fusha kërkimore shkencore dhe specialiteti i stafit akademik është në përputhje me modulën që ofron në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve. DET angazhon si staf PAE edhe pedagogë nga njësi baze të FTI-së dhe të UPT-së. Shumica e tyre zotërojnë grada shkencore Dr, Prof. Asoc. Dr dhe Prof. Dr. Ky staf i perzgjedhur mbulon lëndë të kategorise “A”, “D” dhe “E” ndërsa kategoria “B” mbulohet në masen 100% nga stafi PAE i DET. Në lidhje me stafin akademik me kohë të pjesshme evidentojmë angazhimin e stafit që zotërojnë graden MSc. Siç e kemi theksur edhe në standartët më sipër ky staf angazhohet më shumë në punën praktike dhe laboratorike dhe është një potencial për studime të thelluara në Doktoraturë [takim me stafin akademik; Ref.82. CV - Staf i akademik i FTI-së.; Ref.81. Staf i akademik i FTI, titujt dhe gradat; Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK]

**Kriteri 3.** Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij, gjë e cila mund të shihet edhe në kurrikulumet e tyre në të cilat janë përmendur specializimet, gradat, titujt, etj [takim me stafin akademik; Ref.82. CV - Staf i akademik i FTI-së.]. Për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit DET ka vënë në dispozicion staf të kualifikuar, me grada dhe tituj.

**Kriteri 4.** Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani,

DET në bashkëpunim me kompani biznesi bashkërendon punën për organizimin e praktikave profesionale. Procedura e praktikës profesionale jepet qartë në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT [Ref..Kreu

vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.

VII, neni 51 i tij]. DET i kushton një vëmendje të veçantë zhvillimit të praktikës profesionale dhe monitorimit të saj. Kordinatori i programit në bashkepunim me Këshillin e Programit të Studimit janë përgjegjës për organizimin dhe vlerësimin e cilësisë së këtij procesi. Në përfundim të praktikës profesionale studenti përgatit një relacion që mbrohet përpara një komisioni [takim me studentët, takim me stafin akademik, Ref.101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë].

Në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, Kreu VIII përcakton edhe dispozitat që studenti duhet të ndjekë për diplomimin e tij. DET angazhon stafin PAE si udhëheqës për temat e diplomës. Në lidhje me temat e diplomës diskutime u zhvilluan në institucion në takimin me stafin akademik. Bazuar në pratiken e tyre të gjithë studentet duhet të përgatisin një temë diplome. Kjo temë diplome është një punim në formë projekti apo përmbledhje punimesh të kryera në fushat e programit të studimit. Zgjedhja e temës së diplomes është në përputhje me disiplinat e programit të studimit. Mënyra e organizimit të saj përcaktohet në pikën 3 të nenit 53 të Rregullores së zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT. GVJ nuk gjeti një dispozitë të veçantë në lidhje me procedurën e organizimit të temës së diplomës në rregulloren e programit të studimit. Neni 19 i saj shpreh: "... rezultate e frekuentimit, provave përfundimtare të moduleve dhe të mbrojtjes së temës së diplomës regjistrohen në Sekretarinë Mësimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit".

*Bazuar për sa më sipër GVJ rekomandon rishikimin e rregullores së programit të studimit duke vendosur një dispozitë të qartë ligjore dhe të veçante për procedurën e diplomimit të studentëve.*

GVJ në takimin me stafin akademik diskutoi në lidhje me mundësinë e vendosjes së një mesatare pragu dhe të zhvillimit të provimit përfundimtar për studentë që nuk e kalojnë këtë prag. Për sa më sipër stafi akademik në mënyrë solide kundërshtoi këtë propozim. Ata theksuan që në mbledhje departamenti kanë pasur diskutime lidhur me këtë çështje dhe kanë rënë dakord të mos ndryshojnë kriterin e temës së diplomës. Një nga profesorët në mbledhje u shpreh në mënyrë të qartë dhe eksplicite: "Ne e konsiderojmë temën e diplomës një pashaportë që studenti fiton në përfundim të studimeve të tij. Përmes saj ata kanë mundësi të pasqyrojnë tek punëdhënësi apo në aplikime për master shkencor në


	universitet brenda dhe jashte vendit punimin e tyre" [takim me stafin akademik].			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësues shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se zhvillimi i seanceve laboratorike mbështetet prej asistentëve (laborant). Kontributi i tyre dhe i personelit administrativ shkon edhe për mirëmbajtjen e laboratorëve. [107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimit dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimit në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, institucioni ka hartuar rregullore dhe udhëzues në nivel institucional për përmirësimin e metodave të ndryshme dhe bashkëkohore të mësimit në bazë të fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve. Institucioni tregon vullnet në sigurimin dhe përmirësimin e mësimit dhe mjedisit të nxënies. Sidomos gjatë periudhës së pandemisë së krijuar nga virusi Sars-Cov-2 (covid-19), institucioni ka hartuar udhëzues për përdorimin e metodave inovative në mësimit ku ndër to veçojmë përdorimin e platformës Microsoft Teams, dhe Microsoft Office 365.

	<p>[Ref.18. Udhëzuesi i zhvillimit të mësimit në distancë; Ref.62. Platformë softuerike në përdorim nga dhe për studentët, office 365; Ref.52. Instalim Skype for Business dhe Office 365; Ref.53. Përdorim Skype for Business si pedagog].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimit dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>UPT ka ngritur mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e procesit të mësimit në mënyrë periodike. GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga institucioni në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësues nga ana e Institucionit konstaton si vijon më poshtë strukturat përgjegjëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtuesi i Njesisë Bazë koordinon, kontrollon dhe menaxhon procesin mësues. Në mënyrë periodike ai përgatit raportet vjetore të punës mësuese, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të DET, mbështetur në raportet e grupeve mësuese-kërkimore [Ref.92. Rregullore e brendshme e njesisë bazë-DET, neni 10].</li> <li>• Në drejtim të sigurimit të brendshëm të cilësisë është ngritur në nivel universiteti Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe në nivel FFTI është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Nisur nga rekomandimet e dhëna nga procesi I parë i akreditimit institucional është ngritur Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe në vitin 2021 është ngritur edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti.</li> </ul> <p>GVJ në takimin me përfaqësues të kësaj drejtorie u njoh me detyrat dhe përgjegjësitë e saj. Detyrat dhe funksioni i këtyre njësive realizohet përmes zbatimit të rregulloreve përkatëse të tyre. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në mënyrë periodike si pjesë e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ndërmerret edhe anketime semestrale me studentët për të matur cilësinë në mësimit [Ref.27. Raport pyetësor studentor organizuar UPT]. Të dhënat e mbledhura nga anketimet shprehen në formë raporti dhe u bëhen të njohur Dekanatit të FTI-së, drejtuesit të DET për të marrë masa në lidhje me problematikat që janë ngritur [takime në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimit, të vlerësimin të dijeve,</p>	<p>Studentët janë të përfshirë në të gjithë strukturat vendimarrëse kolegjiale të UPT-së. Në lidhje me vlerësimin e procesit mësues ata marrin pjesë në anketime ku shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetësorëve. Mendimi i tyre dëgjohet edhe nga stafi akademik. Nga takimi me studentët u theksua marrja e mendimit në fund të çdo orë mësimi në lidhje me</p>







përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	temën e trajtuar dhe nese ka nevojë për ndryshime [takim me stafin akademik, takim me NJSBS] .			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Të dhënat e mbledhura nga pyetorët përpunohen dhe paraqitet në Rektorat, në njësinë kryesore dhe njësitë bazë në formë raporti. Në takimin e zhvilluar me përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe NJSBC në FIT u theksua vëmendja e veçantë që Rektori i UPT-së i kushton raportit të hartuar në lidhje me rezultatet e pyetsorëve të studentëve. Për problematikat e ngritura në vëmendje të veçantë të tij kërkohet hartimi i një plan masash që burojnë nga njësia bazë deri në nivel fakulteti dhe zbatimi i tyre [takim me përfaqësues të NJSBC]. Të dhënat bëhen publike edhe në website <a href="http://www.upt.al">www.upt.al</a>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Në përmbushje të misionit të tij UPT, FTI promovojnë shembuj të praktikave më të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të huaja [Ref.48. <i>Procedurë mbështetje stafi akademik për kërkimin shkencor dhe trajnime</i> ]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Referuar ligjit në fuqi, akteve nënligjiore, Rregullores së Programit të Studimit si dhe planit mësimor, format e mësimdhënies janë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, detyrat e kursit, projektet, praktikat profesionale dhe projekt - diploma. Neni 25 në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT përcakton format e mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve. Njësia bazë mund të propozojë edhe forma të tjera të punës mësimore, që janë të përshtatshme për realizimin e programit të studimit, veçanërisht ato të kontrollit të dijeve të fituara. Propozimet për format e reja bëhen para fillimit të vitit të ri akademik dhe pasqyrohet në planin mësimor të programit të studimit, si dhe në programet e

	<p>lëndëve (syllabuse) së bashku me informacionet për ngarkesën mësimore, për orët në auditor/jashtë auditorit, për frekuentimin/ndjekjen e programit dhe për mënyrën e vlerësimit të dijeve [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT; 103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK.].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Për t'ju përgjigjur diversitetit dhe kërkesave të studentëve, personeli akademik mban kontakt të vazhdueshëm me ta nëpërmjet Koordinatorit të Programit të Studimit dhe KPS-se si dhe në çdo lëndë mundësohet komunikimi me studentët jo vetëm gjatë realizimit të procesit mësimor në auditor, por edhe jashtë auditorit nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, në rrugë elektronike (e-mail, etj) [takime në institucion]. Në këtë mënyrë, GVJ konstatoi se personeli akademik ka qenë në vazhdimësi i disponueshëm për zhvillimin e konsultimeve për çështje specifike si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve e shqetësimeve individuale të studentëve në lidhje me procesin mësimor [takim me stafin akademik; takim me studentët].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>GVJ konstatoi se për të mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve, institucioni ka vepruar në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Së pari, në përmirësimin e infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditorë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies. Për stafin akademik janë në dispozicion edhe salla ku ata kanë mundësi të punojnë dhe bashkëveprojnë me studentët. Mjediset janë të reja dhe bashkëkohore;</li> <li>- Së dyti, nëpërmjet modernizimit të bazës laboratorike dhe mbajtjes së saj në gatishmëri për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor;</li> <li>- Së treti, nëpërmjet krijimit të oportuniteteve për stafin akademik nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit për të përsosur metodat e mësimdhënies. Me mundësitë që kanë DET financon pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca duke bërë pagesën e pjesëmarrjes në to. GVJ është i vetëdijshëm që kemi të bëjmë me fonde publike ku investimi në këtë drejtim është pak i vështirë si pasojë e kornizës ligjore në fuqi. [Ref. Takime në institucion]</li> </ul>

<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ konstatoi se metodat e mësimdhënies janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve si nga vetë personeli akademik për lëndët që mbulojnë ashtu edhe nga studentët (pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve të programit të studimit) si dhe nga drejtuesi i DET. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve për çdo program studimi i cili plotësohet në fund të çdo semestri shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme përmes hartimit të një plan masash dhe realizimit të tyre [Ref.takime me NJSBS, Ref.takime ne institucion].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga takimet me studentët dhe personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi GVJ konstatoi se personeli akademik përdor metoda të ndryshme (që varen edhe nga specifika e lëndëve) për të rritur interesimin për orën e mësimi dhe për të rritur shkallën e përvehtësimit të informacionit të transmetuar. Teknika të shumta janë përdorur ne periudhen e pandemise për të rritur interesimin e studentëve dhe për ta plotësuar mungesën e komunikimit inter-aktiv që mësimi online nuk e plotëson dot. Për këtë anketime janë zhvilluar tek studentët çdo muaj për menyren e organizimit të mësimi online dhe diskutime janë kryer për problematikat e hasura. Në takimin me stafin akademik, këta të fundit shprehen që forma e mësimi online nuk është efektive për programe studimi inxhinierike ku bashkëveprimi pedagog – student duhet të jetë aktiv [takime ne institucion]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Personeli akademik përdor metoda interaktive. Prezantimet për lëndët me zgjedhje dhe gjuhë të huaja, detyrat e kursit dhe projekte e kursit që janë individuale ose në grup janë format me të shpeshta që përdoren nga stafi akademik në shërbim të mësimdhënies. Mbrojtja e detyrave të kursit apo projekt – kursi bëhet me presantim ku diskutimet janë të shumta dhe efektive [Ref.takime ne institucion]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga takimet me studentët dhe personelin akademik të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve”, GVJ konstatoi se ka një përpjekje të vazhdueshme për angazhimin e studentëve në punë praktike të cilat inkurajojnë sensin e autonomisë dhe synojnë zgjidhjen e problemeve të caktuar [Ref.Takime në institucion]. Ky element konkretizohet nëpërmjet detyrave e projekteve të kursit si dhe punëve laboratorike. Në rastin e detyrave e projekteve të kursit, të cilat në mjaft raste organizohen në grup, nuk mungon edhe ndjekja e vazhdueshme nga ana e pedagogut përkatës dhe</p>




	asistimi prej tij për tejkalimin e problematikave [103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Procesi mësimor në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” zhvillohet në ambiente e Fakultetit të Teknologjise së Informacionit vendosur në një godinë të re në korpusin e UPT-së. Godina është ndërtuar e re në përputhje me të gjithë standartet që parashikon një godinë arsimore. Mjediset e brendshme sigurojnë salla mësimi, laboratorë, zyra dhe mjedise për studentët. Godina është funksionale dhe me akses në mjediset e tjera të Universitetit Politeknik [Ref.59. Infrastruktura dhe shërbime IT në FTI].
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se ambientet në të cilat zhvillohet procesi mësimor janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një zhvillim cilësor të këtij procesi, që përfshin: ngrohje-ftohjen, ndriçimin, tabelat, projektorë dhe çdo gjë tjetër të domosdoshme për këtë qëllim. Një kontribut i rëndësishëm ofrohet nëpërmjet bazës laboratorike, e cila, në drejtim të paisjeve kompjuterike të nevojshme për zhvillimin e seancave laboratorike, është e viteve të fundit dhe e paisur me softet e nevojshme. Godina është funksionale edhe për studentët me aftësi të kufizuara. Rampa, ashensorë sigurojnë një lehtësi të lëvizjes së tyre. Në totalin e njeve hidrosanitare 3 janë në funksion për këtë kategori të studentëve [Ref.23. Raporti i kontrollit të kapaciteteve të MASR; vizite në institucion].  Siperfaqja për leksione është 1184. 57 m <sup>2</sup> (10 salla për leksione), 7 klasa për seminare (415.92m <sup>2</sup> ), laboratorët 484.98 m <sup>2</sup> (7 laboratorë), mjedise për Dekanatin dhe stafin akademik 22 zyra me një siperfaqje 824.14m <sup>2</sup> . Në këto mjedise janë në shërbim të programit edhe dy sekretari mësimore, zyra e NJSBC-së, zyra për koordinimin dhe mbështetjen ndaj studentëve. Sallat janë të pajisura me të gjithë mjetet didaktike

	<p>ndërsa laboratorët janë të pajisur me të gjithë programet softuer të duhur për mbarëvajtjen e procesit mësimor [Ref.35. Dokumentacion mbi asetet, objektet në përdorim FTI; Ref.59. Infrastruktura dhe shërbime IT në FTI]. Të gjithë sallat e leksioneve dhe seminareve kanë një ndriçim brenda standarteve të kërkuara, akustikë të mirë dhe një sistem HVAC. Godina ka një rrjet të brendshëm sipas departamenteve dhe njësive të tjera administrative. FTI siguron akses ne internet nëpërmjet dy provider Abcom dhe UPT-Rash [Ref.59. Infrastruktura dhe shërbime IT në FTI].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Për nga vetë profili i programit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve”, në masën më të madhe elementët formues të tij funksionojnë mbi bazën e një infrastrukture laboratorike solide. GVJ konstatoi se infrastruktura IT mbështet plotësisht realizimin e procesit mësimor. FTI zotëron 5 laboratore të informatikës të pajisur me programet e duhur për sigurimin e cilësisë së programit mësimor. Çdo kompjuter ka dual boot option. Sistemet e operimit janë Ëindoës (7-10) dhe Linux (Ubuntu 14.04). Çdo kompjuter i laboratorit ka të instaluar paketën Office365 (Ëord, Excel, Access, Poëer Point, Outlook etj.). Gjithashtu janë të instaluar programet profesionale si: MATLAB, Multisim, HFFS, Adobe, MS SQL Server 2014; Microsoft Visual Studio 2015; NetBeans 8.2; Octave; Ëirefreshark; Bizagi Modeler &amp; Express; Ëamp Server etj.</p> <p>Të gjitha programet e instaluar janë të liçensuara në bazë të kontratës me Microsoft ose janë falas. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin sa më modern të procesit mësimor. Instalimi, mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i departamentit dhe nga stafi IT i UPT-së.</p> <p>Në funksion të programit të studimit përdoren edhe laboratorë nga njesi të tjera bazë të UPT-se ku përmendim:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Laboratori i Fizikës në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike;</li> <li>b. Laboratori i Gjuhëve të Huaja pranë Fakultetit të Matematikës dhe Inxhinierisë Fizike;</li> <li>c. Laboratori i Elektroteknikës pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike;</li> <li>d. Laboratori i Matjeve Elektrike dhe Elektronike pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike.</li> </ol> <p>Labororet janë afër godinës së FTI-se duke garantuar nje efektivitet kohe të transferimit të studentëve nga njeri laborator</p>




	<p>në tjetrin në përputhje edhe me oraret mësimore [Ref.64. Infrastruktura laboratorike në funksion të programeve të studimit FTI]; Ref.Takime me stafin akademik theksoi kërkesën për përmirësim të kushteve laboratorike në dy drejtime kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Zgjerim të kapaciteteve në përgjigjë të numrit të studentëve dhe;</li> <li>Përmirësim të tyre në cilësi përmes blerjes së pajisjeve bashkëkohore;</li> </ol> <p>Në mbledhjet e zhvilluara nga DET po shikohet mundësia edhe për shfrytëzimin e laboratorëve të kompanive private bazuar edhe në modelin e përdorur për fibrat optike [takime në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse vihet në dispozicion të studentëve përmes Bibliotekës Shkencore të UPT-së e cila për periudhën 2017-2020 ka zgjeruar fondin e saj me 2105 njësi bibliotekare dhe 605 tituj të rinj. Kërkesat për titujt e rinj mblidhen çdo vit në njësitë kryesore, duke siguruar kështu përputhshmërinë e tyre me kurrikulat mësimore dhe fushat e kërkimit shkencor [Ref.65. Biblioteka dhe burimet bibliotekare në dispozicion të FTI]. Në shërbim të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit është ngritur edhe “Qendra Multimediale”. GVJ në vizitën e saj konsideron një hap pozitiv krijimin e një qendre të dedikuar për FTI dhe FIE por ambjentet e saj janë të vogla dhe fondi në libra shumë i pakët.</p> <p><i>GVJ rekomandon forcimin e kësaj njësie që do të krijojë lehtësi studenteve për këto dy njësi kryesore në drejtim të këtij shërbimi.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka Shkencore ka zgjeruar fondin e saj me 2105 njësi bibliotekare dhe 605 tituj të rinj. Studentët e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit kanë qasje në të gjitha bibliotekat dhe burimet bibliotekare të Universitetit Politeknik të Tiranës. Bazuar edhe në kërkesat e bëra nga stafi akademik për periudhën 2018-2021 është bërë pasurimi i saj me 71 tituj të rinj. [Ref.66. Shtimi i fondeve të bibliotekës FTI 2018-2021]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të</p>	<p>Literatura ndihmëse sigurohet në formë elektronike përmes lidhjes së BSH të UPT-së me rrjetin e katalogimit duke siguruar një bazë të gjerë të dhënash në lidhje me librat akademike, revista shkencore. Në shërbim të studentëve është në funksion edhe                    libraria                    digitale                    COBISS</p>

përafërta me programin e studimit.	[[ <a href="https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries">https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries</a> ]. Në dispozicion të studentëve është edhe libraria digitale Jstor [Ref.65. Biblioteka dhe burimet bibliotekare në dispozicion të FTI; <a href="http://www.upt.al">www.upt.al</a> ].
<p><b>Kriteri 7. Infrastruktura</b> laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Mjediset e sallave të mësimi, laboratorët, zyrat dhe shërbime të tjera, janë të një standarti të lartë dhe të pajisura me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, jo vetëm për zhvillimin komod dhe me standarte të procesit mësimor, por edhe me facilitete dhe përfitime, si për studentët, ashtu edhe për stafin akademik. Infrastruktura në FTI garanton një bazë laboratorike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Në funksion të programit të studimit janë laboratorët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 Laboratorë të informatikës dhe gjuhëve të programimit</li> <li>- Laboratori i Radio frekuencës dhe Komunikimeve Optike;</li> <li>- Laboratori i Telekomunikacionit, Sistemeve të sigurisë dhe Sistemeve të Informacionit;</li> <li>- Laboratori Multimedial dhe Sistemet e Rindërtimit 3D;</li> <li>- Laboratori Embedded systems;</li> <li>- Laboratori i Inxhinierisë së Softit dhe Inteligjencës Artificiale;</li> <li>- Laboratori i Arkitekturave, Sistemeve Operative dhe Rrjetave;</li> </ul> <p>Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin sa më modern të procesit mësimor [Ref.64. Infrastruktura laboratorike në funksion të programeve të studimit FTI; Ref.59. Infrastruktura dhe shërbime IT në FTI; Ref.23. Raporti i kontrollit të kapaciteteve të MASR;]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>FTI në funksion të mësimdhënies përdor platformën Office365 [62. Platformë softuerike në përdorim nga dhe për studentët, office 365] pjese e së ciles janë edhe modulet e mësimi on-line si Teams. Për lehtësi të përdorimit të kësaj platforme janë hartuar edhe dy manuale trajnimi përkatësisht për stafin akademik dhe studentët [Ref.51. Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft Teams (pedagog)], [Ref.54. Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft Teams (student)]</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë "Microsoft OneDrive" për komunikim të brendshëm dhe shkëmbim të të dhënave. Në lidhje me përdorimin e saj, sic u theksua edhe në kriterin 8, janë hartuar trajnime për studentët dhe stafin akademik. Përdorimi i këtij moduli siguron studentët dhe stafin</p>

dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	akademik të bashkëpunojnë në dokumeta të përbashkëta dhe ruajtje të të dhënave përmes një historiku të tij.								
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Diplomimi i studentëve është përcaktuar qartë në Kreun VIII të rregullores së zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT. Çdo student në përfundim të studimeve të tij ka si detyrime përmbyllëse përgatitjen e temës së diplomës e cila është vlerësuar në këtë program studimi me 6 ECTS. Përgatitja e temës së diplomës bëhet në semetrin e gjashtë të programit mësimor [12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT; 102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK; 107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK]. DET përgatit një listë të stafit akademik që do të shërbejë si udhëheqës të temës së diplomës. Konkretisht nga evidencat e paraqitura është stafi PAE i cili angazhohet plotësisht në procesin e diplomimit të studentëve [Ref.85. Lista e pedagogëve udhëheqës për punimet e diplomave FTI]. Zgjedhja e temës bëhet në bashkëpunim me udhëheqësin dhe kryesisht në fusha të njëjta ose të përafërta me disiplinat e programit mësimor. Në përgatitjen e temës së diplomës një vëmendje e veçantë i kushtohet formulimit të saj [Ref.takime në institucion]. Për këtë zbatohet me rigorozitet udhëzuesi për punimin e diplomës. Në mbledhjen me stafin akademik u theksua veçanërisht ky aspekt i punës së tyre. “Ne kërkojmë nga studentët një formulim të qartë, një shkrim shkencor të studimit të tyre dhe një paraqitje dinjitoze të saj. Ky është treguesi i cilësisë që studenti ka arritur në përfundim të studimeve të tij” u theksua nga shumë pjesëmarrës në takim me stafin akademik të zhvilluar në institucion [Ref.60. Model njoftimi në faqen ueb të FTI-së (diplomat, praktikat, leksione të hapura, personel akademik etj.) Ref.104. Udhëzues për punimin e diplomës Bachelor-BscTLK; Ref.85. Lista e pedagogëve udhëheqës për punimet e diplomave FTI; takim me stafin akademik].								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në Statut të UPT-së Kreu III, neni 17 organizimi dhe menaxhimi i programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë në nivel njësi bazë bëhet nga Këshilli i Programit të studimit (KPS) duke përcaktuar qartë edhe përberjen e tij [Ref.1. Statuti i UPT]. Për garantimin e procesit mësimor përgjegjës është edhe njësi bazë DET për këto programe studimi. Detyrat dhe përgjegjësitë e saj janë shprehur në dokumentat institucionale [Ref.1. Statuti i UPT; Ref.92. Rregullore e brendshme e njësisë bazë-DET; Ref.30. Rregullore e brendshme e FTI; Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT;].</p> <p>Në garantimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë së procesit mësimor në nivel institucional në vitin 2016 me rekomandimin e dhënë nga Bordi i Akreditimit për akreditimin e parë institucional të UPT-së është ngritur edhe Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila në vitin e fundit 2021 ka ngritur edhe Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetë pjesë e të cilës është edhe FTI [Ref.takim në insitucion]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësi kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit ka përgjegjësi të drejtpërdrejta për garantimin e procesit mësimor. Të drejtat dhe detyrat e saj janë shprehur në dokumentat institucionale. DET është përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe monitorimin e procesit mësimor përmes sigurimit të një mjedisi të duhur infrastrukture për punën e stafit akademik dhe studentëve. DET në bashkëveprim me kordinatorin e programit të studimit është përgjegjëse për rishikimin e programit mësimor duke marrë mendimin e stafit akademik, të kompanive të biznesit dhe studentëve. DET garanton një staf akademik cilësor për procesin mësimor dhe inkurajon dhe mbështet punën e tyre në drejtim të aftesimit shkencor [takime në institucion]. DET moniton në mënyrë të vazhdueshme procesin mësimor, përcakton ngarkesën mësimore në fillim të vitit akademik dhe realizimin e saj në perfundim të tij. Të dhënat e mbledhura për procesin mësimor pasqyrohen në raportin vjetor e cila i bashkangjitet edhe raportit vjetor institucional të UPT-së që dorëzohet edhe në MAS [Ref.46. Model analizë vjetore mësimore FTI; Ref.45. Model evidencë për raportimin e zhvillimit mësimor; Ref.47. Model analizë vjetore për kërkimin shkencor FTI; Ref.96. Model analizë vjetore mësimore njësi bazë – DET; Ref.97. Model analizë vjetore për kërkimin shkencor njësi bazë-DET].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të</p>	<p>Metodat inovative në mësimdhënie janë të larmishme. Syllabuset e paraqitura nga Institucioni tejkalojnë pak kornizën ligjore dhe GVJ evidenton që stafi akademik në përputhje me modulën, përmbajtjen e tij për të bërë më të kuptueshme tek</p>

reja inovative të mësimdhënies.	studentët organizon forma mësidhënie te reja të cilat japin një trajtë cilësore zhvillimit dhe asimilimit të tij nga studentët [Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK; Ref.takime në institucion]. Situata e krijuar nga pandemia solli më në pah përdorimin e trajtave dhe formave te larmishme. Në takimin me stafi akademik u theksua puna e madhe e tyre për të bërë lëndën të kuptueshme tek studentët. Mungesa e komunikimit dhe ndërveprimit që është baza e lëndëve inxhinierike në këtë periudhe u zëvendësua me orë shtesë pune të stafit akademik të cilet u jepnin përgjigje në kohe reale studentëve për çdo pyetje apo paqartësi të tyre [Ref.takim me stafin akademik]
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Personeli akademik zotëron grada shkencore. DET ka një staf akademik të kualifikuar në fushën e inxhinierisë elektronike dhe të telekomunikacionit. DET mbështet punën e stafit akademik në kërkimin shkencor. Njësia bazë inkurajon pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca duke bërë aty ku mundet edhe pagesën e tarifës së pjesëmarrjes [Ref.48. Procedurë mbështetje stafi akademik për kërkimin shkencor dhe trajnime]. DET krijon mundësi mobiliteti stafi akademik përmes projekteve kërkimore shkencore duke ju ofruar shkëmbim eksperience dhe marrje përvoje në univeristetë të njohura në Evropë [Ref.82. CV - Stafi akademik i FTI-së; Ref.47. Model analizë vjetore për kërkimin shkencor FTI; Ref.49. Procedura mobilitet stafi akademik, student.]. Arritjet kërkimore shkencore analizohen në mbedhjet e DET dhe jane pjesë e raportit vjetor që njësia bazë harton në fund të vitit akademik [Ref.47. Model analizë vjetore për kërkimin shkencor FTI; Ref.83. Lista e publikimeve të stafit akademik të FTI-së. Ref.96. Model analizë vjetore mësimore njësi bazë - DET]
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Stafi akademik PAE është në përmirësim të vazhdueshëm, duke ndjekur kualifikime, trajnime, certifikime në fushën e tyre të kërkimit shkencor në mënyrë që produkti final të jetë përmirësimi i karrierës së tyre si dhe procesit mësimor. Të gjitha arritjet, kualifikimet dhe çertifikimet e stafit akademik ndikojnë në përmirësimin e mëtejshëm të jo vetëm profesional të tyre por edhe të procesit mësimor duke sjellur njohuri, praktika dhe informacione të reja [Ref.83. Lista e publikimeve të stafit akademik të FTI-së; Ref.81. Stafi akademik i FTI, titujt dhe gradat; Ref.50. Listë trajnimesh, pjesëmarrje në mobilitete për stafin akademik; Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK].

<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik në FTI dhe në DET është përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Detyrat e stafit akademik janë të mirëpërcaktuar në Rregulloret e Institucionit. Stafi akademik është përgjegjës për kryerjen e një procesi mësimor sipas standarteve duke garantuar ruajtjen e përmbajtjes së programit të miratuar në department dhe të aprovuar nga instancat përkatëse të institucionit dhe MAS. Nga takimet e zhvilluara në Institucion GVJ konstaton nje staf akademik me përgjegjeshmëri, profesionalizëm që punon me përkushtim për programin mësimor. Mbatja e një kuote pranimi për të mos çenuar cilësinë e mësimdhënies, mbatja e punimit të temës së diplomës në përfundim të studimeve të studentit panvarësisht rritjes së ngarkesës në punë të stafit janë shembuj konkrete që stafi akademik në këtë njësi është plotësisht i motivuar dhe angazhuar për cilësinë në programin mësimor në terma afatgjatë kohore [Ref.takime në institucion].</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik shembuj u sollën në lidhje me testimin e metodave të reja në mësimdhënie. Evidenca u sollën për situatën e covid-19 kur mësimi u zhvillua online. Manual i mësimit online u përdor për format që duheshin përdorur gjatë procesit mësimor. Pyetsorë me studentët zhvilloheshin në mënyrë periodike çdo javë dhe raportimet përkatëse në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor hartoheshin nga ana e stafit akademik [Ref.takime në institucion].</p> <p>Forma të reja janë përdorur sidomos për projektet që zhvillohen në grup. Nxitja e debatit, diskutimit, zhvillimi dhe analizimi i situatave kritike dhe inkurajimi për gjetjen e zgjidhjes janë disa forma që janë testuar dhe kanë dalë eficiente [Ref.takime në institucion].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.5</b></p>	
<p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive</p>	<p>Kriteret e vlerësimit dhe testimit të njohurive përcaktohen qartë në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies. Kreu IV dhe V japin informacion në lidhje me organizimin e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>programeve të studimit dhe vlerësimin e dijeve. GVJ konstaton se kjo rregullore përcakton qartë kriteret bazë ndonëse siç kemi theksuar edhe në kriteret më sipër ndihet e nevojshme një rishikim i rregullores së programit të studimit e cila duhet të përcaktojë më qartë disa kriteret vlerësimi specifike për këtë program studimi. Rregullorja baze institucionale është e aksesueshme edhe në website <a href="http://www.upt.al">www.upt.al</a> të UPT-së [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Takimet me stafin akademik dhe studentët theksuan njohjen e përmbajtjes së syllabusit në fillim të lëndës dhe detyrimet përkatëse të tyre. Studentët ishin të mirë-informuar në lidhje me masën e frekuentimit në leksione, seminare dhe procedurën e ankimimit në rast kundërshtimi të vlerësimit të bërë nga ana e pedagogut të lëndës [Ref.takime në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive bëhet bazuar në rregulloren kurrikulare të mësimdhënies së UPT-së por edhe në varesi specifike të lëndës [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]. Në këtë drejtim GVJ konstaton:</p> <p>Bazuar në rregulloren e UPT-së format e vlerësimit që ndërmerren në këtë program studimi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Provimi me shkrim;</li> <li>- Provimi me gojë;</li> <li>- Vlerësimi i projektit dhe forma të kombinuara;</li> </ul> <p>Mënyra e organizimit të provimit me shkrim është në funksion të natyrës së disiplinës. Në rregulloren e FTI-së neni 55 përcakton “Vlerësimi i dijeve në FTI kryhet dhe bazohet sipas përcaktimeve të kornizës ligjore në fuqi dhe Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT (kreu V) [Ref.30. Rregullore e brendshme e FTI]. Në rregulloren e programit të studimit neni 17 përcakton “Kontrolli i dijeve në çdo modul bëhet nëpërmjet vlerësimit të detyrave të kursit, pjesëmarrjes në laborator dhe provës përfundimtare, provimit) pa përcaktuar peshën që secila prej tyre zë në masën e vlerësimit përfundimtar të studentit” [101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë-BscTLK]. Në tabelën nr.15 [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK] konstatojmë përcaktimet si vijon më poshtë:</p> <p>Tabela 10: Format e kontrollit të njohurive</p>

Format e kontrollit të njohurive	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve
	Pjesa në % ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	0-30%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	10-40%
Testimet gjatë vitit	10-40%
Provimi përfundimtar	0-100%
Në total	100%

GVJ shqyrtoi me vëmendje syllabuset e paraqitura nga institucioni. Në tërësi GJV gjen në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

### Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Kriteret dhe procedurat për testimin e njohurive të studentit janë përcaktuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies në UPT dhe në syllabuset e lëndëve [103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK; Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]. Testimi i njohurive bëhet gjatë vitit akademik që zhillohet lënda.</p> <p>Provimet zhvillohen në disa sesione:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sesione i provimeve në përfundim të semestrit të parë akademik;</li> <li>- Sesiioni i provimeve në përfundim të semestrit të dytë të vitit akademik;</li> <li>- Sesiioni i provimeve të vjeshtës të cilat zhvillohen kryesisht në Shtator;</li> </ul>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>- Sesione të veçanta të cilat në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi i japin të drejte studentit të përmbushë detyrimet për leëndët e prapambetura;</p> <p>Format e testimit janë përcaktuar qartë ne Rregulloren e UPT-së [12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]. Format testimit përfshijnë kontrollin e pjesshëm gjatë vitit, kontrollin në orë ushtrime, në orët laboratorike në detyrat e kursit dhe provimin përfundimtar. Format e testeve variojnë në varësi të specifikës së lëndës. Studenti informohet në fillim të semestrit për përmbajtjen e syllabusit nga pedagogu i lëndës dhe detyrimet përkatëse të tij [Ref.takime ne institucion].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>FTI bazuar edhe në marrëveshjen që ka me kompaninë Microsoft ka ofruar për studentët dhe stafin akademik paketën e plotë të moduleve të Oficce 365 [Ref.6. Marrëveshjet Institucionale UPT me akademinë dhe industrinë]. Në këtë platformë stafi akademik ka zbatuar edhe sistemin e kontrollit bazuar në modulën Forms. Gjithsesi provimet përfundimtare janë kryer si gjatë kohës së pandemisë edhe aktualisht në auditor duke garantuar ruajtjen e anonimatit dhe duke eliminuar çdo formë abuzimi përmes zbatimit të rregullores në lidhje me organizimin dhe zhvillimin e testeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi bëhet nga një komision i përbërë nga dy anëtarë ku njëri prej tyre është edhe titullari i lëndës. Komisionet aprovohen nga Koordinatorin e programit dhe drejtuesi i DET në fillim të sezonit të provimit dhe datat e provimeve bëhen publike 2 javë përpara sezonit të provimeve për stafin akademik dhe studentët. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës. Në syllabus janë përcaktuar qartë sa % zë pjesa teorike dhe përqindja e orëve të ushtrimeve për çdo lëndë në varësi të specifikës përkatëse të tyre. Tezat firmosen nga drejtuesi i DET dhe një kopje e saj depozitohet në arshiven e njësisë bazë [Ref.76. Procedura për ngritjen e komisioneve të provimeve, shembuj; 103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK; Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të</p>	<p>Provimi përfundimtar bëhet me shkrim dhe i sekretuar. DET i kushton një vëmendje të veçantë ruajtjes së anonimatit dhe për këtë angazhon edhe staf shtesë përurvejtim [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT].</p>

monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive bëhet me pikë dhe konvertohet në notë përfundimtare. Provimet e pjesëshme të zhvilluara gjatë vitit dhe provimi përfundimtar e shoqeron vlerësimin edhe me sqarime aty ku paraqitet e nevojshme. Bazuar edhe në rregulloren e zhvillimit kurrikular të mësimdhënies në UPT, Kreu V pika 9, përcakton se vlerësimi i jepet studentit jo më vonë se 5 ditë nga data e zhvillimit të provimit. Komisioni bën me dije studentin për rezultatin e vlerësimit para plotësimit të dokumentacionit përkatës sipas nenit 36. Studenti ka të drejtën e sqarimit dhe të kundërshtimit të tij duke zbatuar të gjithë procedurat për ankimim jo më vonë se 3 ditë nga data e shpalljes së rezultatit [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT].
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Safi akademik është i kujdesshëm në lidhje me çdo formë abuzimi, kopjimi në detyra kursi dhe provime. Penalitetet zbatohet konform rregullores së percaktuar institucionale të UPT-se. Vëmendje i kushtohet temës së diplomes ku plagjatura nuk tolerohet [Ref.takime ne institucion].
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën e studentit dhe jepen në kohë duke qenë se ato diskutohen mes pedagogut dhe studentit. [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, Kreu V]
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit bazuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies në UPT. Komisioni i provimit ka të drejtë ti japë sqarime studentit përpara se të bëjë zbardhjen e notes përfundimtare të tij [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT].
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Studenti ka të drejtën e kundërshtimit të notës jo më vonë se 3 ditë nga data e shpalljes së notës përfundimtare. Ankesa paraqitet në sekretarinë Dekanit të FTI-së i cili ka të drejtën të kërkojë për sqarim të gjithë palët e përfshira dhe të marrë vendimin në pranimin e notës ose refuzimin e saj aty ku paraqitet që ankesa është e drejtë nga ana e studentit. Çdo vendim i formës së prerë të marrë nga Dekani i FTI-së

	arshivohet në arkivën e FTI-së [Ref.30. Rregullore e brendshme e FTI]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	<b>Në përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve mundëson formim të thelluar shkencor për ushtrimin e iniciativave dhe aftësive vendim-marrëse në situata komplekse, për të punuar në projektimin, integrimin, dhe mirëmbajtjen e sistemeve te elektronikës dhe telekomunikacionit, menaxhim të punës shkencore dhe të sistemeve të telekomunikacionit, si edhe në laboratorë të SI (Sisteme të Informacionit) për fushën e telekomunikacionit duke krijuar një kulturë të gjerë teknike, drejtuese, menaxhuese të aftë si në vendimmarrje, por edhe në aspektin projektues dhe mirëmbajtës [Ref.31. Plani strategjik i zhvillimit të FTI]. Në përfundim të studimeve studenti ka mundësi të merret me :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Projektme në fushën e sisteme të elektronikës dhe telekomunikacionit;</li> <li>b. Zbatime dhe mirëmbajtje të sistemeve TI;</li> <li>c. Menaxhim të punës shkencore dhe të sistemeve te Telekomunikacionit etj;</li> <li>d. Mirëmbajtje dhe kontroll të laboratorëve SI ( sisteme të informacionit) për fushën e Telekomunikacionit;</li> </ul> <p>Spektri i punësimit është i gjerë. Studentët në përfundim të studimeve të tyre mund të punojnë kryesisht në drejtimin e sistemeve të transmetimit të të dhënave në institucione shtetërore apo në kompanitë që operojnë në fushën e elektronikës, telekomunikacionit. Ata kanë fituar aftësite e duhura për tu angazhuar në projekte, zbatime dhe mirëmbajtje të sistemeve përpunues të informacionit, të sistemeve të telekomunikacionit, të rrjetave të transmetimit të</p>



	<p>të dhënave [takime në institucion; 103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK].</p> <p>Gjithashtu ata mund të punësohen brenda ose jashtë vendit ku njehsimi i diplomës nuk paraqet vështirësi pasi programi mësimor në përmbajtjen e tij është i ngjashëm me programe të universiteteve të njohura në Itali dhe në Evropë [103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK; Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK]. Të dhënat statistikore tregojnë që për periudhën 2018-2021 janë diplomuar 233 studentë në këtë program studimi ku 78.9% e tyre janë punësuar në përputhje me fushën e diplomës [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit përfshin një larmi të gjerë lëndësh/modulesh (sipas kategorive nga A në E) të cilat në përputhje me Udhëzimet e MAS përmbushin kërkesat dhe detyrimet. Në programin mësimor janë vendosur edhe dy grupe lëndë me zgjedhje. Në grupin e dytë janë vendosur lëndët: Integrimi Evropian, Siguria dhe Legjislacioni, Historia e Fizikës dhe teknologjitë moderne dhe Ekonomi dhe Menaxhim. Për periudhën 2018-2022 janë zgjedhur si lëndë Ekonomi në Menaxhim dhe Integrimi Evropian. Rishikimi i programit në vitin 2018 ka krijuar një hapësirë të re për dy lëndë me zgjedhje nga kjo kategori në vitin e tretë. Përmes tyre studenti ka mundësi të marre koncepte në lidhje me ekonominë dhe parimet bazë të menaxhimit të cilat e aftësojnë atë në fushën e biznesit edhe në mendurit e një drejtuesi ku përveç aspekteve inxhinierike duhet të japë mendim edhe për zgjedhjet ekonomike. Studenti në vitin e parë zhvillon edhe lëndë "Gjuhë e Huaj" vlerësuar me 5 ECTS. Në programin mësimor janë vendosur si gjuhë të huaja: anglisht, italisht, japonisht dhe frengjisht të cilat krijojnë mundësi studentit të aftësohet në këtë drejtim dhe të ketë më shumë oportunitete dhe mobilitete në programe të huaja [Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Bazuar në kuadrin ligjor ndryshimet për përmirësim në programin mësimor burojnë nga stafi akademik, nga mendimi i studentëve përmes anketimeve të kryera në fund të çdo semestri dhe në analizën e objektivave dhe kompetencave që çdo lëndë ka shprehur në syllabusin përkatës. Koordinator i programi dhe Këshilli i Programit të Studimit janë përgjegjës për rishikimin e syllabuseve dhe ndryshimeve të propozuar nga stafi akademik. Përmirësimet bëhen përmes diskutimeve në department dhe aprovohen më pas në hallkat përkatëse në përputhje me rregulloren institucionale dhe kornizën ligjore</p>




	në fuqi [Ref.94. Procedura e ndryshimeve në planet mësimore].
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Në përmbajtjen e syllabusit janë përcaktuar tematika e orëve të leksionit, ushtrimet, orët laboratorike dhe pesha në ushtrime dhe teori në provimin përfundimtar. Në programin lëndor është përcaktuar edhe një përmbledhje e njohurive që bëhet në javën e fundit të semestrit. Në lidhje me ecurinë e studentit në vitin akademik 2020-2021 ka filluar edhe përcaktimi i njëje tutori për çdo grup mësimor të studentëve proces i cili ka vazhduar edhe për vitin akademik 2021-2022 [Ref.100. Model emërimi i pedagogëve kujdestar për studentët]. Stafi akademik është i hapur për t'ju përgjigjur çdo paqartësi që kanë studentët. Seanca konsultimi kryhen nga stafi akademik bazuar edhe në kërkesën e studentëve përpara zhvillimit të provimeve.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	GVj u njoh përmes evidencave dhe takimeve në institucion për implementimin e orëve të hapura dhe ëorkshop nga profesorë të huaj të ftuar nga institucioni, nga drejtues të kompanive të biznesit si Microsoft, Protik, Vodafone Albania, Albtelekom [Ref.43. Aktivitete shkencore FTI, DET, DII].
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Kompetencat që studenti përfton janë dhënë në programet leëndore. Në syllabuse janë përcaktuar qartë tematika e orëve të laboratorit dhe frekuentimi i saj në masën 100% të detyrueshëm është një indikator që tregon rëndësinë që institucioni i kushton aftësisimit praktik të studentëve. FTI zotëron një infrastrukturë të duhur për të mundësuar orët laboratorike. Këto zhvillohen në mjedise të përshtatshme dhe mbështeten nga një staf ndihmës-akademik me përvojë. Praktikrat profesionale kryhen në kompani të njohura me të cilat institucioni ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi. DET monitoron procesin e zhvillimit të praktikës profesionale dhe relacionet e përgatitura vlerësohen nga një komision kompetent [Ref.takime në institucion].
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Në programet lëndore detyrat dhe projektet e kursit mbizotërojnë në grup ku diskutimet janë të shumta [Ref.takime në institucion; Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK]. Përgatitja e temës së diplomës është subjekt diskutimi jo vetëm i studentit me udhëheqësin e tij por edhe me stafin akademik në department ku prezantime paraprake bëhen nga ana e studentëve në lidhje me progresin e punës së tyre dhe zgjidhjet e propozuara.

<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Stafi akademik inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në thirje dhe projekte kërkimore shkencore. Ndonëse programi i përket ciklit të parë të studimeve, GVJ vëren një angazhim të studentëve në punë individuale dhe në projekte kërkimore shkencore [Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK, tabela 22]. Në total janë aktivizuar 19 studentë në projekte shkencore në nivel departamenti, nivel fakulteti dhe në projekte shkencore në bashkepunim me palë të tjera.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Ndër objektivat strategjike të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” është të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve si edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj [Ref.3. Plani strategjik UPT 19-24]. Kjo mund të arrihet, ndërmjet të tjerash, nëpërmjet krijimit të një baze financiare të qëndrueshme që mundëson infrastrukturë të përgjithshme për sistem edukimi, paisje dhe akomodim për mësim, materiale mësimore si dhe mjedis social.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Institucioni mbështet dhe inkurajon studentët që të përfaqasin idetë më inovatore. Shumë prej studentëve të diplomuar tashmë janë lider në fushën e telekomunikacioneve dhe sipërmarrës të suksesshëm. Mobiliteti i studentëve është një mbështetje që institucioni i jep studentëve përmes dhënies së mundësisë në shkëmbim përvoja dhe eksperience në universitete pritëse në kuadër të Erasmus+ [Ref.91. Lista e studentëve të përfshirë në aktivitetet kërkimore shkencore].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi III.8</b> <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Punimi i temës së diplomës është përcaktuar të zhvillohet në programin mësimor në semestrin e dytë të vitet të III-të. Procedura e zhvillimit të procesit të diplomës është dhënë qarte përmes dispozitave të në Kreun VIII të rregullores së zhvillimit kurrikular të mësimdhënies në UPT [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]. Studentët</p>




	<p>janë të njohur me programin e studimit dhe në përfundim të semestrit të parë kanë të drejtën të zgjedhin udhëheqësin e diplomës në bazë të listës së publikuar nga DET [Ref.30. Rregullore e brendshme e FTI neni 61 pika 7]. Si udhëheqës temë diplome angazhohet stafi akademik PAE [Ref.85. Lista e pedagogëve udhëheqës për punimet e diplomave FTI]. FIT ka hartuar një manual për punimin e diplomës e cila respektohet nga studentët gjatë përgatitjes së temës së diplomës [Ref.104. Udhëzues për punimin e diplomës Bachelor-BscTLK]. Në takimin me stafin akademik u thekua vëmendja e veçantë që i jepet në vlerësim paraqitjes së punimit të studentit në përputhje me kërkesat e dhëna në këtë manual [Ref.takim me stafin akademik].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Diplomimi bëhet me përgatitjen e temës së diplomës e cila bazuar edhe në Kreun VIII të rregullores së zhvillimit kurrikular të mësimdhënies në UPT është një punim në formën e një projekti ose përmbledhje punimesh të kryera në fushat e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve”. Zgjedhja e temës së diplomës bëhet në diskutim me udhëheqësin e temës së diplomës dhe aprovohet në department [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, neni 54]. Në mbështetje të përgatitjes së temës së diplomës DET vë në shërbim të studentëve manualin mbi punimin e saj. Stafi akademik dhe ndihmës janë në dispozicion të studentëve gjatë punës së tyre në përgatitjen e temës [Ref.104. Udhëzues për punimin e diplomës Bachelor-BscTLK]. Biblioteka vë në dispozicion literaturë ndihmëse shtesë sipas kërkesave të studentëve [Ref.65. Biblioteka dhe burimet bibliotekare në dispozicion të FTI]. DET vë në dispozicion të studentëve edhe laboratorët në rastet kur puna në laborator është pjesë e zhvillimit të temës [Ref.64. Infrastruktura laboratorike në funksion të programeve të studimit FTI]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Referuar RVB-së, dhe takimeve në institucion, FTI në të gjitha programet e ciklit Bachelor, mbrojtjen e studimeve e bëjnë me teme diplome. Në funksion të këtij procesi është hartuar edhe Udhëzuesi për punimin e diplomës. [104. Udhëzues për punimin e diplomës Bachelor-BscTLK]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për</p>	<p>GVJ në takimet e zhvilluara në institucion konstaton se procedura e përgatitjes së temës së diplomës është konform</p>

<p>përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>dispozitave të rregullores së zhvillimit kurrikular të mësimdhënies në UPT dhe Rregullores së FTI-së. [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT; Ref.30. Rregullore e brendshme e FTI].Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës duke përcaktuar edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Udhëheqësi përgatit edhe orët e konsultimeve sipas një grafiku dhe përmes së cilës ai kontrollon edhe ecurinë e punës së panvarur të studentit në drejtim të përgatitjes së temës së diplomës. DET organizon dy seanca të veçanta përmes së cilave kontrollon punën e zhvilluar nga studenti në drejtim të punimit të temës së diplomës [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, neni 55].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>RVJ konstatoi se egzistojnë të gjitha mundësitë për të shfrytëzuar bazën laboratorike të FTI-së për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit. Gjithashtu, DET ofron mundësi tek studentët gjatë përgatitjes së temës së diplomës për të kryer matje apo teste edhe në laboratorë të veçantë që UPT disponon në njësi të tjera bazë apo në kompani private bazuar në marrëveshjet e nënshkuara institucionale [Ref.6. Marrëveshjet Institucionale UPT me akademinë dhe industrinë.]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i temës së diplomës asiston studentin bazuar në grafikun e punës së hartuar dhe rënë dakord me të [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]. Ai asiston edhe në matjet kryesore dhe vlerëson përpunimin e rezultateve. Udhëheqësi i temës së diplomës udhëzon studentin të përgatisë temën bazuar në kërkesat e manualit të punimit të temës së diplomës. Ai asiston studentin edhe gjatë dy sesioneve të kontrollit që DET kryen për të monitoruar progresin e studentëve gjatë përgatitjes së temës së diplomës. Udhëheqësi kur është i bindur se punimi i kryer nga studenti përmbush standartet e kërkuara e nënshkruan atë dhe jep aprovimin për paraqitjen e saj në komisionin e mbrojtjes së temës së diplomës [Ref.104. Udhëzues për përpunimin e diplomës Bachelor-BscTLK; Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT].</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Organizimi i mbrojtjes së temës së diplomës dhe vlerësimi i saj janë përcaktuar në dispozitat e Kreut VIII, neni 57 të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies në UPT. Tema e diplomës mbrohet përpara një komisioni të posaçëm i cili propozohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe miratohet nga Dekani i FTI-së dhe përbëhet nga 3-5 anëtarë. Mbrojtja e temës së diplomës është publike. Komisioni vlerëson paraqitjen e</p>

	punimit të temës së diplomës, merr në konsideratë vlerësimin nga recensuesi i diplomës, si edhe përgjigjet që studenti ka dhënë në lidhje me pyetjet e ngritura nga Komisioni i Posaçëm. Vlerësimet e çdo anëtari të komisionit pasqyrohen në proces verbal dhe nota është mesatarizim i vlerësimit që çdo anëtar i komisioni ka dhënë për punimin e paraqitur nga studenti [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT neni 58].			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Njohja e diplomës për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve është bërë përmes vendimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.765 Prot date 06.02.2006. Regjistrimi i formës së diplomës për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve në regjistrin shtetëror të diplomave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor është bërë përmes Urdhërit Të Ministrisë Së Arsimit Sportit dhe Rinisë nr.201 date 29.04.2021. Në përfundim të studimeve të ciklit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve”, studentit i vihet në dispozicion diploma (sipas modelit të miratuar nga MASR) dhe suplementi i diplomës së bashku me listën e notave [Ref.105. Formati i Diplomës bachelor-BscTLK.; Ref.106. Suplementi i diplomës-BscTLK].			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopja e plotë e programit të studimit të zhvilluar. Studenti ka të drejtë të tërheqi një kopje të programit në çdo kohë që ai e sheh të arsyeshme [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT.]			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	FTI dhe DET zbatojnë një sistemi arkivimi të materialeve dhe dokumentacionit në përputhje me ligjin e Arkivave, konform kuadrit ligjor në fuqi dhe rregullores institucionale të UPT-së. Dokumentacioni i studentëve në përfundim të studimeve të tyre ruhet në një kopje në të njëjtën përmbajtje me dosjen që studenti ka pasur gjatë zhvillimit të studimeve. Në raste këkese nga ana e studentit pas diplomimit të tij, strukturat bazë japin sqarime dhe vërtetime apo referenca nëlidhje me ciklin e studimeve që studenti ka kryer në këtë program studimi [Ref.88. Shërbimi i sekretarisë mësimore, orari i hapjes dhe model Formularësh]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takim me përfaqësuesin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Gjatë këtij takimi në bazë të dokumentacionit që u vu në dispozicion GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësues dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi, që përfshin diplomat, çertifikat e ndryshme, vërtetimet për gradat akademike, CV-të, kontratat e punës, librezë shëndetsore, dëshmia e anglishtes, kërkesa e punësimit etj. Kjo gjë u konstatua gjatë shqyrtimit të disa dosjeve të protokolluara, të cilat u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme nga GVJ.</p> <p>Në bazë të dokumentave [Ref.55. Procedurë për rekrutim stafit akademik PAE dhe PAK, Ref.58. Model kontrata individuale e punës personeli PAE dhe PAK, Ref.84. Formati i dosjes personale të stafit.] të dhënat e stafit efektiv dhe me atij me kontratë administrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në nivel institucional dhe nga njësi kryesore dhe njësitë bazë për program studimi. I gjithë informacioni administrohet duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave personale dhe arkivohen konform akteve rregullatore institucionale [Ref.13. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UPT].</p> <p>Pjesë e përpunimit të të dhënave është edhe parashikimi i ngarkesës mësimore për stafin efektiv dhe me kontratë që do të angazhohet në këtë program studimi në fillim të secilit vit akademik. Në përfundim të vitit akademik, administrohet edhe evidencat e detajuara për plotësimin e orëve mësimore [Ref.45. Model evidencë për raportimin e zhvillimit mësimor].</p> <p>GVJ përmes dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe takimeve të zhvilluara konstatojmë një korrektësi të zbatimit të</p>

	<p>procedurës së administrimit të të dhënave të personelit akademik, ndihmës-akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit duke u bazuar në Statutin e UPT dhe në rregulloret e brendshme harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik. Njësia bazë harton kriteret e punësimit për personelin akademik dhe ndihmës-akademik ku ofrohet pozicioni vakant dhe miratohen nga Rektori [Ref.1. Statuti i UPT, Neni 42]. Kriteret përcaktohen në varësi të nevojave specifike të kurrikulës dhe disiplinave shkencore përkatëse. Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës-akademik kryhet me konkurrim, përmes thirrjeve të hapura. Shpallja e thirrjeve bëhet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike e UPT, online përmes <a href="http://www.upt.al">www.upt.al</a> (rubrika vende pune) në mënyrë që të jenë lehtësisht të aksesueshme nga kushdo. Thirrjet shpallen edhe përmes faqes zyrtare ueb të njësisë kryesore, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit [<a href="http://www.fti.edu.al">www.fti.edu.al</a>] [Ref.60. Model njoftimi në faqen ueb të FTI-së] dhe publikohen edhe në rrjete sociale [Ref.56. Shembull konkursi PAE dhe PAK në FTI].</p> <p>Vlerësimi dhe përzgjedhja e kandidatave kryhet përmes komisioneve “ad-hoc”, me shumicë anëtarësh nga njësia bazë, në përputhje me përcaktimet e Statutit dhe me procedurat e punësimit në UPT [Ref.55. Procedurë për rekrutim stafi akademik PAE dhe PAK].</p> <p>Punësimi i personelit në institucion përmbillet me lidhjen e kontratës nëpërmjet Rektorit të UPT si punëdhënës dhe kandidatit fitues si punëmarrës [Ref.58. Model kontrata individuale e punës personeli PAE dhe PAK], [Ref.56. Shembull konkurs PAE dhe PAK në FTI]</p> <p>GVJ nga dokumentacionet e shqyrtuara konstaton se procedurat për rekrutimin e personelit akademik, janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kriteret e punësimit për personelin akademik dhe ndihmës-akademik hartohen nga njësia bazë ku ofrohet pozicioni vakant dhe miratohen nga Rektori [Ref.1. Statuti i UPT, Neni 42]. Kriteret përcaktohen në varësi të nevojave specifike të kurrikulës dhe disiplinave shkencore përkatëse. Shpallja e thirrjeve bëhet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike e UPT, online përmes <a href="http://www.upt.al">www.upt.al</a> (rubrika vende pune) në mënyrë që të jenë lehtësisht të aksesueshme nga</p>






	<p>kushdo. Thirrjet shpallen edhe përmes faqes zyrtare web të njësisë kryesore, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (www.fti.edu.al). Me publikimin e shpalljes së vendit vakant si më sipër, kandidatëve potenciale ju jepet mundësia të depozitohen dokumentacionin përkatës brenda afatit të përcaktuar në njoftim. [Ref.56. Shembull konkursi PAE dhe PAK në FTI]. Kriteret e punësimit sanksionojnë zhvillimin e një konkursi publik, të hapur dhe të paanshëm.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në Statutin e UPT, [Ref.1. Statuti i UPT]. përcaktohet procedura e rekrutimit, e zhvillimit të konkursit, si dhe e ngritjes së Komisionit Ad Hoc. [Ref.55. Procedurë për rekrutim stafi akademik PAE dhe PAK]. Kompetenca themelore e këtij komisioni të posaçëm është shqyrtimi i pajtueshmërisë së dokumentacionit të depozituar nga ana e kandidatëve, me kriteret e përgjithshme të përcaktuara në ligj dhe rregullore, si dhe kriteret specifike të përcaktuara nga njësisia bazë. [Ref.57. Format skede pikëzimi dhe vendimi komisioni ad hoc për rekrutim personel akademik]. [Ref.55. Procedurë për rekrutim stafi akademik PAE dhe PAK; Ref.56. Shembull konkursi PAE dhe PAK në FTI].</p> <p>Nga shqyrtimi i dosjeve të personelit dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka nivelin e duhur akademik në përputhje me përmbajtjen e moduleve apo lëndëve që ata japin mësim.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës në FTI si edhe mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni [“Ref.3. Plani strategjik UPT 19-24, Dokumentacion mbi asetet, objektet në përdorim FTI, Ref.49. Procedura mobilitet stafi akademik, student dhe Ref.48. Procedurë mbështetje stafi akademik për kërkimin shkencor dhe trajnime”] u konstatua se institucioni ofron mjedise të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të</p>

	<p>personelit si p.sh. zyra komode, laboratore për zhvillim të mësimdhënies dhe projekteve të tyre, pajisje teknike, internet falas, etj. Gjatë takimit me stafin akademik GVJ u informua se mjediset në ambjentet e reja të FTI janë me kushte të përshtatshme dhe bashkëkohore, aksesit në bibliotekën shkencore si edhe në atë online ju ka mundësuar atyre kryerjen e detyrave në mënyrë sa më profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimit me stafin akademik të FTI ([Ref.31. Plani strategjik i zhvillimit të FTI]; [Ref.48. Procedurë mbështetje stafi akademik për kërkimin shkencor dhe trajnime].) GVJ konstatoi se institucioni nxit kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik duke ju ofruar mundësi financimi për zhvillimin dhe publikimin e rezultateve nga kërkimet e tyre shkencore, si dhe e mbështet stafin për trajnime dhe avancim akademik dhe shkencor. Disa trajnime ofrohen përmes marrëveshjeve Erasmus+ apo projekteve në nivel institucioni apo njësie kryesore. [Ref.44. FTI - pjesëmarrje në projekte]; [Mobilitetet e stafit dhe studentëve Erasmus 2021-2022] [Ref.49. Procedura mobilitet stafi akademik, student]; [Ref.50. Listë trajnimesh, pjesëmarrje në mobilitete për stafin akademik].</p> <p>Stafi akademik në fillim të vitit akademik bën parashikimin për aktivitetin shkencor dhe institucioni mbështet zhvillimin e aktiviteteve shkencore si konferenca, seminare apo orë të hapura të cilat mundësojnë jo vetëm rritjen profesionale të stafit por edhe sigurojnë një rritje të bashkëpunimeve si me institucione të tjera të arsimit të lartë ashtu edhe me aktorë të industrisë dhe biznesit të lidhur ngushtësisht me profilin e institucionit. [Ref.43. Aktivitete shkencore FTI, DET, DII; [Ref.78., Shembulli i orëve të hapura]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit koordinohet nga FTI dhe nga strukturat përkatëse të ngritura në UPT që janë Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) dhe Drejtoria e Kurrikulave (DK) [Ref.9. Organigrama UPT]. Këto struktura janë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Mbështetja e mobiliteteve të stafit akademik, organizimi i konferencave me pjesëmarrjen ndërkombëtare janë disa nga politikat për kualifikimin e personelit akademik dhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies që institucioni ndjek. ([Ref.48. Procedurë mbështetje stafi akademik për</p>

	kërkimin shkencor dhe trajnime], [Ref.50. Listë trajnimesh, pjesëmarrje në mobilitete për stafin akademik], [Ref.43. Aktivitete shkencore FTI, DET, DII]. [Ref.78., Shembulli i orëve të hapura].)			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Në fillim të çdo viti akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës mësimore, e cila aprovohet nga drejtuesi i njësisë bazë. Takimet e zhvilluara, dokumentacioni i paraqitur janë tregues të një shfrytëzimi me efikasitet të kapacitetit njerëzor, të stafit akademik dhe të stafit ndihmës mësimor jo vetëm në këtë program studimi por edhe në programe të tjera studimi brenda FTI ku stafi akademik i kësaj njësie bazë angazhohet. <i>Shënime nga vizita</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Suk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe gjatë vizitës në institucion, u konstatua se Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse.  Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” e zhvillon aktivitetin didaktik në ambientet e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. FTI, vendosur në godinën e re të përfunduar së ndërtuari në vitin 2016 pranë Korpusit Qëndror të UPT. Gjithashtu FTI ka në përdorim edhe mjediset nga kampusi qendror. Hapësirat në dispozicion për këtë program studimi janë të shpërndara si në tabelën më poshtë:												
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset e tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit</th> <th>Sasia</th> <th>Sipërfaqja</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Salla për leksione</td> <td>10</td> <td>1184.57</td> </tr> <tr> <td>Klasa për seminare</td> <td>7</td> <td>415.92</td> </tr> <tr> <td>Laboratorë për lëndët</td> <td>7</td> <td>484.98</td> </tr> </tbody> </table>	Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia	Sipërfaqja	Salla për leksione	10	1184.57	Klasa për seminare	7	415.92	Laboratorë për lëndët	7	484.98
Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia	Sipërfaqja											
Salla për leksione	10	1184.57											
Klasa për seminare	7	415.92											
Laboratorë për lëndët	7	484.98											

Zyrë informacioni për studentët	1	12.31
Korridore/holle	6	1335.23
Nyje hidrosanitare për studentët	18	204.24
Biblioteka dhe laboratorë nga njësi të tjera në UPT	2500	
<b>Norma m2/për student</b>	<b>6137.25 m2/ 1180 studentë = 5.2 m2/student</b>	
<b>Mjediset për stafin:</b>	<b>Sasia</b>	<b>Sipërfaqja</b>
Zyra për Dekanin/zyrë mbledhjesh	5	193.71
Zyra për sekretarinë mësimore	2	53.43
Zyra për departamentet	3	74.45
Zyra për personelin akademik të departamenteve	14	555.68
Zyrë për financën	2	58.94
Zyrë për Njësinë e SBC		
Zyrë për Koordinimin dhe Mbështetjen ndaj Studentëve / Zyrë IT	1	24.42
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	10	102.13
<b>Norma m2/për person</b>	<b>1062.75 m2/ 56 persona = 19 m2/person</b>	

[Ref.35. Dokumentacion mbi asetet, objektet nëpërdorim FTI].

GVJ evidenton një shpërndarje më të mirë të ambienteve brenda godinës në funksion të programit të studimit dhe krijimin e hapësirave për disa struktura mbështetëse siç është Zyrë për Koordinimin dhe Mbështetjen ndaj Studentëve / Zyrë IT ( 24.42m<sup>2</sup>), zyrë informacioni për studentët (12.31m<sup>2</sup>), Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj (102m<sup>2</sup>) por konstaton mungesë të sallës për aktivitete promovuese, të mjedisit për aktivitete studentore, rekreative, mjediseve sportive për të cilat rekomandojmë të konsiderohen nga institucioni në vijim të plotësimit të kushteve për një ambient ndërveprues studentor.

**Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.

Gjatë vëzhgimit të mjediseve të auditorëve dhe laboratoreve nga GVJ u vu re sa ato ishin të pajisur me aparaturave të nevojshme dhe specifike, gjithashtu edhe me instrumente ndihmëse sikurse janë video-projektorët dhe printera të lidhur në rrjet. Për zhvillimin e aktiviteteve laboratorike, në dispozicion të studentëve të Inxhinierisë Elektornike janë laboratorët e Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit si dhe laboratorët e Departamentit të Inxhinierisë Informatike. Laboratorët mbështesin lëndët përkatëse të cilat mbuloohen nga stafi akademik i të dy departamenteve.

Laboratorët kërkimor-shkencor të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës janë gjashtë si në vijim:

- Laboratori i Radiofrekuencës dhe Komunikimeve Optike
- Laboratori i Telekomunikacionit, Sistemeve të sigurisë dhe Sistemeve të Informacionit
- Laboratori Multimedial dhe Sistemet e Rindërtimit 3D
- Laboratori Embedded systems
- Laboratori i Inxhinierisë së Softit dhe Inteligjencës Artificiale
- Laboratori i Arkitekturave, Sistemeve Operative dhe Rrjetave

[Ref.64. Infrastruktura laboratorike në funksion të programeve të studimit FTI].

Në funksion të transmetimit të njohurive, për zhvillimin e aktiviteteve laboratorike të parashikuara në planin mësimor, janë në dispozicion edhe laboratorë të njëjësive bazë në fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIMIF) që mbështesin lëndët e fizikës dhe kimisë, gjithashtu edhe laboratorët e njëjësive bazë në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike (FIE) që mbështesin lëndët bazë të elektroteknikës dhe matjeve elektronike. Laboratorët janë të pajisur me pajisje fizike të nevojshme si:

- Oshiloskop,
- gjenerator sinjali dhe
- makete didaktike në:
  - studimin e qarqeve elektronike digjitale
  - për të studiuar teknika e modulimit,
  - për të analizuar sensorët dhe shndërruesit,

	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ për të studiuar transmetimet me fibra optike, etj.</li> </ul> <p>Laboratorët informatikë me një numër të mjaftueshëm kompjuterash për të zhvilluar të gjitha ato aktivitete didaktike të cilat bazohen në zhvillimin e simulimeve të ndryshme si në analizën e qarqeve lektronike, protokollet e rrjetave të telekomunikacionit, teknikat e procesimit të sinjalit etj. Të gjitha këto laboratorë janë të lidhur në rrjetin Internet në dispozicion të studentëve. [Ref.59. Infrastruktura dhe shërbime IT në FTI].</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni, sikurse përmendet edhe në Kriterin 3 më sipër, ka në dispozicion gjashtë laborator të teknologjisë së informacionit të pajisur me programe profesionale në funksion të aktivitetit didaktik dhe programeve të studimit që ofron. Këto laboratorë janë në një përditësim të vazhduar bazuar në nevojat dhe kërkesat e njësive bazë përkatëse. ([Ref.64. Infrastruktura laboratorike në funksion të programeve të studimit FTI], [Ref.36. Buxheti FTI procedura e miratimit dhe hartimit].)</p> <p>Nga biseda me studentët, këto laboratorë aksesohen prej tyre jo vetëm gjatë orëve të parashikuara për lëndët përkatëse, por mund të aksesohen sa herë e kanë të nevojshme edhe nën kujdesin e laboranteve në laboratore.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale institucioni vë në dispozicion jo vetëm mjediset e tij por edhe ato të ofruara nga institucionet me të cilat bashkëpunon. Për çdo praktikë të ndjekur nga studentët hartohen raportet përkatëse nga studenti mbi gjithçka që ka zhvilluar gjatë peridhës së praktikës. ([Ref.64. Infrastruktura laboratorike në funksion të programeve të studimit FTI], [Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK])</p> <p>Nga dokumenti i marrvëshjeve GVJ konstatoi se UPT ka marrvëshje me 79 Kompani Private, me 17 Institucione Shtetërore brenda vendit, me 18 Universitete Kombëtare, me dhe me 28 Universitetet Europiane. Bashkëpunimi me institucione dhe subjekte të tjera organizohet si në nivel institucioni, por edhe më specifikisht për këtë program studimi, në nivel njësie kryesore dhe asaj bazë. [Ref.6. Marrvëshjet Institucionale UPT me akademinë dhe industrinë].</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="576 1883 767 1982"></td> <td data-bbox="767 1883 959 1982">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="959 1883 1150 1982">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1150 1883 1370 1982">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		


**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga verifikimi në institucion dhe dokumentat e dorëzuara [Ref.65. Biblioteka dhe burimet bibliotekare në dispozicion të FTI]. studenteve të FTI, i është ofruar qasje tek bibliotekat e universitetit të UPT përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bibliotekën Shkencore Qendrore të UPT,</li> <li>• Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike &amp; Inxhinierisë Fizike si dhe</li> <li>• “Qendra Multimediale” e përbashkët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.</li> </ul> <p>Orari është 8:30-6:30 PM ditëve të javës, dhe të shtunave 8:30-1:30pm.</p> <p><i>Sygjerojme që të shtohen dhe mundësohet salla studimi të mirëfillta me orar të zgjatur deri me 20:00, duke pasur parasysh rëndësinë dhe shkallën e vështirësisë së degës e cila kërkon impenjim të jashtëzakonshëm</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizitat në institucion nënvizojmë se bibliotekat kane të mireorganizuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Artikujt bashkohur shkencor: Biblioteka Shkencore ka 65570 tituj ku me literaturë bashkëkohore me profil tekniko-shkencor, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, në fushat e interesit të studentëve dhe stafit akademik të UPT.</li> <li>• Qendren elektronike multimediale: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ libra të huaj / 660 tituj (754 njësi)</li> <li>○ libra shqip / 226 tituj (287 njësi)</li> <li>○ Periodike / 8 tituj (76 njësi)</li> <li>○ Punime shkencore dhe dorëshkrime, artikuj shkencorë (102 njësi)</li> <li>○ Fondi referencial (enciklopedi, fjalorë e tj.) (34 njësi)</li> <li>○ CD-ROM (168 njësi)</li> </ul> </li> </ul>




	<p>o Kasete audio-vizuale /58 (cikël leksionesh) (1160 njësi)</p> <p><i>Sygjerojme që të ketë abonime të përvitëshme në revista prestigjioze ndërkombetare të cilat nuk trajtojnë vetëm artikuj shkencor por edhe artikuj të mirefillte teknik me shembuj konkret të implementimit të zgjedhjeve teknike të ndryshme, kjo për arsye që studentët të kenë një qasje sa teorike ashtu edhe praktike të problemeve të ndryshme inxhinierike.</i></p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Politeknik i Tiranës, përveç literaturës se shtypur ofron edhe akses ne bibliotekat elektronike online siç janë JSTOR [http://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1544-njoftim-per mundesine-e-studenteve-dhe-stafit-te-universitetit-politeknik-te tiranes-per-te-shfrytezuar-biblioteken-digjitale-jstor] dhe ULIBRARY [https://ulibrary.rash.al/]. Studentët dhe stafi akademik mund të shfrytezojnë materialet ne forme elektronike nga kompjuterat e vendosura ne dispozicion. Aksesit është i lirë për të gjithë studentet dhe i disponueshëm në çdo kohe. Gjithashtu është funksional sistemi i katalogimit dhe kërkimit në bibliotekën e Universitetit Politeknik të Tiranës, COBISS [https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries]</p> <p>[Ref. 65. Biblioteka dhe burimet bibliotekare në dispozicion të FTI].</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Qendra Multimediale ka kapaciteti fizik 32 vende/poste pune-kërkimi dhe ofron shërbimet: Shërbimi në fond të hapur i koleksioneve; Katalogu elektronik (COBISS – UPTFIE); Kartë elektronike anëtarësimi, Interneti (wireless), Fotokopje; Burimet elektronike; Shërbimin me projector. [Ref.65. Biblioteka dhe burimet bibliotekare në dispozicion të FTI].</p> <p>Nga ana e qasjes në literaturë elektronike biblioteka ka arritur të jetë e ndërlidhur ne rrjet mjaft të gjere COBISS, FGJM, FIE dhe FIN/FAU me mbi ~200 mije libra, ~50 mije revista, 200 milion lajme shkencore, dhe paketa per mësimin e gjuhëve elektronike.</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>FTI ka pasuruar me 71 tituj të rinj fondin e Bibliotekës sipas tabelës së mëposhtme:</p> <table border="1" data-bbox="587 1720 1362 1966"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Numri i librave</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>35</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>30</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Numri i librave	2018-2019	35	2019-2020	30	2021-2022	6
Viti akademik	Numri i librave								
2018-2019	35								
2019-2020	30								
2021-2022	6								






	<p>Kjo literature përdoret nga stafi akademik dhe studentët. Kërkesat për titujt e rinj mblidhen çdo vit në njësitë kryesore, duke siguruar kështu përputhshmërinë e tyre me kurrikulat mësimore dhe fushat e kërkimit shkencor. [Ref.66. Shtimi i fondeve të bibliotekës FTI 2018-2021]</p> <p>Gjithashtu, për pasurimin e fondit, BSH bazohet edhe në kërkesat e përdoruesve. Përveç blerjeve, pasurimi i fondit bëhet edhe përmes dhurimeve dhe shkëmbimeve me bibliotekat e tjera duke u fokusuar në profilin teknik dhe shkencor të koleksionit të BSH. Ndërkohë në nivel institucioni, po zbatohet projektit për Automatizimin dhe Digjitimimin e BSH. Aktualisht është duke u zhvilluar procedura e prokurimit për pajisjet e nevojshme për funksionimin e sistemit, që do të mundësojë vënien e tij në punë. I gjithë aktiviteti i bibliotekës do të administrohet dhe aksesohet online përmes sistemit të integruar bibliotekar ILS KOHA [<a href="https://kohacommunity.org/">https://kohacommunity.org/</a>]. Ndërkohë është zhvilluar edhe faqja e re ueb, e dedikuar për bibliotekën shkencore, e aksesueshme në [<a href="https://biblioteka-shkencore.edu.al/">https://biblioteka-shkencore.edu.al/</a>].</p> <p>Përtej sistemit të katalogimit dhe kërkimit COBISS [<a href="https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries">https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries</a>], i cili është funksional, prej vitit 2019 ofrohet edhe shërbimi i bibliotekës digjitale [<a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a>]. Biblioteka digjitale mundëson aksesin në një databazë me mbi 193 mijë libra akademikë, mbi 50 mijë revista shkencore, mbi 200 milion lajme shkencore si dhe 30 paketa për mësimin e gjuhëve të huaja.</p>				
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Sipas referencave studentet kanë akses në bibliotekat dhe sallat e tyre përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bibliotekën Shkencore Qendrore (BSHQ)</li> <li>• Biblioteka e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit (BFIN)</li> <li>• Biblioteka e Fakultetit Gjeologji Miniera (BFGJM)</li> </ul> <p>Në orarin 08:30 – 17:30 gjate javes mesimore dhe të shtunave nga 08:30-13:30.</p> <p>[Ref.65. Biblioteka dhe burimet bibliotekare në dispozicion të FTI]. [<a href="https://biblioteka-shkencore.edu.al/aksesimi-ne-bsh/">https://biblioteka-shkencore.edu.al/aksesimi-ne-bsh/</a>]</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="561 1877 762 1973">Përmbushet</td> <td data-bbox="762 1877 963 1973">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="963 1877 1165 1973">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1165 1877 1369 1973">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

				X
--	--	--	--	---

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Përgjatë vizitës në institucion nga GVJ, përkatësisht në sekretarinë mesimore, na u tregua se është në përdorim programi informatik i menaxhimit të të dhënave, me ane të të cilit regjistrohen dhe ruhen të gjithë të dhënat e studenteve, nga fillimi i regjistrimit të tyre për herë të parë deri në diplomimin e tyre. Të dhënat e studenteve përmbanin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Detyrimet nga frekuentimi i lëndëve;</li> <li>• Detyrimet nga laboratorë;</li> <li>• Detyrimet nga projektet e kursit;</li> <li>• Vlerësimin përkatës etj;</li> </ul> <p>Sistem tjetër në përdorim te sekretarisë është u-albania, si pjesë e të gjitha universiteteve ku kryen regjistrimin për herë të parë të studenteve në universitet. Nga takimet në institucion dhe dokumenteve referuese, pjesë e paketës se programeve është edhe Office 365, me anë të së cilës është kryer mësimdhënia gjate periudhës së gjendejes së jashtzakonshme përshkak të pandemisë Sars-Cov-2.</p> <p>[Ref.63. Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mesimore dhe studentët]. [Ref.62. Platformë softuerike në përdorim nga dhe për studentët, office 365]. [Ref.17. Vendim mbi zhvillimin e procesit akademik në platforma online].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga takimi me sekretarinë mesimore dhe stafin akademik, na u shpjegua se Programi i menaxhimit të të dhënave, realizon për stafin akademik administrimin e të dhënave përkatëse, planin mësimor, shfaqjen e raporteve te grupeve mesimore, hedhjen notave apo komenteve përkatëse. Nga ana tjetër, platforma e Office 365, u ka dhënë mundësi që të ofrohen adresa email-i për çdo individ në fakultetin përkatës, duke mundësuar grupimin në bazë të klasës dhe komunikim të qendëruar student lektor. Gjithashtu për çdo idivid u është dhënë në dispozicion një hapësirë ruajtje në cloud nëpërmjet modulit one drive të Office 365. Module të tjera të rëndësime për tu përmendur janë Teams, i cili është përdorur gjatë</p>

	<p>periudhës së Pandemise. [Ref.62. Platformë softuerike në përdorim nga dhe për studentët, office 365]. [Ref.63. Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Programet e menaxhimit të dhënave dhe Office 365, u japin akses të dedikuar si studenteve ashtu edhe stafit akademik. Nëpërmjet tyre studentet njihen me listën lëndeve të vitik akademik, orarin, realizimin e detyrimeve, komunikimet ne grup apo inividualisht nëpërmjet emailit, dhe shkëmbimin e të dhënave. [Ref.62. Platformë softuerike në përdorim nga dhe për studentët, office 365]; [Ref.63. Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përdorimi i platformës globale Office 365 ka lehtësuar tejmasë komunikimin dixhital mes studentëve dhe stafit akademik jo vetëm gjatë përdorimit në periudhën e pandemisë, por edhe në njoftimin në nivel klase apo shkëmbimin e materialeve të nevojshme student -staf akademik ashtu edhe student-student. Kjo gjë u vlerësua si nga stafi akademik dhe nga studentët gjatë takimeve në institucion. [Ref.62. Platformë softuerike në përdorim nga dhe për studentët, office 365]; [Ref.17. Vendim mbi zhvillimin e procesit akademik në platforma online].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Gjatë përshkrimit të funksionaliteteve të sistemit të menaxhimit shfaqet qartë që studentet kanë raporte të qarta mbi detyrimet, në secilën lende, laborator, projekt kursi, sikurse notat e marra në provimet përkatëse. Gjithashtu nëpërmjet raporteve të gjeneruara në sistem, stafi drejtues vëzhgon publikimin e kërkesave dhe të dhënave të stafit akademik sikurse respektimin e afateve të raportimit të vlerësimit të studenteve. Modul specifik i përdorur per efekt raportimi në platformën Office 365 është “insight” i cili ka realizuar në mënyrë të përmbledhur raporte mbi: përdorimin e moduleve të Office 365, statistika të postimeve të studenteve dhe stafit akademik, përfshirjen e studenteve në Teams etj.</p> <p>[Ref.63. Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët]; [Ref.62. Platformë softuerike në përdorim nga dhe për studentët, office 365]; [Ref.53. Përdorim Skype for Business si pedagog]; [Ref.45. Model evidencë për raportimin e zhvillimit mësimor].</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e</p>	<p>Universiteti Politeknik i Tiranës shfaqet në dy faqe web-i përkatësisht <a href="http://www.UPT.edu.al">www. UPT.edu.al</a> edhe <a href="http://www.UPT.al">www.UPT.al</a>. Tek faqja e parë shfaqet që është në ndërtim dhe ju lutem hapni faqen e dytë. Informacioni në faqen ueb <a href="http://www.upt.al">www.upt.al</a> është edhe në</p>

<p>ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>gjuhën anglisht. Përsa i përket Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, shfaqet menjëherë në motorët e kërkimit www.fti.edu.al. Faqja ofrohet vetëm në gjuhën shqipe, dhe si e tillë i mungon gjuha e dytë, edhe pse butoni për gjuhën “English” është në faqen ballore, ai përsëri hapet në gjuhën shqipe. Programet e degëve të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit janë të qarta. [Ref.60. Model njoftimi në faqen ueb të FTI-së].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi IV.6</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion rezulton se FTI harton raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Raportet financiare që hartohen janë edhe në nivel institucional. FTI si njësi kryesor në raport ka të pasqyruar të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet. Shpenzimet sigurojnë mbarëvajtjen e programit të studimit. ([Ref.40. Analiza financiare UPT]; [Ref.39. FTI të ardhura dhe shpenzime]; [Ref.36. Buxheti FTI procedura e miratimit dhe hartimit]; [Ref.38. Relacion të dhënat financiare FTI].)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse</p>	<p>Kreu IV në Statutin e institucionit, përcakton qartë format e financimit dhe marrëdhëniet administrative dhe financiare që kryhen në UPT. Financimi behet në përputhje me ligjin nr.80/2015 dhe akteve të tjera nënligjore. Të ardhurat janë: të ardhurat nga buxheti i shtetit, pagesat e studentëve për arsimin, të ardhurat nga veprimtaria kërkimore dhe shërbimet e kryera për të tretë, donacione, të ardhura nga administrimi i mjediseve të tij dhe nga burime të tjera të ligjshme financimi.</p> <p>Përdorimi i fondeve publike nga UPT bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar. Shpërndarja e fondeve nga buxheti i shtetit është përcaktuar edhe në nenin 28 në Statut. Struktura e hartimit të buxhetit të UPT bëhet sipas modelit të Buxhetit të Shtetit të përcaktuar në udhëzimin</p>

apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.

përkatës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Projekt-buxheti vjetor hartohet nga Administratori, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të UPT dhe në planin buxhetor afatmesëm. Projekt-buxheti vjetor detajohet për çdo njësi bazë dhe kryesore të UPT. Buxheti vjetor dhe afatmesëm i UPT miratohet nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik. [Ref.1. Statuti I UPT.pdf]

Në relacionin përmbledhës të hartuar nga Administratori i FTI për vitet fiskale 2018, 2019, 2020 dhe 2021, disa prej shpenzimeve nga buxheti institucional janë si më poshtë:

**Pjesë e shpenzime në lekë për vitet fiskale**

	2018	2019	2020	2021
<b>Shpenzime për bursat e studentëve e të tjera</b>	2 269 500	30 219 920	21 569 558	32 020 000
<b>Pajisje audiovizuale dhe kompjuterike</b>	5 431 884	1 914 360	-	8 100 000
<b>Pajisje dhe instrumente laboratorik</b>	-	18 935 676	-	-
<b>Pjesëmarrje në konferenca</b>	1 252 612	329 018	-	154 331
<b>Instalime rrjete kompjuterike</b>	-	2 112 472	-	-
<b>Libra</b>	-	524 722	516 213	-

Të dhënat janë në nivel fakulteti dhe GVJ nuk ka të dhëna financiare në lidhje me përfitimet në bursa për studentët në këtë

	<p>program studimi. [Ref.36. Buxheti FTI procedura e miratimit dhe hartimit]; [Ref.44. FTI - pjesëmarrje në projekte]; [Ref.40. Analiza financiare UPT]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. UPT e kryen veprimtarinë dhe harton raporte financiare bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe zbaton të gjitha detyrimet që lindin prej tij.</li> <li>• Ligjit Nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.</li> <li>• Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</li> </ul> <p>Pasqyrat financiare të hartuara janë objekt i analizës në senatin akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës. [Ref.40. Analiza financiare UPT], [Ref.39. FTI të ardhura dhe shpenzime]. Në faqen web zyrtare të UPT janë të publikuara të dhënat mbi aktivitetin financiar të UPT [www.upt.al/rreth-nesh/programi-i-transparences] dhe në portalin U-Transparenca. [https://u-transparenca.al/]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në mbyllje të çdo cikli studimi UPT dokumenton edhe raportet financiare të tre viteve të fundit dhe bën planifikimet për ndërhyrje të posaçme bazuar edhe në strategjinë afatmesëm të saj. Reforma në arsimin e lartë ka mundësuar rritjen e iniciativës në njësitë bazë për realizimin e aktiviteteve shkencore si dhe pajisjen me bazë materiale e laboratorike specifike, në shërbim të nevojave të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor [Ref.36. Buxheti FTI procedura e miratimit dhe hartimit].</p> <p>UPT gëzon autonomi financiare dhe buxheti i tij hartohet në përputhje me përcaktimet e Statutit, Neni 29 [Ref.1. Statuti i UPT].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës</p>	<p>Institucioni dhe vetë program i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Drejtoria Ekonomike ndjek zbatimin e të gjitha procedurave financiare të lidhura me planifikimin dhe realizimin e buxhetit në UPT. [Ref.9. Organigrama UPT]</p> <p>Buxheti vjetor i UPT ka pësuar rritje të vazhdueshme %/vit gjatë viteve të fundit. Në tabelën e mëposhtme paraqitet sasia totale e burimeve të financimit të buxhetit të UPT në vite.</p>

financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	<b>Viti</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>
	<b>BURIMET E FINANCIMITE BUXHETIT UPT</b>	1,170,724,000.0	1,267,988,000.0	1,394,626,000.0	1,458,154,256.0

[Ref.41. Tabela e të ardhurave dhe investimeve UPT].

Në të ardhurat që vetë UPT gjeneron, 53% burojnë nga tarifa e shkollimit. Dokumentacioni dhe takimet e kryera garantojnë stabilitetin financiar të këtij program studimi ndonëse në raportet financiare nuk jepet qartë pesha financiare e këtij programi studimi.

<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me	Nga dokumentacioni që i është vënë në dispozicion GVJ, konstatohet se institucioni ka të përcaktuara procedurat që duhet të ndiqen për pranimin e studentëve në programin Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të programit të studimit. Në aktet rregullatore: Statuti i UPT-së, Rregullorja e Zhvillimit

<p>legjislaconin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Kurrikular dhe Mësimdhënies, Rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Rregullorja e Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit dhe rregulloren e programit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve përshkruhet procesi i regjistrimit të studentëve, i zhvillimit të procesit mësimor, i transferimit dhe njohjes së kompetencave, procedura e ankimimit dhe diplomimit të tyre.</p> <p>GVJ gjen hartimin e dokumenteve bazë institucionale në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe zbatimit të udhëzimeve e MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019.</p> <p>[Ref. 1. Statuti i UPT; Ref. 12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT; Ref. 30. Rregullore e brendshme e FTI; Ref. 92. Rregullore e brendshme e njësisë bazë; Ref. 101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë-BscITLK]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton zbatimin me rigorozitet të procedurave që garantojnë barazinë në çdo student. Procedura dhe kriteret specifike bëhen publike sipas akteve rregullatore të hartuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe të miratuara në njësinë bazë, atë kryesore dhe në Senatit Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës [Ref.72. Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve], [Ref.73. Miratimi i kuotave të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve].</p> <p>Procedura e përfitimi të bursave është e barabartë për të gjithë studentët bazuar në meritën e përfitimit. [Ref.89. Shërbimi i zyrës së finances në shërbim të studentëve, modele formularësh], [Ref.90. Të dhëna mbi studentët e trajtuar financiarisht - ekstrakt RVB UPT]</p> <p>Dokumentet institucionale përcaktojnë qartë të drejtat dhe detyrimet për stafin mësimor dhe studentët duke mos cënuar aspak lirinë përkatëse të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të</p>	<p>GVJ evidenton që kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të pasqyruara në dokumentet bazë institucionale. [Ref.72. Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve], [Ref.73. Miratimi i kuotave të</p>






<p>kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve], [Ref.88. Shërbimi i secretaries mësimore dhe model formularësh],</p> <p>Në takimet e zhvilluar në institucion u theksua njohja nga ana e studenteve të procesit mësimor, të drejtave dhe detyrimeve të tyre. Ky informacion transmetohet si nga pedagogët kujdestar të përcaktuar por edhe nga stafi akademik. [Ref.100. Model emërimi i pedagogëve kujdestar për studentët].</p> <p>Sensibilizimi bëhet edhe përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Portaleve [https://ualbania.al/], [www.upt.al] dhe [www.fti.edu.al]. për të gjitha programet e studimit të ofruara në UPT dhe FTL.</li> <li>• “ditët informuese” ku staf akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës mundëson informimin e studentëve potencial jo vetëm për kriteret dhe procedurat e pranimit, por edhe për ofertën informative të UPT, mundësitë e punësimit përnstudentët e diplomuar në UPT. [Ref.69. Praktika e promovimit dhe informimit të maturanteve, ditët informuese 18-19, 19-20, 20-21].</li> <li>• guidës studentore e hartuar në nivel institucional [Ref.70. Guida Studentore] së bashku me një broshurë përmbledhëse [Ref.71. Broshurë informuese - UPT].</li> <li>• Institucioni, gjithashtu, vë në dispozicion të kandidatëve për studentë dhe studentëve të regjistruar të gjithë informacionin e nevojshëm në çdo kohë që ajo kërkohet me të gjithë administratën.</li> </ul> <p>Institucioni, gjithashtu, vë në dispozicion të kandidatëve për student dhe studentëve të regjistruar të gjithë informacionin e nevojshëm në çdo kohë që ajo kërkohet me të gjithë administratën.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit propozon për çdo vit akademik kriteret e pranimit të studentëve në programin mësimor miratimi i të cilës bëhet nga Fakulteti dhe Senati Akademik dhe vijon me MASR. ([Ref.72. Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve], [Ref.73. Miratimi i kuotave të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve])</p> <p>GVJ konstaton se procedurat e hartimit dhe miratimit të kriterëve specifike për pranimin e studentëve në këtë program studimi është e mirëpërcaktuar në aktet rregullatore institucionale të UPT.</p>




<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>UPT nëpërmjet organeve të brendëshme përcakton kriteret specifike dhe ato të përgjithshme, duke i përshtatur sipas akteve nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në përputhje edhe me kriteret e maturës shtetërore. Midis të tjerash përcaktohen edhe procedurat dhe kuotat për regjistrimin e studentëve të huaj apo ata të ardhur nga trevat shqiptare jashtë vendit.</p> <p>[Ref.72. Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve]. [Ref.73. Miratimi i kuotave të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve].</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara në institucion Zyra e Karrierës në UPT në bashkpunim me zyrën e Karrierës në FTI si edhe me asistencën e stafit akademik zhvillon vazhdimisht sesione informuese për studentët potencialë dhe të gjithë të interesuarit për aktivitetet e ofruara nga institucioni.</p> <p>Informimet bëhen në fillim të çdo semestri akademik ku stafi akademik në fillim të lëndës jep sqarime për përmbajtjen e saj, shpërndan syllabusin. Gjithashtu, çdo vit organizohen ditë informuese me maturanët, ku njoftimi në lidhje me datat dhe vendin e organizimit të këtij aktiviteti u bëhet me dije të gjitha shkollave të mesme dhe gjimnazeve përmes ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe zyra të saj mbështetëse rajonale.</p> <p>[Ref.69. Praktika e promovimit dhe informimit të maturanëve, ditët informuese 18-19, 19-20, 20-21]</p> <p>Programi mësimor dhe rregullorja e programit të studimit janë të pasqyruar edhe në faqen ueb të FTI, rubrika Kurset e Studimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

## Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik GVJ konstatoi se FTI ju vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në</p>




<p>akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>tjetrin. Mënyrat e marrjes së informacionit nga studentët janë disa:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Faqet zyrtare të internetit ku studentët mund të aksesojnë rregulloret. [www.upt.al], [www.fti.edu.al].</li> <li>• Sekretaria mësimore dhe zyra e finances;</li> <li>• Pedagogët kujdesatar të cikleve të studimit dhe çdo staf akademik i angazhura në këtë program mësimi i informon studentët për kriteret e përparimit akademik për lëndët që mbulon;</li> </ul> <p>([Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT], [Ref.30. Rregullore e brendshme e FTI], [Ref.89. Shërbimi i zyrës së financës në shërbim të studentëve, modele formularësh], [Ref.88. Shërbimi i secretaries mësimore dhe model formularësh]. [Ref.100. Model emërimi i pedagogëve kujdestar për studentët]. [Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK].)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UPT ofron mundësinë për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi brenda institucionit apo institucione të tjera. GVJ gjeti pasqyrimin e akteve rregullatore për transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimi e lëndëve në kreun VI në rregulloren përkatëse të Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies. [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT].</p> <p>Neni 12 i Rregullores së programit të studimit specifikon që kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptar ose të huaj duke u bazuar në kuadrin ligjor sipas rregulloreve të përcaktuara në Statutin e UPT, Rregulloren mesimore të UPT dhe rregulloren e brendshme të FTI. [Ref.101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë]</p> <p>GVJ gjeti pasqyrimin e transferimit, njohjes së krediteve dhe ekuivalentimit të moduleve në dokumentat e dorëzuar. [Ref.74. Procedura për transferimin dhe njohjen e krediteve]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi në vizitën e kryer që studentët ishin të mirë informuar në lidhje me mënyrën e vlerësimit të dijeve të lëndëve në fillim të çdo lënde apo moduli nga pedagogu përkatës ku paraqit edhe plani mësimor i lëndëve përkatëse. [R Ref.103.Syllabuse të programit të studimit BscTLK]</p> <p>Një burim tjetër ku ata e gjenin këtë informacion ishte faqja e ueb-it të FTI ku mund të shikonin lëndët dhe rregulloret [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]</p>




	<i>Bazuar edhe në kërkesën e vete studentëve, GVJ rekomandon që detyrat e kursit dhe laboratorët të kishin edhe pikë në vlerësimin përfundimtar.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>GVJ në takimin me studentët kostatoi se studentët ishin të informuar mbi procedurat e punimit të temës së diplomës dhe zgjidhnin fushën e studimit të temës në bazë të preferencave të tyre. Të gjithë studentët e Bachelor Inxhinieri të Telekomunikacioneve duhet të përgatisin një punim diplome si detyrim përmbyllës të studimit. Punimi i diplomës ka 6 kredite ECTS si veprimtari formuese e kategorisë “E” [Ref.102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK].</p> <p>Departamenti ka udhëzimin përkatës, bashkë me një model që student e ndjek në përgatitjen e punimit të diplomes [Ref.104. Udhëzues për punimin e diplomës Bachelor-BscTLK]. Drejtuesi i Departamentit, stafi akademik, pedagogët kujdestar dhe faqia ueb e FTI janë disa nga burimet e informacionit për studentët. Gjatë takimin me stafin u theksua se përgatitja e temave të diplomave nga çdo student duke zbatuar rregulloren dhe kontrollet përkatëse ka sjell vit pas vit tema bashkëkohore dhe punime të mira të studentëve.</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>GVJ nga takimi me studentët evidentoi se ata kishin pasur disa mundësi alternative dhe komplementare për të marrë informacion rreth programeve të studimit të ofruara dhe mundësive që ofrohen në Universitetin Politeknik të Tiranës. Ditët informuese, broshurat, ueb sitet ose panairi informues me pjesëmarrjen e zyrës së këshillimit të karrierës të UPT, ishin disa nga mënyrat e informimit të studentëve.</p> <p>Ditët informuese organizohen nga UPT në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin me kandidatët për studentë nga shkollat e mesme dhe gjimnazet. Në këto ditë marrin pjesë së paku tre anëtarve nga stafi akademik i secilës njësi bazë që ofron programe studimi. [Ref.69. Praktika e promovimit dhe informimit të maturanteve, ditët informuese 18-19, 19-20, 20-21]. Në këto takim shpërndahen dhe udhëzues të hartuar nga UPT [Ref.70. Guida Studentore], [Ref.71. Broshurë informuese - UPT].</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e saj. Ata janë në dijeni për lëndët dhe modulet, ndarja e tyre në aktivitete didaktike si leksione, seminare, laboratorë, projekte/detyra kursi, etj. Rregulloren e programit të studimit dhe plani mësimor i miratuar për këtë program studimi studentët mund t'i gjejnë në faqen web të FTI [Ref.101. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë] [Ref.102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët e regjistruar në këtë program studimi informohen në mënyrë të vazhduar rreth strukturës, organizimit dhe të gjitha aspektet e aktiviteteve akademike të lidhura me avancimin e tyre akademik dhe orarin mësimor. Ky informacion është në faqen ueb të fakultetit, ashtu edhe në ambientet e dedikuara për njoftime në katin e parë të godinës së Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. ([Ref.79. Struktura e vitit akademik]; [Ref.80. Shembull Orari mësimor].)</p> <p>Stafi akademik dhe pedagogët kujdestarë janë gjithashtu udhëzues në të gjitha aspekteve të jetës akademike/studentore në funksion të këtij programi studimi [Ref.100. Model emërimi i pedagogëve kujdestar për studentët]. [Ref.104. Udhëzues për punimin e diplomës Bachelor-BscTLK].</p> <p>Studentët informohen në lidhje me procesin mësimor edhe përmes sekretarisë mësimore duke u njoftuar për lëndët, regjistrimin përkatës, grupet dhe rezultatet e provimeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Nga dokumentat e dorëzuara dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton se studentët e regjistruar në Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” informohen në mënyrë të vazhduar rreth mundësive të punësimit që ofrohen dhe tregut të punës. Disa nga mënyrat e informimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Faqja web institucionale <a href="http://www.upt.al">www.upt.al</a>. Studentët informohen në mënyrë zyrtare rreth mundësive të punësimit apo praktikave mësimore me objektiv punësimin. [Ref.68. Shembuj njoftime punësimi dhe intership në <a href="http://www.upt.al">www.upt.al</a>].</li> <li>• Posta elektronike zyrtare institucionale në domainin <a href="mailto:@fti.edu.al">@fti.edu.al</a>. Informacione mbi mundësitë e punësimit</li> </ul>

	<p>ju transmetohet studentëve, sidomos atyre në vitin e tretë të studimeve Bachelor.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitetet informuese/trajnuese që organizohen për të rritur aftësitë dhe njohuritë e tyre rreth tregut të punës [https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1530-njoftim-u-zhvillua-trajnimi-me-teme-si-te-shkruajme-nje-cv-dhe-nje-leter-te-suksesshme-motivimi].</li> <li>• Panairin e punës. Në mënyrë të përvitshme, Universiteti Politeknik i Tiranës, me përfaqësues nga të gjitha njësitë kryesore, mmerr pjesë në panairin e punës ku kompani të ndryshme marrin pjesë duke paraqitur ofertën e tyre të punësimit për studenët. [Ref.67. Panairi i punës 2018-2019 e në vijim]</li> <li>• Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) e FTI me anë të komunikimeve ballë për ballë, postës elektronike, rrjeteve sociale të FTI i informon studentët për mundësitë e punësimit. Shënime në vizitë</li> </ul> <p>GVJ u njoh me iniciativa të stafit akademik të cilët në kuadër të hartimit të një studimi kanë ndërmarrë edhe sondazhe më specifike në lidhje me studentët e diplomuar, mendimin kritik të tyre për përmbajtjen e programit, aftësimin e tyre në përfundim të studimeve, fushën e punësimit të tyre. GVJ si edhe më sipër e vlerëson këtë artikull dhe rekomandon që të ndiqet një plan veprimi konkret në lidhje me drejtimet e përmirësimeve që duhet të ndërmerren nga Departamenti (Ref.34. Studimi i tregut të punës profilet FTI.)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit mundëson një shpërndarje të informacionit në shumë drejtime gjatë gjithë karrierës universitare në mënyrë të vazhdueshme. Përmes punës së tij studentët informohen në lidhje me të drejtat, detyrat dhe udhëzimet informuese për procesin mësimor. Informacion shpërndahet edhe përmes :</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pedagogëve, të cilët në fillim të çdo lënde/moduli, paraqesin plan-programet e lëndëve [Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK].</li> <li>• Pedagogët në fillim të çdo lënde/moduli, paraqesin plan-programet e lëndëve [Ref.103. Syllabuse të programit të studimit BscTLK].</li> <li>• Postës elektronike @fti.edu.al” ose Platforma Microsoft Teams ku studentët marrin njoftime rreth</li> </ul>




	<p>zhvillimit të laboratorëve, zëvendësimeve të orëve mësimore etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në faqen web të Universitetit Politeknik të Tiranës [www.upt.al] si dhe në atë të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit [www.fti.edu.al] afishohen informacione të azhuruara rreth procesit mësimor, strukturës akademike, afateve dhe modaliteteve të procesit të diplomimit, të dhëna rreth trajnimeve të ndryshme apo mundësive për punësim, orari mësimor, ambientet dhe sallat e zhvillimit të aktiviteteve didaktike, etj ([Ref.60. Model njoftimi në faqen ueb të FTI-së] [Ref.65. Biblioteka dhe burimet bibliotekare në dispozicion të FTI]).</li> </ul> <p>GVJ konstatoi se këto sisteme janë të arritshme lehtësishtë nga studentët edhe në distancë, si kërkesë mjaft e nevojshme gjatë periudhës së Pandemise.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	UPT ka të dhëna statistike vjetore si në nivel institucional ashtu edhe në nivel fakulteti.  Sektori i Statistikave dhe Informacionit në Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë mbledh dhe përpunon të dhëna numerike në mënyrë periodike nga të gjitha njësitë kryesore në UPT. ([Ref.9. Organigrama UPT]. [Ref.19. Informacion mbi sektorin e statistikës]) Në këto të dhëna përfshihen: numri i studentëve të regjistruar në secilin prej programeve të studimit, numri i studentëve të çregjistruar, numri i studentëve të transferuar dhe numri i studentëve të diplomuar për çdo program studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Mbështetur në ligjin nr.80/2015 të dhënat e studentëve mbahen, administrohen, monitorohen dhe kontrollohen në

	<p>sekretarinë mësimore. Të dhënat mbahen në formë të shkruar dhe elektronike në tre regjistra bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Regjistri themeltar i studentëve;</li> <li>• Regjistri i arritjeve akademike;</li> <li>• Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave;</li> </ul> <p>Sekretaria mësimore administron të dhënat e studentëve që nga faza e regjistrimit deri në përfundim të studimeve.</p> <p>GVJ ndërmori një vizitë në sekretarinë mësimore dhe nga takimi me kryesekretare dhe sekretaren në këtë zyrë konkludon:</p> <p>Regjistrimi manual dhe online i studentëve në procedurën e aplikimit dhe të pranimit janë në përputhje me nenin 4 në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore dhe në përputhje me aktet ligjore të përcaktuara nga MASR. Të dhënat e plotësuar për çdo student të regjistruar janë në renditje kohore me datën e regjistrimit të studentëve. Këto të dhëna mbahen edhe në regjistrin elektronik për të cilën u bë edhe një verifikim nga ana e GVJ-së. Regjistri themeltar i studentëve është i plotësuar në përputhje me shtojcën nr.2 të udhëzimit nr.31 datë 16.09.2014 të MASR “Për pajisjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat me Regjistrat Bazë të Studentëve”.</p> <p>GVJ gjeti regjistrimin përfundimtar të studentëve me numrin e matrikulimit në përputhje me nenin 15 në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore. GVJ verifikoi edhe regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimi u bë me të dhënat e dy studenteve të përzgjedhur në mënyrë rastësore në një procesverbal provimi me notat përkatëse të studentëve të zgjedhur të hedhur në regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimet gjejnë një përputhje të notave dhe në tërësi plotësimi i tij është në përputhje me kuadrin ligjor. Sekretaria mësimore është përgjegjëse edhe për administrimin e të dhënave të studentëve që diplomohen. Të dhënat plotësohen në regjistrin e diplomave dhe lëshimi i saj me suplementin e diplomës bëhet nga vete studenti ose përmes një autorizimi të noterizuar. Shënime në vizitë</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Në sekretarinë mësimore ruhen të dhëna të detajuara për ecurinë akademike të studentëve.</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar;</p> <p><b>Tabela 11: Të dhëna për periudhën 2018-2022</b></p>






[Ref.107. Tabelat RVB për programin bachelor BscTLK]

Numri i studentëve të diplomuar në këto vite akademike, i përkasin regjistrimeve së paku në tre-vjeçarin para ardhës.

Viti Akademik	Studentë të regjistruar në vitin e parë	Nota mesatare	Studentë të diplomuar
2018 – 2019	120	9.15	31
2019 – 2020	100	9.33	98
2020 – 2021	100	9.43	91
2021 - 2022	111		

Çdo pedagog i angazhuar në procesin mësimor në UPT, harton në përfundim të vitit akademik, një analizë të lëndëve të zhvilluar prej tij. Ndër të dhënat e raportuara, janë edhe statistika rreth kalueshmërisë së studentëve, vlerësimi mesatar dhe pjesëmarrjes në provim. [Ref.98. Model analizë për lëndë pedagogu \_ELN-TLK].

Informacion i nevojshëm për ofrimin e shërbimeve të tjera në Zyra e Financës gjeneron informacion për përfitimin e bursave të plota apo të pjesshme bazuar mbi meritë, apo detyrimet ekonomike për studentët që paraqesin provime të bartura përtej kohëzgjatjes normale të ciklit të studimeve [Ref.89. Shërbimi i zyrës së financës në shërbim të studentëve, modele formularësh]. Raporte periodike për avancimin akademik të studentëve, jo vetëm si numër provimesh por edhe si vlerësime përkatëse, hartohen të paktën një herë në çdo vit. Këto të dhëna mbledhen në formë të përmbledhur edhe nga sektori i statistikës në kuadër të funksioneve institucionale. [Ref.19. Informacion mbi sektorin e statistikës]. [Ref.9. Organigrama UPT]

**Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Të dhënat e studentëve mbahen edhe në Regjistrat bazë që ruhen në mënyrë të përhershme në përputhje me ligjin “Për Arkivat” dhe janë objekt kontrolli. Një pjesë e të dhënave administrohen edhe në Portalin e Sekretarisë Mësimore [<https://bit-albania.com/>] ku na u garantua edhe ruajtja e konfidencialitetit dhe garancisë së vërtetësisë së tyre. Nëse një mospërputhje ekziston, atëherë të dhënat me shkrim në regjistrat bazë prevalojnë. Në takimet e zhvilluara u theksua që UPT mbron, ruan, dhe administron të dhënat personale edhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

	<p>Disa nga funksionalitetet për studentët që mundëson Portali i Sekretarisë Mësimore janë: informimi i studentëve për rezultatet e tyre, informacione të tjera të lidhura me aktivitetin mësimor, dërgimi i mesazheve, njoftimeve edhe anketimet semestrale për cilësinë në mësimdhënie.</p> <p>Sistemi ofron skanimi optik të procesverbaleve dhe fletë detyrimeve të plotësuar nga pedagogët e ka thjeshtuar mjaft punën edhe për personelin akademik dhe sekretaritë, pasi të dhënat hidhen në mënyrë automatike. Në këtë mënyrë, dokumentacioni ruhet në hard copy dhe në formë elektronike, duke ofruar siguri të lartë. Ky sistem, lejon përpunimin e thjeshtuar dhe në kohë më të shkurtër të të dhënave. [Ref.63. Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët]</p>
--	--


<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Niveli i studentëve në hyrje për këtë program studimi është me një mesatare të lartë mbi 9.1. Gjatë takimeve në institucion u theksuar se këta studentë punësohen në vitet më të larta dhe e gjejnë veten lehtë në tregun e punës. FTI i ruan kontaktet me studentët e diplomuar, që janë ekspert në fushat përkatëse, duke i angazhar si staf PAK ose duke organizuar leksione të hapur. DET gjithashtu për të përmirësuar objektivat e programit të studimit ndjekt rekomandimet e raportit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë i haruar nga NJQSC e UPT. Ky raport jep informacion i detajuar mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe në lidhje me punësimin e tyre. ([Ref.9. Organigrama UPT]; [Ref.77. Gjurmim Alumni]; Ref.60. Model njoftimi në faqen ueb të FTI-së (diplomat, praktikat, leksione te hapura, personel akademik etj.), Takime në institucion)</p>
---	---

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe</p>	<p>Bazuar në nenin 9, pika 4 të Statutit të UPT përcaktohet përfaqësimi i studentëve në Senatin Akademik të Universitetit</p>




<p>angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Politeknik të Tiranës (SAUPT) [Ref.1. Statuti i UPT] [Ref.11. Përfaqësimi i studentëve në organe kolegjinale].</p> <p>Në UPT, studentët janë të përfshirë në të gjithë nivelet vendimmarrëse dhe këshilluese me përfaqësues të tyre, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në Bordin e Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës (BAUPT) [Ref.10. Rregullore e bordit të administrimit].</li> <li>• Në komisionet zgjedhore si në nivel institucional, ashtu edhe në nivel njësie kryesore [Ref.22. Rregullore për organizimin zgjedhjeve UPT].</li> <li>• Në këshillin e Etikës [Ref.1. Statuti i UPT], [Ref.2. Kodi i etikës UPT].</li> <li>• Në komisionet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë. [Ref.87.Vendim për ngritjen e grupeve të vlerësimi të brendshëm për programet bachelor FTI]</li> </ul>								
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Referuar RVB, Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje. Studentët kanë përfaqësimin e tyre në organet kolegjinale vendimmarrëse si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Senatin akademik të UPT (4 student)</li> <li>• Këshilli i etikës në UPT (1 student)</li> <li>• NJQSC në nivel institucioni (1 student)</li> <li>• NJQSC për program studimi (1 student)</li> <li>• Komisioni Institucional Zgjedhor – UPT (1 student)</li> <li>• Komisioni i zgjedhjeve në fakultet (1 student)</li> </ul> <p>Anketimeve periodike të realizuara në nivel institucional janë një burim i duhur që përfshihen në këshillimet e nevojshme për përmirësimin e cilësisë, por nevojitet realizimi i këtyre anketimeve më sepcifike edhe në nivel fakulteti dhe programi studimi që të dëgjohet zëri i një numri më të madh studentësh [Ref.27. Raport pyetësor studentor organizuar UPT].</p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve</p>	<p>Në hartimin e programeve të studimit merren në konsideratë gjithë rekomandimet për ngarkesën akademike të studentëve në auditor dhe mësim jashtë auditorit sipas parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi. Numri i orëve totale në auditor dhe për studim individual është si më poshtë:</p> <p>Tabela 13: Ngarkesa mësimore</p> <table border="1" data-bbox="592 1843 1367 1937"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Orë në auditor</th> <th>Orë studim individual</th> <th>Raporti</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </tbody> </table>	Viti	Orë në auditor	Orë studim individual	Raporti				
Viti	Orë në auditor	Orë studim individual	Raporti						

të plota apo të pjesshme të mëparshme.

I	773.5	726.5	1:1
II	765.8	734.2	1:1
III	736	764	1:1
<b>Total</b>	<b>2275.3</b>	<b>2224.7</b>	<b>1:1</b>

[Ref.102. Plani mësimor i programit të studimit-BscTLK]  
Ndarjen e orëve në auditor për secilin aktivitet formues si më poshtë:

Tabela 14: Ngarkesa për 1 ECTS

Aktiviteti	Nr. Kredite	Orë në auditor	Orë Studim individual
Leksion	1	12	13
Ushtrime/seminar	1	14	11
Laborator	1	20	5
Projekt/detyra	1	5	20
Praktika	1	23	2

[Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]

Rregullorja e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT përmban të gjithë informacionet e nevojshme për kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme. ([Ref.12. Kreu VI Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]; [Ref.74. Procedura për transferimin dhe njohjen e krediteve]; [Ref.49. Procedura mobilitet stafi akademik, student])

**Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.

Studentët janë pjesë e procesit të rishikimit të programit mësimor dhe rregullores mësimore i cili organizohet në fund të çdo viti akademik. [Ref.94. Procedura e ndryshimeve në planet mësimore] [Ref.93. Vendimi për emërimin e këshillave të programeve të studimit (KPS)].

UPT ofron për çdo student një pyetësor për vlerësimin e lëndës apo modulit. Pyetësori mundëson studentin të shprehë mendimin e tij në lidhje me cilësinë e procesit mësimor. Gjetjet nga përpunimi statistikor i pyetësorëve shërben si bazë për përmirësimin e programit dhe për ndërmarrjen e plan

	<p>veprimet nga ana e DET. [Ref.27. Raport pyetësor studentor organizuar UPT]</p> <p>Studentët e këtij program studimi përmes takimeve më të afërta të stafit akademik të DET me anë të pedagogëve kujdestarë, shfaqin mendimin e tyre në lidhje me dobësitë në procesin mësimor dhe shërbejnë si mjet për ndërmarrjen e hapave në lidhje me përmirësimet që kërkohen. [Ref.100. Model emërimi i pedagogëve kujdestar për studentët bachelor]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>UPT ofron për çdo student një pyetësor për vlerësimin e lëndës apo modulit. Pyetësi mundëson studentin të shprehë mendimin e tij në lidhje me cilësinë e procesit mësimor. Gjetjet nga përpunimi statistikor i pyetësorëve shërben si bazë për përmirësimin e programit dhe për ndërmarrjen e plan veprimet nga ana e DET. Dokumenti bazë si Rregulloren Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies mundëson studentët të kenë të drejtën të njohë mënyrën e vlerësimit të tij gjatë procesit mësimor dhe e drejta e ankimimit. [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]</p> <p>Në këtë rregullore janë të përshkruara organizimi i provimit, njohja me vlerësimin e tij, afatet kohore për ankimimin. Institucioni i informon studentët që në momentin e regjistrimit të tyre për herë të parë me njohjen e të drejtave dhe detyrimeve të tyre. Nga takimi me studentët GVJ konstaton që studentet ishin të mirë informuar në lidhje me mënyrën e vlerësimit të tyre nga ana e stafit akademik dhe mënyrën e ankimimit. Ata nuk sollën shembuj të eksperiencës së tyre në këtë drejtim.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<p><b>Standardi V.6</b></p> <p><b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet</p>	<p>Misioni i Zyrës së Këshillimit të Karrierës në UPT është të orientojë, inkurajojë dhe mbështesë studentët dhe të diplomuarit me mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit dhe udhëzimit në</p>

<p>ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>karrierë. Ajo është e shtrirë në nivel njësie kryesore në të gjitha fakultetet e UPT.Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t në FTI i informon vazhdimisht studentët e FTI, me anë të postës elektronike, me informacione për avancimin e tyre akademik dhe karrierën pas universitare [Ref.61. Shembuj njoftime dhe informime me email për studentët].</p> <p>Informimi i studentëve sigurohet përmes përdorimit të formave siç vijon me poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Takimet informuese me maturanët;</li> <li>• Faqja ueb e UPT dhe FTI;</li> <li>• Organet drejtuese dhe Stafi akademik i cili në fillim të çdo lënde paraqet përmbajtjen e tij, format e mësimdhënies, detyrimet e studentëve dhe leksionet;</li> <li>• Sekretaria mësimore e cila informon studentët për tarifën e regjistrimit, progresin e tyre, rezultatet e provimeve deri në procesin e diplomimit duke ofruar asistencë dhe informim të vazhdueshëm;</li> <li>• Platforma e Sekretarisë Mësimore dhe Office 365;</li> <li>• Broshura, fletëpalosje janë një formë që kanë rritur edhe informimin e publikut dhe studentëve në lidhje me programet mësimore;</li> </ul> <p>([Ref.69. Praktika e promovimit dhe informimit të maturanëve, ditët informuese 18-19, 19-20, 20-21]; [Ref.70. Guida Studentore]; [Ref.71. Broshurë informuese - UPT]; [Ref.60. Model njoftimi në faqen ueb të FTI-së]; [Ref.68. Shembuj njoftime punësimi dhe intership në www.upt.al])</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>UPT ofron asistencë, këshillim dhe ndjek progresin e studentëve përmes strukturave të ngritura të saj. Të gjitha funksionojnë bazuar në organigramën e UPT, Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies dhe Rregulloreve të veçanta të miratuara nga Senati Akademik. Ndër strukturat kryesore bazë ndihmuese për studentët janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNIT në FTI,</li> <li>• Sekretarinë mësimore,</li> <li>• Zyra e financës</li> <li>• Faqet web ajo institucionale [www.upt.al] dhe e fakultetit [www.fti.edu.al]</li> <li>• Ambientet e dedikuara për njoftime në fakultet</li> <li>• Pedagogët kujdestar për secilin grup studentësh</li> <li>• Përgjegjësi i department dhe pedagogët</li> </ul>

	<p>[Ref.9. Organigrama UPT]; [Ref.88. Shërbimi i sekretarisë mësimore dhe model formularësh]; [Ref.89. Shërbimi i zyrës së finances në shërbim të studentëve, modele formularësh]; [Ref.100. Model emërimi i pedagogëve kujdestar për studentët].</p> <p>Klubet studentore, të cilat funksionojnë në nivel institucional, u mundësojnë studentëve një jetë sociale më aktive, përforcimin e aftësive ndër-personale, mundësinë e përfitimit të një orientimi në karrierë etj. [Ref.21. Aktivitete sociale-kulturore me studentët]. GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet me përfaqësues të këtyre strukturave, dhe takimet me studentët evidenton që ato janë aktive dhe ofrojnë ndihmë dhe këshillim për studentët. Vlen të përmendet edhe ndihma që vetë stafi akademik u ofron studentëve e cila ka qënë më e theksuar gjatë situatës së përhapjes së virusit Sars-Cov-2 (Covid-19) dhe pandemisë që pasoi. Ata ishin grupet e para në nivel institucional që testuan me sukses disa platforma mësimdhënie online që rezultuan të suksesshme falë angazhimit dhe përkushtimit të ndërsjellë. Grupi i punës i ngritur në FTI [Ref.17. Vendim mbi zhvillimin e procesit akademik në platforma online], me sukses testoi dhe hartoi edhe manualet e para për të gjithë UPT për përdorimin e Microsoft Teams si platformë institucionale për mësimdhënien e diktuar nga periudha e pandemisë. [Ref.51. Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft Teams (pedagog)], [Ref.54. Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft Teams (student)].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit në FTI është ngritur si pjesë e sektorit të Komunikimit me Publikun në Drejtorinë e Komunikimit dhe Koordinimit të UPT. [Ref.9. Organigrama UPT].</p> <p>Kjo zyre edhe pse e re është një strukturë aktive në lidhje me punën e saj me studente. Specialistja e këtij sektori asiston dhe ndjek studentët, si gjatë kohës së jetës së tyre studentore, ashtu edhe pas mbarimit të tyre. Ndër objektivat kryesore të këtij sektori është edhe mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me studentët apo ish studentët për informacione rreth studimeve, orientim për karrierën ose orientimin profesional si dhe këshillim individual apo në grup.</p> <p>Drejtorinë e Komunikimit dhe Koordinimit në nivel institucional organizon edhe takimet dhe ditët informuese për të gjithë maturanët apo të interesuarit rreth shërbimeve dhe programeve të studimit të ofruara në UPT.</p>

	<p>UPT mbështet aktivisht zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, me fokus në zhvillimin efikas të praktikave profesionale për ta. Ai nxit dhe mbështet krijimtarinë e studentëve, në partneritet të plotë me biznesin dhe mbi bazën e shanseve të barabarta dhe zgjerimin e internshipit. Bashkëpunimet me industrinë, biznesin, kompanitë dhe institucionet mbështeten në marrëveshje e institucionalizuara.</p> <p>([Ref.67. Panairi i punës 2018-2019 e në vijim]; [Ref.68. Shembuj njoftime punësimi dhe intership në <a href="http://www.upt.al">www.upt.al</a>]; [Ref.60. Model njoftimi në faqen ueb të FTI-së (diplomat, praktikat, leksione të hapura, personel akademik etj.); [Ref.61. Shembuj njoftime dhe informime me email për studentët]; [Ref.6. Marrëveshjet Institucionale UPT me akademinë dhe industrinë])</p>
--	--

<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese nërkatëse.</p>	<p>Realizimi i praktikave mësimore të studentëve shërbejnë edhe si pikënisje për punësimin e mëtejshëm të studentëve mbas diplomimit. Specialistët për këshillimin e karrierës dhe ALUMNI mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentë edhe mbas diplomimit si informacion i nevojshme për vlerësimin periodik të programeve të studimit të ofruara në UPT. Kontaktet e vazhduara edhe me ish studentët e diplomuar në programet e studimit në FTI shërbejnë edhe si pika kontakti me industrinë ku ata janë të punësuar apo në aktivitetet dhe kompanitë që ish studentë kanë krijuar. Projektit GRADUA (një projekt tre-vjeçar 2017-2020) ku UPT ka qenë pjesëmarrës ka ndihmuar për të dhënë në mënyrë të përgjithshme një panoramë të situatës së punësimit në Shqipëri. [Ref.33. Sondazhe mbi tregun e punës dhe kompanitë]</p> <p>GVJ e vlerëson anketimi e zhvilluar nga zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI dhe rekomandon që këto anketime të jenë të përvitshme dhe të ndara sipas programeve të studimit dhe jo vetëm në nivel fakulteti. [Ref.77. Gjurmim Alumni]</p>
---	--

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Në përmbushje</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
---	-----------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Në përmbushje</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
--	-----------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---






## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion [Ref.1. Statuti i UPT, Dhjetor-2018; Ref.3. Plani strategjik UPT 19-24; Ref.9. Organigrama UPT; Ref.19. Informacion mbi sektorin e statistikës) si dhe nga takimet me përgaqësues të Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria e Kurrikulave, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Në UPT funksionon Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë që ka si detyrë rritjen e vetëdijes institucionale për mekanizmat cilësor. Sektori i Statistikës dhe Informacionit të kësaj drejtorie mbledh dhe përpunon vazhdimisht të dhëna sasiore nga të gjitha njësitë përbërëse kryesore dhe bazë të UPT me qëllim raportimin e gjetjeve në organet drejtuese për vendimmarrje. [Ref.19. Informacion mbi sektorin e statistikës].</p> <p>Me qëllim sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së programeve të studimit të ofruara, në UPT funksionon gjithashtu në nivel institucional, Drejtoria e Kurrikulave. Kjo drejtori kontrollon të gjitha aspektet teknike të lidhura me dokumentacionin e plotë të një programi studimi dhe sugjeron përmirësime në vazhdim të diktuar nga ndryshimet e akteve ligjore dhe nën ligjore. Drejtoria e Kurrikulave çdo vit miraton planet mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ është i mendimit se Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT është funksionale dhe e kryen veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin e UPT.</p> <p>UPT ka një mirëfunksionimi të sistemit të brendshëm të cilësisë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstaton se kjo drejtori në bashkëpunim me drejtoritë e tjera në vartësi të Rektoratit UPT, kanë në fokus primar informimin e organeve vendimmarrëse të UPT në lidhje me gjendjen aktuale të të gjithë sektorëve respektive, dhe të japin vlerësimin e tyre për përmirësime në vijim. Këshilli i Etikës në UPT i cili është garanti për zbatimin e kodit të etikës si një</p>

	<p>ndër përbërësit kyç të rritjes së cilësisë [Ref.2. Kodi i etikës UPT]. Ka disa aktivitete në funksion të rritjes së cilësisë të cilat raportohen në mënyrë periodike. Fillimisht secili anëtar i personelit akademik [Ref.99. Model analizë kërkimi shkencor pedagogu], bëhen pjesë e analizës së kërkimit shkencor në njësinë bazë përgjegjëse [Ref.97. Model analizë vjetore për kërkimin shkencor njësi bazë - DET] dhe në fund bëhen pjesë e analizës dhe diskutimeve të aktivitetit shkencor në njësinë kryesore [Ref.47. Model analizë vjetore për kërkimin shkencor FTI]. Analiza e raporteve të përmendura më sipër është në funksion të rritjes së vazhdueshme të cilësisë, dhe në mënyrë periodike paraqiten në Sektorin e Statistikës dhe Informacionit si pjesë e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Raportet e gjeneruara për Senatën Akademik si organi vendimmarrëse në UPT ka në përbërje dhe 4 përfaqesues të studentëve. [Ref.40. Analiza financiare UPT; Ref.11. Përfaqësimi i studentëve në organe kolegjiale].</p> <p>Në kuadër të vlerësimit të brendshëm GVJ konstaton se GVB është ngritur në përputhje me Statutin e UPT, dhe ka hartuar Raportin e Vetvlerësimit në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore, dhe të bazuar në fakte të mbështetura mbi dokumentat që i janë vënë në dispozicion edhe GVJ.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr 01, datë 07. 01. 2022, “Për akreditimin periodik Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i Tiranës”, është vendosur Akreditimi Institucional i UPT, me vlerësim përfundimtar pozitiv, me kohëzgjatjen prej 6 (gjashtë) vite akademike. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së Akreditimit Institucional është 06/01/2028. Në bazë të dokumentit “Rregullore e Studimeve Universitare, Neni 91” UPT realizon Sigurimin e Jashtëm të Cilësisë përmes vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve është hapur me shkresë Nr. 765.Prot, datë 06.02.2006 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve, me qëllim akreditimin e programit, po realizohet për herë të parë nga ASCAL.</p> <p>[Ref.26. Vendimi për akreditimin Institucional UPT]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe</p>	<p>UPT në funksion të rritjes së cilësisë kryen vetëvlerësimin periodik apo vlerësimeve periodike të drejtorive të ndryshme.</p>

<p>ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Priorite janë edhe rekomandimet e lëna nga vlerësimet e jashtme si në nivel institucioni ashtu edhe në nivel programi studimi. Për këtë qëllim, bazuar edhe në akreditimin institucional të vitit 2017, në Universitetin Politeknik të Tiranë hartoi një plan veprimi për përbushjen e rekomandimeve [Ref.24. Plani i veprimit për përbushjen e Rekomandimeve të përcaktuara në Vendimin 13, Dt. 07.04.2017 të BA]. Realizime [Ref.25. Plotësimi i rekomandimit për akreditimin institucional - ekstrakt RVB UPT] të cilat më pas janë vlerësuar pozitivisht nga Bordi i Akreditimit me Vendimin Nr. 01, date 07.01.2022 për "Akreditimin Periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti Politeknik i Tiranës". [Ref.26. Vendimi për akreditimin Institucional UPT]</p> <p>Dokumentacioni dhe cilësia e programit të studimit kontrollohet edhe nga Drejtoria e Kurrikulave në nivel institucioni. Këtu përfshihet përputhshmëria e planeve mësimore dhe sugjerimet e nevojshme për përmirësime në vazhdim të diktuar nga ndryshimet e akteve ligjore dhe nën ligjore. Miratimi i përvitshëm i planeve mësimore, mbasi ndjek të gjithë strukturën e miratimit në nivel njësie bazë dhe asaj kryesore, merr edhe kontrollin cilësor të kësaj drejtorie.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve është Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit (DET), konform ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë. GVJ nga takimet në institucion dhe dokumnetat e dorëzuara konstaton dy strukturat e posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Këshilli i Programit të Studimit i ngritur në departament;</li> <li>• Drejtoria e Kurrikulave në nivel institucioni;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme</p>	

<p>të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>[Ref.93. Vendimi për emërimin e këshillave të programeve të studimit (KPS)]; [Ref.9. Organigrama UPT].</p> <p>Këshilli i Programit të Studimit përbëhet nga personel akademik me përvojë së paku 10 vjeçare në mësimdhënie pranë kësaj njësie. Aktivitetet kryesore të Këshillit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shqyrtimi në mënyrë periodike i dokumentacionit të një programi studimi, si: planin mësimor, syllabusin përkatëse, analizimi i raportit të zhvillimit të aktiviteteve didaktike të hartuara nga secili pedagog i angazhuar në këtë program [Ref.98. Model analizë për lëndë pedagogu ELN-TLK].</li> <li>○ Pjesë e rishikimit janë edhe mbledhjet e njësisë bazë të cilat analizojnë edhe gjetjet e pyetësorëve studentorë të hartuara në nivel institucional. [Ref.27. Raport pyetësor studentor organizuar UPT]</li> </ul> <p>Gjetjet dhe propozimet e këshillit të programeve të studimit diskutohen në mbledhjen e radhës në fillimin e vitit kalendarik, kryesisht në periudhën janar-mars, ku bëhen propozimet për modifikime të planeve mësimore, syllabuseve, ndarjen e aktiviteteve didaktike etj, nëse është e nevojshme. Më pas kalohet në miratimin në njësinë bazë të modifikimeve të propozuara. Pasi miratohet nga njësia bazë dokumentacioni i plotë i programit të studimit për vitin pasardhës përcillet në Drejtorinë e Kurrikulave nëpërmjet njësisë kryesore. Drejtoria e kurrikulave kontrollon përputhshmërinë e dokumentacionit të programit të studimit me aktet rregullatore institucionale dhe ligjore. Nëse nga kontrolli rezulton përputhshmëri dokumentacioni i kalon për miratim të Rektorit të UPT, në rast të kundërt kthehet në njësiën bazë për të kryer modifikimet e nevojshme. [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]</p> <p>Në takimin me përfaqësues të kësaj strukture u theksua puna e bërë në lidhje me ndjekjen dhe kontrollin e ecurisë së procesit mësimor në përputhje me planet dhe programin mësimor në të gjithë përbërësit e tij.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ndërmerr pyetësorë në fund të çdo semestri në lidhje me lëndët e zhvilluara. Sektori i Statistikës dhe Informacionit në Drejtori përpunonë të dhënat e mbledhura nga pyetësorët studentorë. [Ref.19. Informacion mbi sektorin e statistikës]. Raportet përcillen në njësitë kryesore dhe ato bazë për njohje dhe përmirësime të mëtejshme. GVJ nga dokumentat e</p>

	<p>dorëzuar vlerëson raportin e zhvillimit të aktivitetit didaktik nga pedagogu [Ref.45. Model evidencë për raportimin e zhvillimit mësimor] që shërben si një praktikë pozitive matëse dhe vlerësuese e ecurisë së modulit të zhvilluar.</p> <p><i>Rekomandojmë që të zhvillohen edhe pyetësorë në nivel programi mesimor me pyetje më specifike të cilat ndihmojnë stafin akademik në punën e tij për përmirësimin e përmbajtjes së lëndës.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e pyetësorëve nga studentët përpunohen nga sektori i Statistikës dhe Informacionit konform rregullores së brendshme Ky sektor gjeneron raportet studentore të organizuar në nivel institucional, [Ref.19. Informacion mbi sektorin e statistikës]. Të dhënat e këtij raporti i përcillen njësisve kryesore e më pas atyre bazë për informim dhe përmirësim të mëtejshëm të aktiviteteve të tyre. [Ref.27. Raport pyetësor studentor organizuar UPT].</p> <p>Rezultatet e mësipërme, së bashku edhe me raportet vjetore të njësisve bazë [Ref.96. Model analizë vjetore mësimore njësi bazë - DET] dhe ato të përmbledhura të njësisve kryesore [Ref.46. Model analizë vjetore mësimore FTI], përcillen në Rektoratin e UPT ku më pas përpunohen dhe analizohen në mbledhjet e Senatit akademik për vendimmarrje. Raporte të cilat çdo vit paraqiten të përmbledhura në ministrinë përgjegjëse për arsimin.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>GVJ gjeti raportet e përgatitura nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT, të kryera rregullisht anketime semestrale studentore mbi cilësinë në mësimdhënie. [<a href="https://www.upt.al/cilesia-ne-upt">https://www.upt.al/cilesia-ne-upt</a>]. Këto raporte fillojnë nga semestri i dytë 2017-2018. Përmes rezultateve individuale të personelit akademik, hartohen analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në çdo program studimi. Këto analiza përmbledhen në trajtë raporti dhe i përcillen njësisve kryesore dhe atyre bazë për të zhvilluar analiza të mëtejshme e për të vijuar punën mbi përmirësimin e cilësisë [Ref.27. Raport pyetësor studentor organizuar UPT].</p> <p>Bazuar mbi raportet e anketimeve por edhe ato të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm institucional apo për programe studimi, hartohen planet e veprimit për arritjen e objektivave për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë [Ref.24. Plani i veprimit për përmbushjen e Rekomandimeve të përcaktuara në Vendimin 13, Dt. 07.04.2017 të BA].</p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen në mënyrë periodike vlerësimin e programit të studimit. [Ref. 1. Statutit UPT: Kreu IX] Në pikën e të statutit përcaktohet se detyra e NJSBC është planifikimi organizimi periodik i vlerësimit të brendshëm të cilësisë të programeve të studimit si edhe të vlerësimit të brendshëm institucional; Pyetësorët e ndërtuar plotësohen nga studentët. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen në mënyrë statistikore dhe shërbejnë si bazë të dhënash edhe nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm në hartimin e raportit në kuadër të akreditimit të programit. Në nenin 81 të këtij statuti “Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit dhe kërkimit-shkencor” përcaktohet se: ”Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo institucional, realizohet në përputhje me udhëzimet përkatëse të ASCAL dhe organizohet si rregull një herë në tre vjet. Nëse është e nevojshme, mund të organizohen vlerësime të pjesshme apo të plota edhe më shpesh. Mënyra e organizimit të vlerësimit të brendshëm, aktivitetet që kryhen, përgjegjësitë dhe mënyra e paraqitjes së rezultateve përcaktohen në nivel institucional nga drejtoria përkatëse.”</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me GVB u theksua se ky grup në hartimin e RVB kishte autonomi funksionale dhe ka qasje në të gjitha të dhënat e institucionit. Dokumentat institucionale, analizat statistikore, konstatime nga regjistrat, pyetësorët, ambjentet e shërbimit apo edhe intervistat me student dhe stafin akademik kanë shërbyer në hartimin e raporti nga GVB.</p> <p>[Ref.46. Model analizë vjetore mësimore FTI; Ref.27. Raport pyetësor studentor organizuar UPT; Ref.98. Model analizë për lëndë pedagogu _ELN-TLK]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të</p>	

<p>realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Janë përdorur disa metoda për vlerësimin e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve”. Cilësia se mësimdhënies dhe kurrikulës kontrollohet dhe monitorhet nga Drejtuesi i Departamentit, i cili realizon dhe analizat peridike të Departamentit [Ref.45. Model evidencë për raportimin e zhvillimit mësimor]; [Ref.96. Model analizë vjetore mësimore njësi bazë - DET].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Bazuar në nenin 16 të rregullores së brendshme të FTI [Ref 30. Rregullore e brendshme e FTI] Zëvendësdekani për anën mësimore, për të ndihmuar dekanin në realizimin e veprimtarisë së Fakultetit, ndjek hartimin dhe zbatimin e planeve, si dhe të programeve mësimore dhe mbikëqyr zhvillimin e aktiviteteve didaktike konform strukturës mësimore dhe orarit mësimor të miratuar. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga njësi bazë dhe ajo kryesore realizohet edhe duke përdorur raportet e hartuara nga stafi akademik në lidhje me mësimdhënien, duke përdorur pyetësorët studentorë dhe vëzhgimeve rastësore dhe periodike në auditor. [Ref.98. Model analizë për lëndë pedagogu _ELN-TLK] [Ref. 27. Raport pyetësor studentor organizuar UPT] [Ref. 0. RVB-Bsc. Inxh. Telekomunikacioni]</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrjerës dhe ALUMNI në kuadër të gjurmimit të studentëve të diplomuar ka organizuar edhe një pyetësor, në Dhjetor 2021, për të marrë mendimin në lidhje me cilësinë e programit të studimit dhe vlefshmëria e tij tek studenti i punësuar. [Ref.77. Gjurmim Alumni]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>




<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentet bazë institucionale dhe vizitat në institucion konkludon që në institucion është vendosur sistemi i vlerësimit të brendshëm gjithëpërfshirës dhe aktiv. Bazuar në nenin 81 të statutit të UPT institucioni parashikon dhe garanton përfshirjen në vlerësimin e brendshëm të aktorëve të brendshëm stafit akademik, stafit joakademik, studentët dhe grupet e interesit të lidhura me programin e studimit apo institucionin, dhe në rast nevojë përfshirjen e një eksperti të jashtëm. [Ref. 1. Statuti i UPT: Neni 81]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Raportet vjetore të përgatitur nga pyetësorët e studentve japin një informacion të gjerë në lidhje me mendimin e studentëve për cilësinë dhe përmbajtjen e programit mësimor dhe japin rekomandimet e nevojshme për përmirësim për njësitë bazë. [Ref.27. Raport pyetësor studentor organizuar UPT].</p> <p>Planet strategjike të UPT dhe FTI e kanë objektiv vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. [Ref.3. Plani strategjik UPT 19-24], [Ref.31. Plani strategjik i zhvillimit të FTI 2018-2023]</p> <p>UPT ka miratuar rregulloren specifike për organizimin e zgjedhjeve, në të cilën përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e organeve zgjedhore dhe kandidatëve nga stafi akademik apo nga studentët. [Ref.22. Rregullore për organizimin e zgjedhjeve UPT]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se, në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve” janë përfshirë staf akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentët. [Ref.87. Vendim për ngritjen e grupeve të vlerësimi të brendshëm për programet bachelor FTI].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se ngritja e grupeve të vlerësimit të brendshëm, stafi akademik është i përfaqësuar në mënyrë jo diskriminuese si në bazë gjinie, ashtu edhe grade apo kualifikimi akademik. [Ref.87. Vendim për ngritjen e grupeve të vlerësimi të brendshëm për programet bachelor FTI].</p> <p>Procesi i vlerësimit është gjithëpërfshirës duke respektuar elementin e barazisë dhe integritetin e stafit akademik dhe studentëve. Ky proces përfshin procesin e vetëvlerësimit nga ana e pedagogut [Ref. 98. Model analizë për lëndë</p>






	pedagogu], vlerësimin nga eproreë dhe [Ref. 46. Model analizë vjetore mësimore FTI] dhe nga studentët [Ref.27. Raport pyetësor studentor organizuar UPT].			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>GVJ u informua gjatë takimit me drejtuesit e Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit se në vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, si pjesë integruese e vlerësimit, janë edhe ekspertë nga tregu i punës, ku një pjesë përfaqësuese janë të angazhuar si staf akademik i jashtëm [Ref.33. Sondazhe mbi tregun e punës dhe kompanitë]. Forma të tjera të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë nga bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm në FTI janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i praktikave mësimore pranë kompanive partnere. [Ref.42. Raport i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit].</li> <li>• Orët e hapura me ekspertëve të fushës [Ref.78. Shembulli i orëve të hapura].</li> <li>• Përvoja e ish studentëve të diplomuar [Ref.77. Gjurmim Alumni].</li> <li>• Analiza e përputhshmërisë së planit mësimor dhe syllabuseve përkatëse me atë të ofruar në IAL të ngjashme jashtë vendit. [Ref.95. Programe studimi të ngjashme (Torino, Milano)].</li> </ul> <p>GVJ vlerëson se njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi realizon një vlerësim objektiv të programit të studimit që ofron dhe nevojave për rishikimin e tij.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e	GVJ konstaton se të gjitha dokumentat ([Ref.1. Statuti i UPT-së, [Ref.3. Plani strategjik UPT 19-24;]) në të cilat janë përshkruar politikat, strategjitë dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për këtë

studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	program studimi, janë transparente dhe të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit në zyrat përkatëse të institucionit ose nëpërmjet faqes në faqen ueb institucionale në zërin e Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) [www.upt.al].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ bazuar edhe në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, dhe në takimet e zhvilluara konkludon që procesi i vlerësimit të cilësisë në programin e studimit karakterizohet nga transparenca dhe ruajtja e konfidencialitetit. Njësia qëndrore e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, harton në mënyrë periodike raporte të vlerësimit të brendshëm. Raporte të cilat ruhen në arkivën institucionale conform akteve rregullatore në fuqi. Të gjitha të dhënat në Universitetin Politeknik të Tiranës përpunohen dhe bëhen publike duke zbatuar rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UPT. [Ref.13. Rregullore për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UPT], [www.upt.al].
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	FTI vlerëson në mënyrë periodike punën mësimore dhe kërkimore e shkencore. [Ref. 46. Model analizë vjetore mësimore FTI] [Ref. 47. Model analizë vjetore për kërkimin shkencor FTI] Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor dhe problematikat, diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit propozon ndryshimet në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve apo në elementët përbërës të tij nisur nga nevojat e identifikuar për përmirësim, përpara fillimit të vitit akademik pasardhës. [Ref.94. Procedura e ndryshimeve në planet mësimore]
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton një vullnet të qartë nga ana e UPT në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucion i jep këtij procesi. [Shënime në institucion]
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin	Informimi përmes Portalit të Skerretarisë Mësimore, përmes faqeve ueb, adresave të email-it dhe pedagogëve kujdestarë janë disa forma që përdoren për të rritur sensibilizimin e studentëve në lidhje me programin mësimor, udhëzimet e reja dhe masat përmirësuese të ndërmarra nga departamenti




afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	[Ref.100. Model emërimi i pedagogëve kujdestar për studentët]. [ Takimet ne institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Suk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Suk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri të Telekomunikacioneve”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

Programi i studimit është bashkëkohor dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës.

1. Institucioni garanton një bazë laboratorike bashkëkohore duke ofruar një cilësi të lartë në mësimdhënie tek studentët. Mjediset e përshtatshme, infrastruktura didaktike modern dhe labororet mësimore në dispozicion të programit të studimit ofrojnë hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor;
2. Marrëdhënie të institucionalizuara me universitete të huaja homologe në shërbim të kualifikimit dhe shkëmbimit të eksperiencave;
3. Lëndët e programit të studimit ofrohen nga personeli akademik në përputhje me fushën e ekspertizës së tyre. Ngarkesa mësimore mbulohet kryesisht nga staf akademik efektiv i motivuar dhe me kualifikimin e duhur për të garantuar cilësinë e mësimdhënies;
4. Personeli akademik ka eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Përpjekjet e vazhdueshme të stafit akademik në fushën e ekspertizës pavarësisht se niveli i tyre i kualifikimit është shumë i lartë;
5. Niveli i studentëve që regjistrohen në këtë program studimi është cilësor dhe me një mesatare të lartë;
6. Programi i studimit garanton një vazhdueshmëri të plotë të ciklit të studimeve në të tre nivelet: Bachelor – Master i Shkencave – Doktoratë në këtë fushë;
7. IAL kryen analiza vjetore gjithëpërfshirëse, kryen anketime me studentët për stafin, si dhe për kushtet e studimit dhe për problematika të tjera;
8. Institucioni ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi kombëtare që ofrojnë shkëmbim përvojë profesionale dhe bashkëpunimet ndërkombëtare me universitete homologe për realizimit e mobiliteteve të studentëve dhe të stafit, gjithashtu dhe ofrimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë;

9. Institucioni e mbështet financiarisht personelin akademik efektiv në pjesmarrjen në konferenca, botimin e artikujve në revista shkencore dhe pasurimin me literaturë bashkëkohore të kërkuar;
10. Cilësi e lartë e temave të diplomave duke ju ofruar mundësi studentëve një sintezim të kuadrit teorik me raste konkrete në praktikë dhe përfaqsimin me një analizë analitike të situatës;
11. Programi mësimor garanton punësimin e studentëve në perfundim të studimeve të tyre;

**b. Pika të dobta:**

1. Hapësire e vogël e “Qendrës Multimediale” dhe jo e pasuruar për të përmbushur kërkesat e studentëve të këtij programi; (*Standarti III.3, Kriteri 4; Standarti IV.4, Kriteri 2, Kriteri 6*)
2. Rregullorja e programit të studimit nuk pasqyron informacion bazë në lidhje me programin e studimit dhe elementët e tij; (*Standarti I.5, Kriteri 4, Standarti II.3, Kriteri 4, Standarti II.4, Kriteri 3, Standarti II.5, Kriteri 4*)
3. Mungesë e të dhënave nga anketimet në lidhje me punësimin e studentëve në këtë program studimi; (*Standarti V.6, Kriteri 4*)

**Rekomandime:**

1. Të rishikohet rregullorja e programit të studimit duke shtuar ose ofruar informacion të detajuar si më poshtë:
  - 1.1 Të përfshihet një dispozitë e veçantë për procedurën e zhvillimit të praktikës profesionale
  - 1.2 Të vendosen përkufizime të veçanta ligjore, të cilat në konsiderojmë se do t'i japin studentit informacion më të detajuar për programin e studimit;
  - 1.3 Të përcaktohen qartë objektivat formues në këtë rregullore që zotëron çdo student në fillim të vitit akademik të studimeve;
  - 1.4 Të vendoset një dispozitë e qartë dhe e veçantë ligjore për procedurën e diplomimit të studentëve;
2. Të forcohet njësisia “Qendra Multimediale” me qëllim krijimin e lehtësive në drejtim të këtij shërbimi për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit;
3. Programet e menaxhimit të dhënave dhe Office 365, u japin akses të dedikuar si studenteve ashtu edhe stafit akademik. Të listohet materiali akademik i nevojshëm për studentet për ndjekjen e lëndës (psh. Emri i librit, issbn vendodhja ku mund të blihet, dispenca nëse ka gjendje, prezantime të ndryshme, referenca me libra në gjuhë të huaj). Kjo do të ofronte një transparencë më të lartë ndaj studenteve;
4. Të ndiqet një plan veprimi konkret në lidhje me drejtimet e përmirësimeve që duhet të ndërmerren nga Departamenti në lidhje me mundësitë e punësimit të studenteve;

5. Të përpilohen pyetësorët e studentëve në përputhje me lëndët e zhvilluara në nivel kurrikular duke përfshirë pyetje më specifike që i mundësojnë stafit akademik të përmirësojë përmbajtjen e lëndës;
6. Të realizohen anketimet rreth punësimeve të studentëve të diplomuar në FTI-UPT çdo vit dhe të jenë të ndara dhe sipas programeve të studimit dhe jo vetëm në nivel fakulteti;
7. Të prezantohet informacioni i faqes ueb të Fakultetit edhe në gjuhë të huaj;

## **Conclusions of the evaluation of the first cycle program Bachelor in "Telecommunication Engineering"**

### **a. Strengths and affirmations**

The study program is contemporary and in compliance with the demands of the labor market;

1. The institution guarantees a modern laboratory base, by offering a high quality of teaching to students. Suitable environments, modern didactic infrastructure and teaching laboratories available for the study program provide the necessary contemporary spaces and conditions for the learning process;
2. Institutionalized relations with counterpart foreign universities toward qualification and exchange of experiences;
3. The courses of study program are offered by academic staff in compliance with their expertise field. The teaching load is mainly covered by effective academic staff motivated and with the proper qualification to guarantee teaching quality;
4. The academic staff has wide experience in teaching and scientific research. Ongoing efforts of academic staff in field of expertise despite the fact that their qualification level is very high;
5. The level of students enrolled in this study program is qualitative and with a high average;
6. The study program ensures a complete continuity of the study cycle at all three levels: Bachelor - Master of Science – PhD in this field;
7. HEI conducts annual comprehensive analyses, conducts surveys with students about staff, as well as study conditions and other issues;
8. The institution has a series of national cooperation agreements that offer the exchange of professional experience and international cooperation with counterpart universities for the realization of student and staff mobility, as well as the provision of second and third cycle study programs;
9. The institution financially supports effective academic personnel in participating in conferences, publishing articles in scientific journals and enriching them with contemporary literature;
10. The high quality of the diploma topics by offering to students the opportunity to synthesize the theoretical framework with realistic cases in practice and the approach with an analytical analysis of the situation;
11. The study program Bachelor in "Electronic Engineering" guarantees the employment of students at the end of their studies;

## **b. Weaknesses:**

1. Small space of the "Multimedia Center" and not enriched to meet the demands of the students of this program; (*Standard III.3, Criteria 4, Standard IV.4, Criteria 2 and 6*);
2. The regulation of the study program does not reflect basic information about the study program and its main elements; (*Standard I.5, Criteria 4, Standard II.3, Criteria 4, Standard II.4, Criteria 3 and Standard II.5, Criteria 4*);
3. Lack of data from surveys regarding the employment of students in this study program; (*Standard V.6, Criteria 4*);

## **Recommendations**

1. To review the Regulation of study program by adding or providing detailed information as follows:

1.1 To include a special provision with regard of the procedure for the development of professional practice;

1.2 To establish distinct legal definitions which we consider that will provide more detailed information to the student about the study program;

1.3 To clearly define the formative objectives in this regulation that every student possess at the beginning of the academic year of his studies;

1.4 To establish a clear and separate legal provision for the graduation procedure of students;

2. To strengthen the "Multimedia Center" unit in order to create facilities for this service for the students of the Faculty of Electrical Engineering and the Faculty of Information Technology;


3. Data management programs and Office 365 provide dedicated access to both students and academic staff. To list the academic material necessary for the students to follow the course (eg name of the book, issbn location where it can be purchased, dispensation if available, different presentations, references to books in foreign languages). This would provide a higher transparency towards students;

4. To follow a concrete action plan regarding the directions of improvements that should be undertaken by the Department regarding the employment opportunities of students;

5. To develop student questionnaires in line with the courses developed at the curriculum level by including more specific questions that enable the academic staff in their improvement of the content of the course;

6. To carry out surveys about the employment of students who graduated from FTI-UPT every year and be categorized according to study programs and not only at the faculty level;

7. To disseminate the information of the website of the Faculty also in foreign;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushet	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X